

Mars 2019
Numri: 132
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



DELIKATEZA e Rugës sonë





revistaetika



progresibotime

TË
RINJ

*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 2 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*



“Ata që të janë betuar për besnikëri, në të vërtetë, i janë betuar për besnikëri Allahut. Dora e Allahut është mbi duart e tyre!..” (Fet’h, 10)

“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjyqet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.” (Teube, 128)

“O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues, njëkohësisht (të kemi çuar) si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues.” (Ahzab, 45-46)

“...Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj...” (Hashr, 7)

“...Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!..” (A’raf, 158)

“Falni namazin, jepni zeqatin dhe bindjuni të Dërguarit, për të fituar mëshirën e Allahut!” (Nur, 56)

“...Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë.” (Enfal, 1)

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...” (Nisa, 80)

Ata që i binden të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i binden Allahut Teala. Atëherë, ajo që na takon të bëjmë është të mësojmë se si mund t’i bindemi të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe pastaj të veprojmë sipas informacionit që marrim.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), është cilësuar si një “njeri nga gjiri ynë”, si një njeri që ndjen keqardhje kur besimtarët bien në vështirësi, si një njeri i butë, i mëshirshëm, dëshmitar, përgjues, paralajmërues, thirrës për te Allahu dhe një kandil që përhap dritë prej Zotit (xh.xh.).

Allahu i Lartësuar kërkon që t’i bindemi atij. Ai na njofton se bindja ndaj të Dërguarit, është bindje ndaj Tij. Gjithashtu na tregon se rruga e drejtë është vetëm rruga e Resulullahut, (a.s.). Pastaj në fund, Zoti i Madhëruar na e shpjegon qartë se arritja e mëshirës është e lidhur me bindjen ndaj të Dërguarit të Tij.

Atëherë, ajo që na takon të bëjmë, është të mësojmë se çfarë është bindja ndaj Pejgamberit tonë të nderuar.

Zoti (xh.xh.), kërkon prej nesh që të marrim çfarëdo që na jep Pejgamberi, dhe të largohemi prej çdo gjëje që ai ka ndaluar. Atëherë, neve na takon që të mësojmë saktësisht gjithçka që na jep Resulullahu, (a.s.), çdo gjë prej të cilave dëshiron që ne të largohemi, dhe ta sistemojmë jetën sipas tyre.

Ai që i kthen sytë drejt Kuranit Fisnik, që ia vë veshin Librit të Zotit (xh.sh.), dhe që e konsideron si parim të jetës thirrjen e Allahut Fuqiptotë, i respekton ligjet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Çdo gjë tjetër përveç kësaj, është fjalë boshe dhe devijim, pra kërkim i një rruge tjetër përveç rrugës së të Dërguarit të Zotit. Pra, është kërkim i diçkaje tjetër prej Islamit.

Mars 2019

VITI: XIII

NUMRI: 132

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



Cadër e madhe,
cadër e vogël
Nuredin Jëlldëz

16




Betohem se kjo
është një mirësi...
Dr. Adem Ergyl

8



Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash

34



23



Ajjash ibn Ebi Rebia
Mustafa Erh

20

5 Perceptimi i mirësisë hyjnore
Ahmet Tashgetiren

11 Ndrëimi i urtësisë nga dje deri më sot
Ali Byjykçapar

12 Rëndësia e Sunetit të të Dërguarit të
Allaht, (a.s.)
Mubarek Erkull

18 Të kuptuarit e sures Huxhurat
Xhafer Durmush

23 Kapërcimi i pengesave
Ferudun Ozdemir

24 Identiteti i përbashkët
i njeriut dhe Islamit
Ali Riza Temel

26 Kurrkundi dhe pritshmëria
Nuredin Nazarko

28 Psikologjia e mëkatit dhe pendimit
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz



44

Përparësitë dhe delikatesa 30
e rrugës sonë
Fuat Akpënar
Një Ajet-Një Hadith 32

El-Habir 40
Ilir Hoxha

Muslimanët studiohen, por nuk njihen 44
Hatem Bazian

Rinia sipas Islamit 46
Mehmet Emin Aj

Fëmija i mbarë 50
Ferit Piku

A u mbush kavanozi? 53
Urtësi

Njeriu është mësues i asaj që di 54
Kybra Çoban

Për një fjalë të bukur 56
Seher Ajdën

42

Leximi i Kuranit me meditim
Doç. dr. Kerim Bulladë



Si duket kjo botë e parë nga bota tjetër?
Dr. Murat Kaja

48





— Ahmet Tashgetiren —

Perceptimi i mirësisë hyjnore




Ai që e ka zgjedhur si të “Dërguar” birin e Allahut, Muhamedin (a.s.), dhe që ia ka dërguar njerëzimit, është Krijuesi i botëve, Allahu (xh.xh.). Një mysliman, para së gjithash duhet ta vërejë këtë fakt, dhe pastaj ta fusë brenda “Amentusë” së tij. Faza e dytë është që myslimani ta dijë që Krijuesi i Madhëruar ka dërguar një libër së bashku me Pejgamberin. Prandaj, edhe besimin ndaj atij Libri duhet ta fusë brenda “Amentusë” së tij. Emri i këtij libri të shenjtë është Kurani Fisnik.

Cilido që nuk beson se Muhamedi (a.s.), është zgjedhur si “i Dërguar” nga Allahu Teala dhe se Kurani është dërguar bashkë me të, nuk bëhet fjalë që të përfshihet brenda kornizës së Islamit.

Faza e tretë është hulumtimi i tablosë së të Dërguarit në Kuran, pra në fjalën e Allahut, dhe i mënyrës se si janë caktuar ligjet e tij, nga Vullneti që e ka dërguar atë. Myslimanizëm do të thotë pikërisht vendosje e kornizave të mendimit dhe jetës sonë, sipas rregullave që ka caktuar Allahu Teala.

A ka rregulla në Kuranin Fisnik në lidhje me detyrimet e myslimanit kundrejt Pejgamberit (a.s.)? Po, ka. Këtu mund të parashtrohet edhe një pyetje tjetër: A janë të vlefshme edhe në ditët e sotme ajetet e Kuranit që bëjnë fjalë për të Dërguarin e Allahut, (a.s.)? Kjo pyetje domosdoshmërisht sjell edhe pyetjen tjetër: “Cilat ajete të Kuranit janë të vlefshme dhe cilat jo, në ditët e sotme?” Për sa i përket një çështjeje të tillë, vendimin nuk mund ta japë asnjë përveç Allahut (xh.xh.). Përpjekja për të dhënë vendim në këtë mesele, është në kundërshtim me natyrshmërinë e kësaj çështjeje. Nëse besohet se dikush tjetër përveç Allahut ka autoritet për të ndryshuar fjalët e Zotit (xh.xh.), duket qartazi se në pah nuk do të ngelte më Kuran. Për këtë arsye, thënia: “Dispozita e këtij ajeti ka qenë për të kaluarën.”, është tentativë për ta shkatërruar Kuranin Fisnik. E njëjta gjë është e vlefshme edhe për ajetet që flasim për të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Prandaj, ajo që i takon myslimanit, është përpjekja për ta kuptuar librin e Allahut dhe për të formësuar një disiplinë jete sipas dispozitave të tij.

Atëherë, e gjithë çështja është që myslimanët t’i mësojnë këto rregulla, ta perceptojnë sa më mirë secilin prej tyre dhe të formojnë një kornizë jete, siç





Allahu Teala thotë për të Dërguarin e Tij: **“Të kemi dërguar si mëshirë për botët.”** (Enbija, 107.), dhe nuk bën ndonjë kufizim në lidhje me kohën, vendin, racën dhe ngjyrën, atëherë do të thotë se të gjithë njerëzit, me në krye besimtarët, duhet të përpiqen ta bëjnë të Dërguarin e Allahut, (a.s.), mëshirë për veten e tyre. Domethënë, një mendim i formës: **“I Dërguari i Allahut ka qenë mëshirë vetëm në kohën kur është zbritur Kurani.”**, nuk është gjë tjetër përveçse një mendim totalisht i gabuar.

është e nevojshme që ato të reflektojnë në jetë.

Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Fisnik, madje duke u betuar: **“(Betohem se) Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre...”** (Al ‘Imran, 164.) Atëherë duhet t’i vëmë në veprim të gjitha aftësitë mendore, për ta perceptuar si duhet këtë ajet. Ky ajet së pari u drejtohet “besimtarëve”, sepse secili nga ne duhet ta shohë Resulullahun (a.s.), si një mirësi të Allahut (xh.xh.). Pastaj duhet ta kuptojmë se çfarë do të thotë mirësi nga aspekti i jetës sonë. Ajeti i plotë është si më poshtë:

“(Betohem se) Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.”

Çfarë kuptojmë nga ky ajet? I Dërguari i Allahut, (a.s.), është ai që e largon njeriun nga devijimi, që i pastron besimtarët dhe ua mëson atyre Kuranin dhe urtësinë.

Domethënë se ne duhet të kapemi fort pas të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, në mënyrë që të mos shkojmë drejt devijimit. Ne duhet të kapemi fort pas të Dërguarit të Allahut, (a.s.), për t’u pastruar, për të mësuar Librin dhe për të arritur urtësinë. Prandaj, nën përkufizimin e “mirësisë” që përmendet në ajet, le të lexojmë edhe shumë ajete të tjera që flasin për të Dërguarin e Allahut, (a.s.).

Nëse Allahu Teala thotë për të Dërguarin e Tij: **“Të kemi dërguar si mëshirë për botët.”** (Enbija, 107.), dhe nuk bën ndonjë kufizim në lidhje me kohën, vendin, racën dhe ngjyrën, atëherë do të thotë se të gjithë njerëzit, me në krye besimtarët, duhet të përpiqen ta bëjnë të Dërguarin e Allahut, (a.s.), mëshirë për veten e tyre. Domethënë, një mendim i formës: **“I Dërguari i Allahut ka qenë mëshirë vetëm në kohën kur është zbritur Kurani.”**, nuk është gjë

tjetër përveçse një mendim totalisht i gabuar. Nga mund ta nxjerrim një përfundim të tillë?! Si mund ta ndërpresim kështu mëshirën e Allahut?!

Nëse Zoti (xh.xh.), i thotë të Dërguarit të Tij në Kuranin Fisnik: **“Me të vërtetë, ti ke një moral të lartë.”** (Kalem, 4.), atëherë, detyra që u takon të gjithë atyre që e besojnë Kuranin si libër të Allahut, është që ta mësojnë moralin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe të pajisen me moralin e tij. Këtë duhet ta bëjnë me dëshirën e zjarrtë për të fituar “mirësinë hyjnore”.

Zoti (xh.xh.), thotë në Kuran: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”** (Ahzab, 21.) Atëherë, në lidhje me këtë qëndrim, çfarë detyrash i takojnë besimtarit? Së pari i takon të kuptojë se i Dërguari i Allahut, (a.s.), është përkufizuar nga Zoti (xh.xh.), si shembull i mrekullueshëm. Pastaj duhet të ketë parasysh se këtë perceptim, Allahu Teala ua jep atyre “që shpresojnë te Allahu dhe Dita e Fundit dhe që e përmendin Allahun shumë.” Për këtë arsye, duhet të përpiqet ta sjellë zemrën në këtë pozitë, në mënyrë që t’i dhurohet ky perceptim. Pas kësaj etape, duhet të përvetësojë me të gjitha bukuritë e tij, “shembullin e mrekullueshëm”, dhe të përpiqet ta ndërtojë personalitetin e vet duke u lyer me “bojën” e tij.

Myslimani duhet të mendojë se kur Zoti (xh.sh.), përdor termin “shembull i mrekullueshëm”, do të thotë se këtu bëhet fjalë për një jetë të mrekullueshme që duhet të merret për shembull. Zoti i madhëruar thotë “Usvetun Hasene”. Pra, nuk vë ndonjë kufizim në lidhje me ndonjë fushë të jetës.

Prandaj, nëse duhet të marrim dikë për shembull, le të marrim të Dërguarin e Allahut, (a.s.), sepse të gjitha bukuritë dhe cilësitë njerëzore kanë qenë të mbledhura te ai. Nëse do ta pasojmë atë, atëherë mirësia hyjnore do të mbartet edhe në jetën tonë.

Bazuar në këto që thamë më sipër, tentativa për

ta kufizuar marrëdhënien e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), me myslimanët, nuk është gjë tjetër përveçse devijim. Çfarë po përpiqen të bëjnë njerëzit sot? Po përpiqen të kufizojnë Kuranin Fisnik. Si rezultat, po përpiqen të kufizojnë vullnetin e Allahut Teala. Si mund të quhet kjo gjendje e mjerueshme?

Tashmë le t'i lexojmë këto ajete që Zoti (xh.xh.), i ka zbritur për të drejtat e të Dërguarit të Tij, (a.s.), dhe t'i bëjmë ato parim të jetës sonë:

“Ata që të janë betuar për besnikëri, në të vërtetë, i janë betuar për besnikëri Allahut. Dora e Allahut është mbi duart e tyre!..” (Fet'h, 10)

“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.” (Teube, 128)

“O Profet! Ne të kemi dërguar ty si dëshmitar, sjellës të lajmit të mirë dhe paralajmërues, njëkohësisht (të kemi çuar) si thirrës, që i fton njerëzit në rrugën e Allahut me urdhrin e Tij dhe si pishtar ndriçues.” (Ahzab, 45-46)

“...Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj...” (Hashr, 7)

“...Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!..” (A'raf, 158)

“Falni namazin, jepni zeqatin dhe bindjuni të Dërguarit, për të fituar mëshirën e Allahut!” (Nur, 56)

“...Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nëse jeni besimtarë të vërtetë.” (Enfal, 1)

“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...” (Nisa, 80)

Çfarë kuptojmë nga këto ajete?

Ata që i binden të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i binden Allahut Teala. Atëherë, ajo që na takon të bëjmë është të mësojmë se si mund t'i bindemi të Dërguarit të Allahut, (a.s.), dhe pastaj të veprojmë sipas informacionit që marrim.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), është cilësuar si një “njeri nga gjiri ynë”, si një njeri që ndjen keqardhje kur besimtarët bien në vështirësi, si një njeri i butë, i mëshirshëm, dëshmitar, përgëzues, paralajmërues, thirrës për të Allahu dhe një kandil që përhap dritë prej Zotit (xh.xh.).

Allahu i Lartësuar kërkon që t'i bindemi atij. Ai na njofton se bindja ndaj të Dërguarit, është bindje ndaj Tij. Gjithashtu na tregon se rruga e drejtë është vetëm rruga e Resulullahut, (a.s.). Pastaj në fund, Zoti i Madhëruar na e shpjegon qartë se arritja e

mëshirës është e lidhur me bindjen ndaj të Dërguarit të Tij.

Atëherë, ajo që na takon të bëjmë, është të mësojmë se çfarë është bindja ndaj Pejgamberit tonë të nderuar.

Zoti (xh.xh.), kërkon prej nesh që të marrim çfarëdo që na jep Pejgamberi, dhe të largohemi prej çdo gjëje që ai ka ndaluar. Atëherë, neve na takon që të mësojmë saktësisht gjithçka që na jep Resulullahu, (a.s.), çdo gjë prej të cilave dëshiron që ne të largohemi, dhe ta sistemojmë jetën sipas tyre.

Ai që i kthen sytë drejt Kuranit Fisnik, që ia vë veshin Librit të Zotit (xh.sh.), dhe që e konsideron si parim të jetës thirrjen e Allahut Fuqiplotë, i respekton ligjet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Çdo gjë tjetër përveç kësaj, është fjalë boshe dhe devijim, pra kërkim i një rruge tjetër përveç rrugës së të Dërguarit të Zotit. Pra, është kërkim i diçkaje tjetër prej Islamit.

Së fundi, le ta lexojmë edhe këtë ajet fisnik, që i bashkon ligjet e Allahut (xh.xh.), me ligjet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.):

“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë! Dhe ta dini se Allahu ndërhyr midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mblidheni të gjithë!” (Enfal, 24)


Çfarë na takon të bëjmë kur ta lexojmë këtë ajet fisnik? Neve na takon të kuptojmë se rregullat që do të na japin jetë, janë rregullat te të cilat na fton Allahu dhe i Dërguari i Tij. Pastaj duhet ta sistemojmë jetën sipas këtyre rregullave.

Si thotë profesor Nexhip Fazëlli:

“I nderuar, përgëzues, shpëtimtar dhe Pejgamberi im!

Një rregull që nuk përputhet me ty, do ta refuzoja edhe nëse do të bëhej fjalë për vetë jetën.”

Çfarë mund të thuhet tjetër?! Allahu na dhëntë mend të gjithëve dhe mos na largoftë nga rruga e drejtë!





Betohem se kjo është një mirësi...

— Dr. Adem Ergyl —

Allahu i Lartësuar, që e shfaq mëshirën dhe ndihmën ndaj robërve të Tij me nimetet dhe mirësitë e pafundme, i parashton me shprehje betimi ajetet plot të fshehta në lidhje me gjithësinë dhe këto mirësi të Tij, të cilave njerëzit shpesh herë janë të paaftë t'ua dinë vlerën. Ai jep edhe shenja për të treguar të vërtetat e tyre plot të fshehta.

Linguistët, në lidhje me urtësinë e betimeve në mesazhet hyjnore, shprehen: “Nëse Zoti (xh. xh.), betohet për një çështje, ndonëse nuk është i detyruar, do të thotë se aty trajtohet: ndonjë temë madhështore dhe e thellë, që njerëzit nuk mund ta kuptojnë dot; ndonjë qëndrim që kundërshton ndjesitë negative dhe paragjykimet e zemrave të njerëzve kundrejt dijes së dhënë; ose më e pakta shërben si përforcues, duke kërkuar që dëgjuesit e mesazhit hyjnor t'i përkushtojnë edhe më shumë kujdes çështjes që trajtohet.”

Tashmë, brenda kësaj kornize, le t'u hedhim

një sy të vërtetave hyjnore që na janë parashtruar me shprehje betimi në lidhje me të Dërguarin e Allahut, (a.s.):

“Betohem për Kuranin plot urtësi! Në të vërtetë, ti (Muhamed) je një nga të dërguarit në rrugë të drejtë.” (Jasin, 2-4)

“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.” (Al Imran, 164)

“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkoni rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.” (Teube, 128)

“...Betohem për penën dhe për atë që shkruaj-në se ti (o Muhamed), falë mirësisë së Zotit tënd, nuk je i marrë. Pa dyshim, ti do të jesh përherë i shpërblyer se ti je me virtyte madhore.” (Kalem, 1-4)

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Alla-hun.” (Ahzab, 21)

“Betohem për jetën tënde (o Muhamed), se ata ishin vërtet të përhumbur në dehjen e tyre!” (Hixhr, 72)

Le të shohim se çfarë ka dashur të shprehë Zoti i madhëruar në këto ajete, për personalite-tin e të Dërguarit të Tij, për profecinë, për detyrën e Pejgamberit (a.s.), dhe veçanërisht për besimtarët, duke filluar frazat me fjalën “Beto-hem...”:

1- Para së gjithash, Muhame-di (a.s.), është një i Dërguar i Allahut Teala, pra nuk është një i dërguar i zakonshëm, por i Dërguari i vetë Allahut. Atëherë, dashuria dhe respekti që shfaqet kundrejt tij, shfaqet në të vërtetë kundrejt Allahut (xh.xh.). Bindja ndaj qëndrimeve të Pejgamberit (a.s.), është bindje ndaj Atij që e ka dërguar, sepse ai nuk ka folur sipas dëshirës së vet. Udhërrëfimi dhe udhëzimi i tij janë bërë në emër të Allahut. Ai që nuk ia vë veshin atij apo që e nënvlerëson, do të privohet nga adhurimi prej të cilit Zoti (xh.sh.), është i kënaqur.

2- Ai është në “siratu’l-mustekim/rrugën e drejtë”. Kushdo që dëshiron të shkojë te Zoti dhe te e vërteta, duhet të ndjekë rrugën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Rrugë më e drejtë, më e shkurtër dhe më e lehtë në besim, adhurim, vepra dhe moral, pra në të gjitha fushat e jetës, është rruga që na ka shenjuar Pejgamberi, dhe në të cilën ka ecur edhe ai vetë. Rrugët e tjera janë sokakë pa krye. Ndërsa ai që dëshiron të ndjekë një rrugë tjetër përveç rrugës së Resulullahut, (a.s.), me dijeni apo pa dijeni, devijon në rrugë të shtrembra. Tashmë ky njeri është vetë përgjegjës për ato që do t’i ndodhin.

3- I Dërguari i Allahut, (a.s.), është një mirësi e madhe e Zotit (xh.sh.) për besimtarët, një mirësi madhështore së cilës nuk i shlyhet lehtë falënderimi. Kjo është një mirësi përballë së cilës duhet të mbajmë qëndrim të vëmendshëm dhe të disiplinuar, një mirësi që Allahu i Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëplotë e ka dërguar si mëshirë për të gjitha botët. Edhe pse është i vështirë zbulimi i të gjitha horizonteve dhe thellësive të kësaj mirësie, çdo besimtar është i detyruar që ta perceptojë të qenit e saj një mirësi, veçanërisht në këto katër fusha:

E para: I Dërguari i Allahut, (a.s.), na lexon ajetet e Allahut Teala. Mesazhet sublime të Zotit të botëve transmetohen nga zemra e Pejgamberit në gjuhën e tij dhe nga gjuha e tij për te ne. Ai na lexon si ajetet e Kuranit Fisnik, i cili është fjala e Krijuesit të Lartësuar, ashtu edhe ajetet hyjnore të fshehura në gjithësi dhe ngjarje. Pejgamberi ndjek gjurmët e tyre dhe na hap shumë rrugë që na çojnë te këto madhështi. Nga një aspekt, i Dërguari i Allahut, (a.s.), bën ndërmjetësimin/lidhjen me këtë mirësi sublime, të cilën askush nuk mund ta arrijë vetëm.

E dyta: I Dërguari i Allahut, (a.s.), na pastron dhe na dëlir. Pejgamberi na pastron nga besimet e devijuara dhe të humbura, nga mëkatet dhe papastërtitë fizike dhe shpirtërore, nga çdo lloj sjelljeje e shëmtuar që reflektohet në veprimet tona dhe nga çdo degradim apo degjenerim etik që nuk i shkon humanizmit. Madje, Resulullahu, (a.s.), na edukon në butësisht, në mënyrë që të ndërtojmë një personalitet shembullor dhe të përsosur.

E treta: I Dërguari i Allahut, (a.s.), na mëson Librin. Ai na njofton për dispozitat e Zotit (xh.xh.). Ai na sqaron obligimet, hallallin dhe haramin, gjërat e bukura, gjërat e shëmtuara, shkurtimisht, na paraqet një kornizë të qartë të kufijve të shpallur.

E katërta: I Dërguari i Allahut, (a.s.), na mëson urtësinë. Ai i transmeton njerëzimit të vërtetat më themelore, principet e natyrshmërisë, ligjet e

“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.”

(Al Imran, 164)

Allahut Teala në lidhje me jetën e ngjarjet, dhe shumë parime e dispozita të tjera hyjnore që janë respektuar që nga njeriu i parë dhe do të respektohen deri te njeriu i fundit.

4- Veçoritë më të dallueshme të natyrshmërisë dhe personalitetit të të Dërguarit të Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ishin mëshira dhe dhembshuria e madhe që posedonte. Zoti i Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëplotë, si një vepër e mëshirës së Tij ndaj të gjitha botëve, dërgoi Pejgamberin, veshur me cilësi gjallëruese dhe evoluese, si shembulli i një shiu të begatë. Zemra e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ndjente keqardhje edhe për nguljen e një gjembi në këmbën e besimtarëve. Madje, ai përpëltej dhe përpiquej deri në masën që dërmonte edhe veten, në mënyrë që të mos mbetej asnjë që e mohonte Zotin

(xh.xh.). Resulullahu, (a.s.), ishte falës dhe i mbulonte gabimet e të tjerëve.

Sa nderim i madh hyjnor është për ne, fati i të pasurit të një Pejgamberi të tillë dhe të qenit ummeti që i besojmë atij!

5- Zoti (xh. xh.), është dëshmitar për moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Shenja dalluese e nderit të njeriut është morali i tij. Sa adresë të mrekullueshme përbën Pejgamberi për kërkuesit e virtyteve, të cilët janë kureshtarë për të ditur se cila është përsosmëria e moralit me të cilën kënaqet Zoti (xh.xh.)! Të shkruarit e moralit nëpër rreshta relativisht është e lehtë, por të jesh shembull në këtë çështje është mjaft e vështirë. Ekzistenca konkrete e një monumenti të tillë etik për nderin e njerëzimit, nëse mund ta vlerësojmë kështu, është një dhuratë e madhe për humanizmin.

6- I Dërguari i Allahut, (a.s.), është shembulli më i përsosur që mund të pasojnë dhe ndjekin, ata që dëshirojnë kënaqësinë e Zotit (xh.xh.), dhe shpresojnë në takimin me Të, që dëshirojnë të ndërtojnë jetën e tyre të përhershme dhe që janë të vendosur për ta përkujtuar Zotin në çdo moment. Sa mirësi e madhe hyjnore është kjo gjendje shembullore dhe prijëse/elitare e Pejga-

mberit, për besimtarët e vërtetë dhe të mençur, të cilët e konceptojnë faktin e të qenit robër të Zotit dhe e vendosin në epiqendër të jetës së tyre nënshtrimin ndaj Krijuesit!

7- Përfundimisht, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është Mustafai dhe Muxhtebai për jetën e të cilit është betuar Allahu i Lartësuar. Pra, Pejgamberi ynë i nderuar është njeriu i përsosur, të cilin Allahu Teala e ka zgjedhur si të Dërguar të Tij dhe prej nënshtrimit të të cilit Ai është i kënaqur. Atëherë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është prijësi dhe shembulli i vetëm që mund të ndiqet hap pas hapi nga çdo individ që ka nisur rrugën dhe ka vendosur të përparojë në udhëtimin drejt përsosmërisë njerëzore. Pejgamberi, nga ky aspekt, është mirësia më e madhe në të gjitha fushat e jetës.

Ai që nuk e njeh mirësinë, sigurisht që nuk mund të përfitojë prej saj. Kjo është arsyeja pse Allahu i Madhëruar, i Cili është shumë i mëshirshëm dhe i butë kundrejt robërve të Tij, ua ka prezantuar vetë njerëzve këtë mirësi madhështore, duke u betuar. Edhe pse e vërteta është kjo, përveç se prej mohuesve, edhe prej besimtarëve përgjatë gjithë historisë kanë dalë të atillë që nuk e kanë vlerësuar siç duhet këtë mirësi sublime. Njerëz të tillë sigurisht që do të vazhdojnë të dalin edhe në të ardhmen. Këta njerëz e shohin Pejgamberin (a.s.), vetëm si një i Dërguar që predikon shpalljen hyjnore dhe i mohojnë funksionet e tjera të tij. Çfarë mund të quhet kjo, përveçse fatkeqësi?!

Para së gjithash, ne duhet të shfaqim respekt kundrejt mirësisë. Pastaj duhet ta falënderojmë Atë që na e ka dërguar këtë mirësi. Në të vërtetë, këto janë ndjenjat e para që duhet të lindin në zemrat besimtare. Ndërsa për përfitimin e mirëfilltë nga mirësia e dërgimit të Pejgamberit, rëndësi të jashtëzakonshme kanë edhe dashuria e thellë dhe edukata. Ata që ngurrojnë e që janë të ftohtë ndaj kësaj dashurie, dhe ata që nuk e shfaqin edukatën në fjalët e veprimet e tyre, sigurisht që nuk mund të përfitojnë nga begatia dhe mirësia e këtij burimi mëshire. Në të vërtetë, në zemrat e njerëzve të tillë, as që do të formohet synimi për të përfituar nga i Dërguari i Allahut, (a.s.). Prandaj i kërkojmë mbrojtje Allahut (xh.xh.), nga një gjendje e tillë dhe gjendje të ngjashme me të.

All-llahumme sal-li ala sejjidina Muhammedin ve ala ali sejjidina Muhammed!



Ndriçimi i Urtësisë nga dje deri më sot

— Ali Byjykcapar —

Si mund të harrohet kështu?! Ditët kalojnë dhe ne na duket sikur gjithçka ka ndodhur dje. Befas vërejmë se thesari i informacioneve që gjenden në memorie, është në rrezik.

Prandaj, gjithmonë duhet ta mbajmë kujtesën të re dhe të gjallë!

Feja islame, që i pranon të gjithë njerëzit si fëmijët e Ademit (a.s.), i ka treguar njeriut se besimi është cilësia që mund ta bëjë atë më të shtrenjtë dhe fisnik të Allahu (xh.xh.). Termi Iman/besim mbart shumë kuptime dhe është një rreth shumë i gjerë. Kjo kala forcohet me sprova përgjatë gjithë jetës, çdo ditë.

Bashkimi, uniteti dhe solidariteti janë cilësi të bukura, të cilave u theksohet rëndësia pothuajse çdo ditë, por që nëse keqpërdoren, mund të bëhen shkak për ndarje dhe përçarje. Është jashtëzakonisht e vështirë t'i jepet kuptim këtyre dukurive. Ja pra, pikërisht në këto situata, kapja pas litarit të Allahut Teala dhe të qenit modest e largpamës, do të jenë shenjat orientuese të rrugës kryesore të besimtarit.

Ne duhet ta pranojmë si shenjë të nënshtrimit ndaj Zotit (xh.sh.), çdo moment të jetës dhe çdo gjë që ndodh përgjatë saj. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka cilësuar si adhurime: gjykimin me drejtësi ndërmjet dy njerëzve, fjalën e drejtuar bukur, largimin nga rruga të ndonjë pengese që mund t'i shqetësojë njerëzit, dhënien e ndihmës ndaj dikujt që dëshiron të hipë në kafshë apo që përpiket të ngarkojë kafshën, dhe çdo hap që hidhet për të shkuar në namaz. Gjithashtu Pejgamberi (a.s.), është shprehur se këto veprime janë edhe lëmoshë.

Ja baza e fesë!

A nuk është e qartë se kemi nevojë për këtë të vërtetë, e cila qëndron një hap më para përkufizimeve, të cilat rezultojnë nga debate të qëllimshme, apo edhe të dëmshme?

Ekzistojnë tema që duhet t'i diskutojnë ndërmjet njëri-tjetrit njerëzit që kanë zgjedhur shkencat fetare si profesion dhe që kanë bërë specializimet e nevojshme për thellimin në to. Përçimi i këtyre diskutimeve në të gjithë shoqërinë, si dhe pritja e lindjes së urtësisë fetare nga përhapja e diskutimeve të tilla, është mungesë vëmendjeje dhe padrejtësie më e madhe.

“Besimtari është njeri i dashur. Prandaj, nuk ka mirësi te një njeri që nuk krijon afrimet (me njerëzit) dhe që nuk lejon të krijohet afrimet me të.” (Ibn Hanbel, II, 400.)

Ja, kjo është esenca e të gjitha të vërtetave që deshëm të shpjegojmë: arritja e urtësisë së bashkëjetesës me njerëzit dhe formimi i miqësisë me ta. Kjo e fshehtë, që shprehet me fjalë dhe që e bën njeriun burrë me vepra të mira, çdo ditë i jep formë jetës sonë, pra na e hap derën ose drejt Xhenetit, ose drejt Xhehenemit.

Tashmë na kanë rrethuar kohë të vështira.

Në pikën ku ka arritur kjo botë, jemi detyruar të përvetësojmë në mënyrë të menjëhershme sjelljet që popujt e tjerë kanë harxhuar me dhjetëra vite për t'i arritur. Kjo dukuri, me në krye ekzistencën tonë, ka shkaktuar fraktura në të gjitha fushat. Për këtë arsye, çdo ditë po përballemi me vështirësi si përçarja dhe ribashkimi i shoqërisë. Prandaj, le të shohim se sa do ta ndriçojmë të nesërmen me urtësinë e së djeshmes.



Rëndësia e Sunetit

TË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT, (A.S.)

— Mubarek Erkull —

Ebu Rafi (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Kur të njoftoheni për një çështje që ua kam urdhëruar apo ua kam ndaluar, të mos gjej ndonjë prej jush që thotë duke u mbështetur në kolltuk: “Ne nuk i dimë këto. Ne pasojmë çfarëdo që gjejmë në librin e Allahut.”*”¹

Suneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ngaqë është gjendja në praktikë e Kuranit Fisnik, përbën burimin e dytë bazë të Islamit, krahas Kuranit. Libri i Allahut Teala dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), si dy burime të pandashme, kanë mundësuar edhe formimin e strukturës shoqërore islame, por edhe vazhdimësinë e kësaj shoqëria, pa i humbur cilësitë.

Sipas dijetarëve të hadithit, Suneti është çdo gjë që na është transmetuar nga Muhamedi (a.s.).² Shkurtimisht, Suneti është jeta e Pejgamberit, e cila në Kuranin Fisnik paraqitet si “Usvetun Hasene” dhe morali i Pejgamberit, për të cilin Aishja (r.anha), shprehet: “Morali i tij ishte Kurani”.³

Nisur nga ky kontekst, i Dërguari i Allahut, (a.s.), është një njeri i pashoq, nëpërmjet personalitetit të të cilit Shpallja Hyjnore është vënë në jetë. Pra, Kurani Fisnik të Resulullahu, (a.s.), ka dalë nga të qenit fjalë dhe është shndërruar në jetë. Për ata që dëshirojnë të hyjnë në edukimin e

Shpalljes Hyjnore, këshillohet që të ecin në gjurmët e Pejgamberit tonë të nderuar dhe ta marrin si shembull atë. Shpallja e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), nga vetë Allahu, si “shembull i shkëlqyer” për njerëzit, është bërë duke e përforcuar me betim në ajetin: *“(Beto hem se) në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.”*⁴

Marrja për shembull e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), para së gjithash do të thotë kuptim, përjetim dhe përhapje e fesë. Në këtë kontekst, Suneti është bazë e fesë dhe absolutisht nuk mund të ndahet nga Kurani Fisnik.

Hadithi që dhamë më lart dhe që njihet si “Hadithi Erike” ndërmjet dijetarëve, gjendet me transmetime të ndryshme në literaturën islame. Për shembull, ndërkohë që në një transmetim gjendet shprehja “i mbështetur në kolltuk”, në një transmetim tjetër gjendet në formën “një burrë me bark të ngopur dhe i mbështetur në kolltuk”. Por sidoqoftë, çështja e cila theksohet në të gjitha transmetimet është e njëjtë. Ky hadith fisnik njofton se me kalimin e kohës disa njerëz do të përpiqen ta ndajnë Allahun me të Dërguarin e Tij, apo thënë me një shprehje tjetër, ta ndajnë Kuranin me Sunetin duke përdorur konceptet, shprehjet dhe parullat klishe si: “mjaftimi me Kuran”, “të vepruarit sipas Kuranit”, “përqasje sipas Kuranit” dhe “Islami i Kuranit”.

1. Ebu Davud, Sunet, 5; Tirmidhi, Ilm, 10; Ibn Maxhe, Mukaddime, 2; Darimi, Sunen, Mukaddime, 49; Bejhaki, Delail, 1/24; (Tirmidhiu thotë se ky hadith është “Hasen”).

2. Ismail Lutfi Çakan, Sunet, rreth Sunetit, Sunenit të Ebu Davudit dhe disa termave të hadithit, Mukaddime, fq. 14.

3. Shik. Ahmed b. Hanbel VI, 188 (Ismail Lutfi Çakan, vepra e lar - përmendur.).

4. Ahzab, 33/21.

“Ja pra, hadithi fisnik na ndihmon pikërisht në këtë pikë, me dritën e vërtetimeve dhe paralajmërimeve profetike. Në këtë mënyrë, ua ekspozon besimtarëve lojën që po bëhet, me të gjitha dimensionet e saj të vërteta. Pejgamberi ynë i dashur, me këtë hadith na ka njoftuar se një ditë do të dalin disa fatzinj që nuk do ta njohin autoritetin e tij për të vendosur dispozita, dhe që nuk do t’i japin rëndësi komentimit universal që sjell Suneti, dhe do të thonë që mjaftohen me Kuranin. Pastaj shprehet se nuk dëshiron ta shohë ndonjë nga sahabët apo nga ummeti i tij, tek shfaq një pohim dhe veprim të tillë. Në këtë mënyrë, ai ka sqaruar mjaft bukur dhe qartazi pretendimet për një Islam pa Sunet, dhe i ka paraprirë dhe ekspozuar ata që marrim guximin të bëjnë diçka të tillë.” (Ismail Lutfi Çakan, Të vërteta me hadithe, 2, fq. 138.)

Padyshim se aktivitetet kundër Sunetit nuk janë

në lidhje me Sunetin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), një burrë i tha: “O Ebu Nuxhej! Na fol për Kuranin!” Nisur nga këto fjalë, Imran ibn Husejini i tha: “Ti dhe shokët e tu e lexoni Kuranin. A mund të më flasësh për namazin, për gjërat brenda namazit dhe për kufijtë e tij? A mund të më flasësh për zekatin e floririt, deveve, lopëve dhe të pasurive të tjera? Por kur nuk ishe ti, unë i shpjegova këto.” Pastaj (Imrani) e vazhdoi fjalën: “I Dërguari i Allahut, (a.s.), na ka obliguar kështu në çështjen e zekatit.” Atëherë burri i tha: “Ma shpjegove shumë qartë! Allahu të ruajt!” Hasan el-Basriu, i cili e tregon këtë ngjarje, ka thënë: “Ky burrë më në fund u bë prej fakihëve të myslimanëve.” (Abdullah Ajdënlë, Përkthimi i Sunenu Darimi, Mukaddime fq. 47.)

Në shekullin e dytë hixhri, disa njerëz, edhe pse të paktë në numër, e mohuan Sunetin si argument dhe funksionin e tij juridik. Pas shekullit të

bërë vetëm në ditët e sotme. Këto lloje aktivitesh dhe mendimesh mund t’i shohim në çdo periudhë të historisë islame. Këto lloje prirjesh, që kanë filluar të pushtojmë rendin ditor të ummetit, veçanërisht pas periudhës së Tabiinëve, gjithmonë kanë mbetur pakicë, pikërisht siç kanë qenë edhe në periudhën kur janë shfaqur. Ato vazhdimisht janë përvetësuar, mbrojtur dhe nxjerrë në pah nga grupe marginale. Kjo prirje, për të cilën na ka paralajmëruar i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, në hadithin fisnik, ka dalë në pah shumë pak kohë pas vdekjes së tij. Lufta e atyre që e mbrojnë Sunetin me ata që e mohojnë, e ka shfaqur veten e saj në skenën e historisë duke filluar që nga periudha pas Tabiinëve.

Ngjarja e mëposhtme është mjaft interesante si shembull për këtë çështje: Hasan el-Basriu transmeton se një herë kur Imran ibn Husejni po fliste

dytë hixhri iu dha fund kësaj përçarjeje. Ndërsa tashmë po përballemi përsëri me të njëjtën fitne. Pra, e njëjta fitne është ringjallur me influencën e kolonializmit të Perëndimit. Në vendet islame, duke filluar që nga India, edhe pse me përmasa jo serioze, po rastisim në mentalitetin që synon nxjerrjen jashtë funksioni të Sunetit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ndërsa në vendin tonë, krahas kundërshtarëve të pjesshëm të Sunetit, gjenden edhe njerëz që e mohojnë plotësisht traditën profetike.⁵ Ndërkohë Suneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), teorikisht është shpjegim i Kuranit dhe praktikisht është zbatimi i këtij të fundit.⁶

5. Argumentet dhe debatet në lidhje me çështjen, Dr. Muhamed Mustafa el-A'zami. Ky shkrim është përkthyer nga Prof. Dr. Abdullah Ajdënlë dhe është marrë nga vepra me titull “Dirasat fi'l-hadithi'n-nebevi”. Të njëjtën vepër e ka përkthyer edhe Dr. Nuri Topallogllu. Përveç të tjerash, në lidhje me rrjedhshmërinë historike të debateve për Sunetin, shik. Ebubekir Sifil, Kritika e mendimit Islam Modern, I, fq. 524-550.

6. Jusuf Kardavi, Metoda për ta kuptuar Sunetin, fq. 61.

Nisur nga këta që thamë, ne jemi të obliguar ta ndjekim Sunetin, i cili është komentimi universal i Kuranit Fisnik, dhe të veprojmë me dispozitat e sugjerimet që ka sjellë ai.

Përgjigjja e Kuranit Fisnik është shumë e qartë për këta njerëz dashakeqës që thonë, siç shprehet edhe hadithi: “Ne pasojmë vetëm atë që gjejmë në librin e Allahut”, e që me këtë dëshirojnë të shkëpusin Allahun me të Dërguarin e Tij: **“Vërtet, ata që mohojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë Allahun nga të dërguarit e Tij, duke thënë: ‘Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë’ dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme, pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim poshtërues për mohuesit.”**⁷

Nga ana tjetër, bindja ndaj Allahut dhe bindja ndaj të Dërguarit të Tij, janë përmendur bashkë në Kuranin Fisnik: **“Thuaju: ‘Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit!’ Në qoftë se kthejnë shpinën, (dijeni se) Allahu, me të vërtetë, nuk i do jobsimtarët.”**⁸ Por, nëse dikush shprehet se i bindet Allahut Teala, por nuk i bindet Resullullahut, (a.s.), ajeti shprehet se ky veprim është qartazi kufër. Edhe në këto ajete Allahu Teala e ka përmendur veten bashkë me Pejgamberin, për sa i përket çështjes së bindjes: **“Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit, për të shpresuar mëshirën (e Allahut).”**⁹ Allahu i lartësuar e ka konsideruar bindjen ndaj Pejgamberit (a.s.), si bindje ndaj Tij: **“Kush i bindet të Dërguarit, i është bindur Allahut...”**¹⁰

Allahu Teala e ka konsideruar frytin e bindjes ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.), si udhëzim, duke u shprehur: **“Thuaj: ‘Bindjuni Allahut dhe bindjuni të Dërguarit!’ Nëse shmangeni, (ta dini se) ai është përgjegjës për detyrën e tij, ndërsa ju për atë që jeni ngarkuar. E, nëse i bindeni atij, do të jeni në rrugën e drejtë, kurse i Dërguari është i detyruar vetëm që të përcjellë qartë (Mesazhin Hyjnor).”**¹¹

Zoti (xh.xh.), përsëri shprehet në lidhje me pasimin e të Dërguarit të Tij: **“...Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!”**¹² Në të njëjtën mënyrë, Allahu i Madhëruar e ka konsideruar pasimin e Pejgamberit si kushtin për ta dashur

Suneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ngaqë është gjendja në praktikë e Kuranit Fisnik, përbën burimin e dytë bazë të Islamit, krahas Kuranit. Libri i Allahut Teala dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), si dy burime të pandashme, kanë mundësuar edhe formimin e strukturës shoqërore islame, por edhe vazhdimësinë e kësaj shoqëria, pa i humbur cilësitë.

Zotin dhe për të fituar faljen e Tij: **“Thuaju (o Muhamed): ‘Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’ju falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.”**¹³

Allahu i Lartësuar i ka urdhëruar myslimanët që ta ndjekin të Dërguarin e Tij edhe në çështjet që ka urdhëruar dhe ndaluar Pejgamberi: **“...Çfarëdo që t’ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t’ju ndalojë, hiqni dorë prej saj. Frikësojuni Allahut, sepse Allahu, dënon vërtet ashpër.”**¹⁴ Pastaj na ka pafjaljmaëruar që të mos e kundërshtojmë Pejgamberin, duke u shprehur: **“Le të frikësohen ata që kundërshtojnë urdhrin e tij, që të mos i arrijë ndonjë sprovë ose që të mos i godasë një dënim i dhembshëm.”**¹⁵

Përsëri Allahu Teala në Kuranin Fisnik i ka urdhëruar besimtarët që t’i përgjigjen thirrjes së të Dërguarit të Tij dhe çështjen në të cilën thërret i Dërguari e ka quajtur “jetë”.¹⁶ Përveç të tjerash, Kurani Famëlartë ka shprehur me fjalë të qarta se myslimanët duhet t’i drejtohen të Dërguarit të Allahut, (a.s.), kur të kenë mosmarrëveshje ndërmjet tyre¹⁷, se asnjë besimtar i burrë apo grua qoftë, nuk i është dhënë e drejta për të zgjedhur nëse dëshiron apo jo që ta pranojë gjykimin e Pejgamberit (a.s.)¹⁸, se nuk mund të jetë besimtar ai që nuk e pranon të Dërguarin e Allahut, (a.s.),

7. Nisa, 4/150-151.

8. Al Imran, 3/32.

9. Al Imran, 3/132; Nisa, 4/13; Nur, 24/51.

10. Nisa, 4/80.

11. Nur, 24/54.

12. A'raf, 7/158.

13. Al Imran, 3/31.

14. Hashr, 59/7.

15. Nur, 24/63.

16. Enfal, 8/24.

17. Nisa, 4/59.

18. Ahzab, 33/36.



si gjykues, apo që nuk e pranon me nënshtirim gjykimin e tij¹⁹, dhe se pranimi apo kundërshtimi i gjykimit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është guri i kufirit që ndan besimin nga hipokrizia²⁰.

Ndërkohë që e vërteta është e tillë, edhe në ditët e sotme, si në çdo periudhë tjetër, kanë dalë disa njerëz që e refuzojnë Sunetin me komentime të pabaza, duke mos u dhënë rëndësi këtyre ajeteve dhe shumë ajeteve të tjera të ngjashme me to.²¹ Ky hadith fisnik, që shpjeguesi i Tirmidhiut, Mubarekfuri, e ka cilësuar si “Delailu’n-Nubuvvet”²², këtë çështje e ka shpjeguar në një mënyrë shumë ndikuese dhe të qartë, duke i urdhëruar besimtarët që të mos kaplohen nga këto devijime djallëzore që janë pjesë e sprovës, dhe ta sistemojnë jetën e tyre sipas Sunetit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Mbi të gjitha, hadithi e shpreh qartë se në themelin e daljes kundër Sunetit gjenden vrazhdësia, ashpërsia, pasimi i nefsit, pëlqimi i vetes dhe ndjenja e të mos pasurit nevojë për Zotin. Ndërsa me shprehjen “i mbështetur në kolltuk”, hadithi nënkupton se ky veprim është i pahijshëm dhe larg edukatës së myslimanit²³, dhe është një shenjë e qartë që tregon se këto lloj veprimesh mund të bëhen vetëm nga njerëz që kanë mirëqenie të lartë. Edhe ajeti fisnik i Allahut Teala, në lidhje me këtë çështje, është shumë domethënëse: **“Por vërtet që njeriu shkel çdo cak kur mendon se është i vetëmjaftueshëm.”**²⁴ Gjith-

ashtu, shprehja mund të tregojë se këta njerëz do ta sulmojnë Sunetin duke u mbështetur te forca dhe fuqia e pushtetit.

Njerëzit që dëshirojnë të përfitojnë sa më shumë nga klasa sunduese/udhëheqëse, duke e sulmuar Islamin, ndërkohë që shfaqen sikur janë pro Kuranit Fisnik, duhet të njoftohen në lidhje me këto paralajmërime hyjnore: **“O ju që keni besuar! Mos nxitoni para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kijeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshëm.”**²⁵ Dhe: **“O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëritjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare.”**²⁶

Përveç të tjerash, shprehja “i mbështetur në kolltuk” mund të nënkuptojë edhe një njeri, të cilit nuk i ka mbetur fuqi të merret me punë të dobishme, dhe për këtë arsye merret me punë boshe. Kjo mund të jetë një shprehje plot urtësi që tregon se veprime të tilla janë krejt të pakuptimta.

Thënia: “Ne marrim çfarëdo që gjejmë në Kuran. Përveç tij nuk pranojmë gjë tjetër.”, është veçse një sjellje e gabuar, që e kanë pranuar ata që ndjekin dëshirat vetjake dhe që dëshirojnë të fitojnë vlerësimin e personave të cilëve u shërbejnë, duke e lënë mënjanë personin që është vërtet autoriteti i cili mund ta shpjegojë Kuranin, pra, të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Për këtë arsye, nefset e tërbuara të këtyre njerëzve do arrijnë nivelet e nefseve të politeistët të Mekës, që talleshin duke thënë: “Le të na vijë shpallja edhe neve!” Kështu që kuptohet qartë se ata dëshirojnë të thonë: “Tashmë e kemi radhën ne.”, sikur Suneti i të Dërguarit të Allahut të ishte i kufizuar në kohë. Poshtërsia e të gjitha këtyre veprimeve dhe mendimeve, është parashikuar krejt qartë nga goja e bekuar e të Dërguarit Allahut, (a.s.). Prandaj, absolutisht nuk mund të mendohet një Islam pa Sunet.

Shkrimin tonë le ta përfundojmë me këtë fjalë kuptimplotë të Omerit (r.a.): “Ne jemi të kënaqur që Allahu është Zoti ynë, Islami është feja jonë dhe Muhamedi (a.s.) është Pejgamberi ynë.”²⁷

19. Nisa, 4/65.

20. Nur, 24/47,48,51.

21. Xhanan Ibrahim, Kutubu’s-Sitteh, vëllimi i 16-të, fq. 461.

22. Tuhfetu’l-Ahvezi, VII, 425.

23. Ismail Lutfi Çakan, Të vërteta me hadithe, 2, fq. 138.

24. Alak, 96/6-7.

25. Huxhurat, 49/1.

26. Huxhurat, 49/2.

27. Nisa, 4/65; Nur, 24/47-50; Buhari, Ilm, 26; Deavat, 34; Fiten, 15; I’tisim, 3; Muslim, Iman, 56; Tirmidhi, Ilm, 10.

Çadër e madhe, çadër e vogël

— Nuredin Jëlldëz —

Zoti ynë, Allahu, është Zoti i botëve. I Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.), është dërguar si mëshirë për botët. Libri ynë, Kurani Fisnik është libër i përshtatshëm për të gjitha kohërat dhe vendet. Ummeti ynë është ummeti i të gjithë brezave deri në Kiamet. Sheriati ynë është tërësi ligjesh që përfshijnë të gjithë jetën.

Librat e ilmihalit fillojnë me çështjen e ujit dhe mbarojnë me çështjen që shpjegon ndarjen e trashëgimisë së atij që ka ndërruar jetë. Feja jonë e ka të përfshirë në trajtesë të gjithë jetën e njeriut. Ne kemi një fe që na i plotëson të gjitha nevojat në këtë univers, i cili është krijuar për të jetuar së bashku njerëzit, xhindët dhe krijesat e tjera. Në krenohemi me këtë aspekt gjithëpërfshirës të fesë sonë. I tillë është Islami. Kjo është edhe njëra prej garancive të dukshme të madhësisë dhe përhershmërisë së kësaj feje.

Feja jonë, Islami, me këtë strukturë të saj, është një ftesë që i është dërguar të gjithë njerëzimit. Nën çadrën e saj ka vend për të gjithë njerëzimin. Nën atë çadër, absolutisht ka vend për t'u strehuar të gjithë ata që ia kanë vënë synim vetes të qenit rob besimtar i Allahut Teala. Kjo është një e vërtetë, e cila shpjegon me gjuhën më të qartë faktin se Pejgamberi ynë i dashur, (a.s.), ka qenë dërguar si “më-

shirë për botët”. Kjo është një çadër e madhe ku të gjithë e kanë një vend. Kjo çadër është aq e madhe sa që i ka hapur vend nën hijen e saj edhe atij që ka vrarë njëqind njerëz. Kjo çadër i gjeti vend edhe birit të Ebu Xhehlit kur mësoi t'i drejtohej Zotit (xh. sh.). Për këdo që dëshiron të bëhet rob besimtar i Allahut, ka vend nën këtë çadër. Çadra jonë është e madhe. Ajo është aq e gjerë sa që mund të përfshijë të gjithë njerëzimin.

Kur perceptimi dhe stili i jetës së një myslimani të jetë në përputhje me gjerësinë e kësaj çadre, ai do të vishet me këtë identitet. Me këtë identitet do të forcojë edhe vëllazërinë në besim. Pastaj do të qëndrojë më afër stilit të jetës, prej të cilit është i kënaqur Allahu Teala.

Nëse myslimani e ngushton në mendjen e tij fushën e gjerë të kësaj çadre gjithëpërfshirëse, dhe nëse e sheh jetën nga çadra e vet e vogël, atëherë fusha që përfshin çadra e tij, me plot kuptimin e fjalës, do të jetë në kundërshtim me fushën që përfshin feja. Për shkak të ngushtësisë së mendjes së tij, ky njeri ngushton edhe fushën e gjerë të fesë, refuzon gjithçka për të cilën fton feja dhe kundërshton çfarë feja sugjeron. Ky qëndrim bie në kundërshtim me kushtet për të qenë mysliman, prandaj ky njeri jeton veç me iluzionin se Allahu është i kënaqur me të. Edhe nëse këtë e bën me nijet të mirë, fundi i tij është gjithsesi humbje.

Aq sa është e vërtetë se dalim jashtë kornizës së



fesë sonë nëse kërkojmë të ndryshojmë, përgjatë ndonjë periudhe, formën e namazit që ka caktuar Islami, po aq është e vërtetë se shkak për të ngelur jashtë fesë është edhe përpjekja për të bërë jetë fetare me çadra të vogla, nën çadrën e vëllazërisë që ka hapur Islami. Kjo ekuivalencë buron nga fakti se namazi dhe vëllazëria janë çështje të të njëjtit libër dhe të të njëjtave hadithe. Ai që jep urdhrat është Një. Për sa kohë të mos i shkrijmë identitetet etnike të ndryshme nën vëllazërinë e besimit, nuk mund të themi se bëjmë një jetë prej të cilës është i kënaqur Allahu (xh.xh.).

Ne duhet ta përfetojmë besimin pa e mohuar racën tonë, por duke e mbajtur nën hijen e kësaj çadre të madhe. Nëse shkelet parimi: “Arabi nuk ka ndonjë epërsi kundrejt atij që nuk është arab dhe ai që nuk është arab nuk ka ndonjë epërsi kundrejt arabit.”, që është shprehur edhe në Hytben e Lamtumurës, atëherë zëri i ezaneve që jehojnë në tokat tona na fton për në namaz, por mbetet i pafuqishëm për t’i bërë veshët tonë të aftë për të dëgjuar domosdoshmërinë e nënshtrimit ndaj Allahut Teala. Nëse e vërteta themelore që thekson ezani, nuk hyn në veshët tanë dhe nga aty nuk kalon në zemrat tona, Islami mund të mbetet një fe që nuk kuptohet.

Në lidhje me temën, mund të analizojmë historinë e “marrëveshjes së vëllazërisë”, që formoi i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ndërmjet muhaxhirëve dhe ensarëve, në periudhën e Medinës. Kjo marrëveshje u përket fillesave të hixhretit në Medinë, domethënë,

AI QË KA URDHËRUAR
NAMAZIN, KA URDHËRUAR
EDHE VËLLAZËRINË.
URDHRIN PËR VËLLAZËRI
E KA DHËNË PARA SHUMË
URDHRAVE TË TJERË.
NDËRSA ATYRE QË E
VËRTETUAN VËLLAZËRINË,
IU THA QË TË NDËRTONIN
CIVILIZIMIN. JA PRA,
ÇADRA E ISLAMIT ËSHTË
NJË ÇADËR TEPËR E MADHE.
KËTË MUND TA SHOHIM TE
QËNDRIMI NË ARAFAT, TE
TAVAFI RRETH E RROTULL
SHTËPISË SË ZOTIT /
QABESË, NË NAMAZIN E
XHUMASË DHE NË ÇDO
VEND KU KA BESIM NDAJ
ALLAHUT TEALA.

vitit të parë të hixhretit. Ndërsa dhjetëra urdhra të tjera si agjërimi, zekati, haxhi dhe mbulesa, të cilat janë prej adhurimeve më themelore të fesë sonë, janë dhënë në vitet e tjera të mëvonshme. Vëllazërinë në Medinë mund ta emërtojmë si një formim të civilizimit Islam. Shumë lehtë mund të shprehemi se urdhri për vëllazëri fetare, ka ardhur shumë para urdhrat për agjërim, madje edhe para urdhrat të zekatit, mbulesës dhe haxhit.

Së pari është urdhëruar besimi. Vëllazëria ndër-mjet atyre që besuan, u mor nën garancinë e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ajo vëllazëri u shndërrua në një legjendë, si një vepër e vërtetë. Besimtarët hapën shtëpitë dhe ndanë pasurinë e tyre me vëllazërit në besim. Në Medinë u përjetuan skena që mund të ndiqeshin me lot në sy. Civilizimi së pari u formua nëpër zemra. Prej këtyre zemrave u ndriçua Jethribi dhe u bë Medinë.

Rregulli është krejt i qartë:

Ai që ka urdhëruar namazin, ka urdhëruar edhe vëllazërinë. Urdhrin për vëllazëri e ka dhënë para shumë urdhrave të tjerë. Ndërsa atyre që e vërtetuan vëllazërinë, iu tha që të ndërtounin civilizimin. Ja pra, çadra e Islamit është një çadër tepër e madhe. Këtë mund ta shohim te qëndrimi në Arafat, te tavafi rreth e rrotull shtëpisë së Zotit / Qabesë, në namazin e xhumasë dhe në çdo vend ku ka besim ndaj Allahut Teala.

Sa më shumë që e ngushtojmë fushën e përfshirjes së kësaj çadre, qoftë edhe me nijet të mirë e pozitiv, në të vërtetë jemi të detyruar të kuptojmë se po e bëjmë të rrëshqitshme tokën në të cilën shkelim. Ata që e shohin të mjaftueshme çadrën e vogël, do të lagen, dhe si rezultat do të treten në shiun e acidit të devijimit, siç lagen dy veta kur hyjnë në një çadër të bërë për një njeri. Prandaj të gjithë së bashku jemi të detyruar të hyjmë nën çadrën e madhe të Islamit.



TË KUPTUARIT E SURES HUXHURAT

— Xhafer Durmush —



Në ajetet e para të sures Huxhurat thuhet: **“O ju që keni besuar! Mos nxitoni para (urdhrit të) Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe kjeni frikë Allahun! Vërtet, Allahu dëgjon gjithçka dhe është i Gjithëdijshëm. O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare.”** (Huxhurat, 1-2)

Kur marrim Kuranin në dorë dhe lexojmë suren Huxhurat, shohim se në këtë sure është vendosur struktura e shoqërisë model për njerëzimin. Kjo strukturë përbëhet nga tri relata kryesore:

E para: Detyrat që kemi kundrejt Allahut (xh.xh.), dhe të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Besimtarët duhet t’u besojnë dhe nënshtrohen krejtësisht urdhrave dhe ndalesave që janë dhënë në Kuranin Fisnik dhe Sunetin e Pejgamberit (a.s.). Ata nuk duhet të kalojnë para Allahut dhe të Dërguarit të Tij, në asnjë çështje. Siç e kanë vazhduar sahabët e nderuar respektin dhe besnikërinë ndaj të Dërguarit të Allahut, (a.s.), deri te rregulli për të ulur tonin e zërit, edhe ne sot jemi të obliguar që të kemi respekt për personalitetin e tij shpirtëror dhe Sunetin.

Gjithçka që urdhërohet në dy ajetet e para të sures fisnike, në të njëjtën kohë përbën edhe themelin e shoqërisë islame, sepse Islam do të thotë paqe dhe nënshtrim. Virtytet si bindja dhe respekti ndaj të mëdhenjve, në një shoqëri, forcojnë bashkimin dhe unitetin. Këto të fundit nxjerrin në pah fuqinë e kësaj shoqërie. Ndërsa mosbindja shkakton trazira dhe përçarje, të cilat bëhen shkak që shoqëria ta humbasë fuqinë e saj. Për këtë arsye, së pari në këtë sure fisnike është urdhëruar që të mos kalojmë në asnjë çështje para Allahut dhe të Dërguarit të Tij.

Ndërsa në ajetet që vijojnë, lajmërohen ata që ulin zërin në audiencën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.): **“Vërtet, ata që ulin zërin në prani të të Dërguarit të Allahut janë njerëzit, zemrat e të cilëve Allahu i ka kalitur për besim e për kushtim. Për ata ka falje dhe shpërblim të madh.”** (Huxhurat, 3) Sakaq, për ata që nuk e shfaqin këtë ndjeshmëri, thuhet: **“Vërtet, ata që të thërrasin ty (o Muhamed) me zë të lartë nga jashtë dhomave të tua, shumica e tyre nuk marrin vesh.”** (Huxhurat, 4)

E dyta: Marrëdhëniet njerëzore ndërmjet besimtarëve.

Këtu është urdhëruar largimi nga sjelljet dhe veprimet që çenojnë të drejtat e vëllazërisë, të cilat mund t’i radhisim si më poshtë:

Ne nuk duhet të marrim vendime duke i besuar lajmit që sjell një njeri i devijuar, por patjetër duhet të hulumtojmë për vërtetësinë e fjalëve të tij dhe të sigurohemi për të. Në të kundërt, pa e ditur mund t’i shkaktojmë dëm shoqërisë, ose mund të bëjmë veprime për të cilat do të pendohemi më vonë. Tashmë, në këtë kohë kur të vërtetat shndërrohen në të pavërteta me metoda që as nuk mund t’i imagjinojmë, mund të themi se një masë e tillë paraprake është shumë e rëndësishme.

Nëse dy popuj prej besimtarëve vendosen ballë për ballë me njëri-tjetrin dhe fillojnë të luftojnë, ne duhet t’i pajtojmë. Kjo është e detyrueshme për besimtarët. Nëse njëra palë e kalon cakun dhe e sulmon tjetrën, pala sulmuese duhet të luftohet derisa të kthehet te urdhri i Allahut (xh.xh.). Mbi të gjitha, duhet të veprojmë me drejtësi, sepse mbrojtja

e vëllazërisë fillon me mbajtjen e drejtësisë ndërmjet vëllezërve.

Qofshin gra apo burra, besimtarët nuk mund ta tallin njëri-tjetrin. Përçmimi i bashkëbiseduesit apo neglizhimi i tij, janë prej gjërave që lëndojnë më fort vëllain në fe.

Ne nuk duhet ta përçmojmë veten dhe nuk duhet ta thërrasim njëri-tjetrin me llagape të këqija. Nisur nga kjo, myslimani duhet të jetë modest, por veten nuk duhet ta përçmojë. Dinjitetin e të tjerëve duhet ta konsiderojë njësoj si dinjitetin e vet. Prandaj, askënd nuk duhet ta thërrasë me llagape negative.

Ne nuk duhet të krijojmë mendime të caktuara, me paragjykim, pa pasur informacionin e duhur në lidhje me çdo lloj çështjeje, sepse kjo mund të shkaktojë dëme të konsiderueshme që janë të vështira për t'i rregulluar, siç shkakton dëme edhe dhënia e vendimit duke u mbështetur te lajmi që e sjell një njeri i devijuar.

Ndalimi i racizmit. Racizmi është ai që shkakton më së shumti dëme ndaj bashkimit dhe unitetit ndërmjet besimtarëve. Racizëm do të thotë ndezje e zjarrit të përçarjes, që nuk mund të shuhet lehtësisht. Këtu, duke iu bërë e qartë njeriut se është krijuar nga Ademi dhe Havaja, i kërkohet që t'i ndjejë e t'i kuptojë urtësitë e ndarjes në popuj dhe fise. Gjithashtu theksohet se epërsia e vetme qëndron tek devotshmëria.

E treta: Marrëdhëniet e besimtarëve me njerëzit e tjerë.

“Të gjithëve duhet t’u japim vlerën e të qenit njerëz. Ne duhet të përpiqemi me mish e me shpirt për udhëzimin e tyre. Besimtarët duhet t’i sqarojnë çdo njeriu me të cilin bisedojnë, se mirësia më e madhe është nderimi me Islam dhe se kjo nuk mund të kraha-

sohet me asgjë.”¹ Në ajetin e katërmbëdhjetë, thuhet se kjo duhet të bëhet në përputhje me nivelin e njerëzve.

Ndërmjet parimeve që gjenden në suren Huxhurat, është edhe paralajmërimi që besimtarët nuk duhet të shfaqin sjellje apo veprime që i lëkundin ndjenjat e vëllazërisë dhe bashkimit, sepse vëllazëria fetare është një strukturë gjithëpërfshirëse që duhet të mbrohet me përpikëri. Vëllazëria fetare është një mirësi e madhe. Ndërsa mbajtja në jetë e këtyre strukturave domosdoshmërisht kërkon që njeriu t’ua dijë vlerën.

Kjo sure e begatë na njofton se ne mund të jetojmë vëllazërisht, me bindje dhe respekt, së pari ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe pastaj ndaj të mëdhenjve tanë. Ajo na mëson se duhet të kemi kujdes nga veprimet që e dëmtojnë vëllazërinë. Ja pra, kjo është rruga e të qenit një ummet që i ka hije të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

1. Hakk'in Daveti Kuran-i Kerim Meali ve Tefsiri, Prof. Dr. Omer Çelik, Botimet Erkam, Stamboll, 2013, vëll. 4, fq. 589.



DASHURIA NDAJ PEJGAMBERIT

Në suren Teube thuhet:

“Tashmë ju ka ardhur një i Dërguar nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për gjynahet që bëni ju, jua dëshiron të mirën me gjithë zemër që ju të shkonit rrugës së drejtë dhe është i butë e i mëshirshëm me besimtarët.” (Teube, 128.)

Dashuria gjithëpërfshirëse që i Dërguari i Allahut, (a.s.), kishte ndaj ummetit, shprehet me termin “haris”. Ndërsa dhembshuria dhe mëshira e tij, shprehen me cilësimet “rauf” dhe “rahim”, të cilat nuk janë përdorur për asnjë pejgamber tjetër.

Ne e dimë se i Dërguari i Allahut, (a.s.), na donte. Ai ka predikuar thirrjen e Zotit (xh.xh.), e cila na fton në Xhenetin e përhershëm. Ai na i ka hapur krahët, duke thënë që përtej dhjetëra shekujsh: “Vëllezërit e mi!” Pejgamberi ynë i nderuar e vazhdon këtë thirrje çdo ditë, me hadithet që kanë mbushur vëllime të tëra, dhe përpiqet të na mbrojë që të mos biem në zjarr. Siç shprehet edhe në Mevludin e Sulejman Çelebiut: Pejgamberi natë e ditë i përgjërohet Zotit duke thënë: “Ummeti im! Ummeti im!”

Ne gjithashtu e dimë se duhet t’i përgjigjemi me respekt dashurisë që zbret me dhembshuri nga të mëdhenjtë. Atëherë, le të shohim se çfarë kemi bërë për ta merituar dashurinë e të Dërguarit të Allahut, pagja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Allahu i Lartësuar e ka urdhëruar Pejgamberin që të thotë: *“Nëse e doni Allahun, më pasoni mua, në mënyrë që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë mëkatet.”* (Al ‘Imran, 31.) Atëherë, sa u rrimë besnikë Kuranit Fisnik dhe Sunetit në jetën tonë të përditshme? Sa përpiqemi që të fitojmë kënaqësinë e Zotit Mëshirëplotë dhe pëlqimin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), jo vetëm në kohë të caktuara, por përgjatë gjithë kohës? Sa shqetësohemi për ta mbartur shoqërinë në breza që edukohen me dashurinë e Pejgamberit (a.s.)?

Shpërthimi i filizave të farave të dashurisë nëpër zemrat tona, mund të bëhet duke i shumuar këto pyetje.



Ajjash ibn Ebi Rebia

- RADIJALLAHU ANHU -

— Mustafa Erish —

Ajjash ibn Ebi Rebia (r.a.), ishte një sahab që u nderua me Islamin para periudhës së “Daru’l-Erkamit”, në vitet e para kur dielli i Islamit lindi në Mekë!.. Ai gjendej në grupin e dytë të hixhretit për në Abisini. I Dërguari i Allahut, (a.s.), e dërgoi si lajmëtar tek mbreti i Himjerit (një popull në Jemen)!.. Gjithashtu, ishte edhe shoku i rrugës së Omerit (r.a.), në hixhretin për në Medinë!..

Ajjash ibn Ebi Rebia (r.a.), i përket degës Mahzumi të Kurejshëve. Ai lindi dhe u rrit në Mekë dhe përjetoi vitet e para plot vuajtje të Islamit, por duroi e rezistoi ndaj të gjitha shtypjeve dhe embargoeve. Ngaqë u torturua rëndë prej politeistëve, u detyrua të bënte hixhret, bashkë me bashkëshorten, për në Abisini, me grupin e dytë që shkoi atje. Biri i tij, Abdullahu, lindi atje. Pasi u kthye nga Abisinia, emigroi në Medinë së bashku me Omerin (r.a.). Ajjash ibn Ebi Rebia (r.a.), ishte djali i xhaxhait të Halid ibn Velidit (r.a.). Në të njëjtën kohë, ishte edhe vëlla nga nëna i Ebu Xhehlit- armikut të përjetuar të Islamit.

Pasi Ajjashi (r.a.), bëri hixhret në Medinë, vëllezërit e tij Ebu Xhehli dhe Harith ibn Hishami, i kurdishën një kurth, në mënyrë që ta kthenin në Mekë. I kërkuan të shkonte në Mekë, duke i thënë se nëna e tij ishte betuar se do të mbante zi derisa ta

shikonte përsëri të birin. Ai e konsultoi këtë situatë me Omerin (r.a.).

Omeri (r.a.), i tha se dukej që vëllezërit e tij nuk kishin nijet të mirë dhe e paralajmëroi që të mos bin-te në këtë kurth. Ajjash ibn Ebi Rebia el-Mahzumi (r.a.), vendosi të kthehej në Mekë me mendimin për të marrë një pjesë të pasurisë që i kishte mbetur atje, dhe për të vizituar nënën. (Usdu’l-Gabe, IV, 3081.)

Omeri, radijall-llahu anh, i dha edhe një mundësi vëllait të tij në besim, duke i thënë: “Tashmë ti e ke marrë një vendim! Të paktën merre devenë time, sepse është e shpejtë dhe e urtë. Gjithmonë qëndro mbi të. Nëse dyshon te njerëzit e tu, arratisu me të dhe shpëto!”

Ajjash ibn Ebi Rebia (r.a.), e pranoi ofertën, i hipi devesë dhe u kthye në Mekë së bashku me vëllezërit e tij. Pasi kaluan një pjesë të gjatë të rrugës, Ebu Xhehli iu afrua tinëzisht dhe i tha: “O vëlla! Për Zotin, kjo deve tashmë nuk po më mban dot! A nuk mund të më marrësh edhe mua në pjesën e pasme të devesë tënde?” Ajjashi (r.a.), pranoi dhe e uli devenë, krejt me sinqeritet e pastërti.

Kur zbriti nga kurrizi i devesë, dy vëllezërit e tij politeistë iu hodhën sipër dhe ia lidhën fort duart dhe krahët Ajjash ibn Ebi Rebia-s (r.a.). Pastaj e

çuan në Mekë, ku arritën kur zbardhi dita. Personave që dolën për t'i pritur, u thanë:

"O mekas! Kështu duhet të veproni edhe ju me të afërmit tuaj që s'kanë tru!"

Ajjashin (r.a.), e çuan te nëna e tij me duar dhe krahë të lidhura. Madje, Ebu Xhehli dhe Harithi e rrahën dhe për një kohë të gjatë nuk e lejuan që të kthehej në Medinë. (Ibn Is'hak, vëll. 2, fq. 119; Ebu'l-Fida, vëll. 3, fq. 172; Muhtasar Tarihi Dimeshk, XX, 54-58; Mustafa Asim Këksall, Historia Islame 2/296-298.)

Nisur nga kjo ndodhi e Ajjash ibn Ebi Rebia-s (r.a.), zbriti ky ajet fisnik: **"Ne e kemi urdhëruar njeriun, që të sillet mirë me prindërit e vet dhe: "Nëse ata të nxisin ty që të më shoqërosh Mua (në adhurim) atë, për të cilin ti nuk di asgjë, atëherë mos i dëgjo ata." Tek Unë do të ktheheni të gjithë e do t'ju lajmëroj për gjithçka që keni bërë."** (Ankebut, 8) (Alusi, Ruhul-Meani, XX, 139.)

Për arsyen e mësipërme, Ajjash ibn Ebi Rebia (r.a.), nuk mori pjesë dot në luftërat e Bedrit, Uhudit dhe Hendekut. I Dërguari i Allahut, (a.s.), u mërzit shumë për gjendjen e Ajjashit (r.a.), dhe të tjerëve që ndodheshin në të njëjtën situatë, dhe për një kohë të caktuar u lut në namazin e mëngjesit pasi ngrihej nga rukuja: **"O Allah! Shpëtoji nga duart e qafirëve Velid ibn Velidin, Seleme ibn Hishamin, Ajjash ibn Ebi Rebian, dhe të pafuqishmit e tjerë që gjenden në Mekë!"** (Muslim, Mesaxhid, 294-295.)

Pas një kohe të shkurtër, Velid ibn Velidi (r.a.), shpëtoi nga vendi ku mbahej i burgosur dhe shkoi në Medinë. Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), mësoi se Ajjash ibn Ebi Rebia dhe Seleme ibn Hishami jetonin duke u torturuar, e dërgoi përsëri Velidin në Mekë dhe e urdhëroi të arratisej së bashku me ta në Medinë. Kështu ata u bashkuan me myslimanët që po ktheheshin nga "umretu'l-kaza", dhe pas një udhëtimi tre ditor shkuan në Medinë.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte lutur pesëmbëdhjetë ditë për ta dhe në mëngjesin e Fitër Bajramit e kishte ndaluar këtë lutje. Kur Omeri (r.a.), e pyeti për shkakun e lënies së lutjes, Pejgamberi ynë i nderuar iu përgjigj: **"A nuk e di se ata kanë ardhur?!"**

Pikërisht në ato momente u hap rruga. Velid ibn Velidi po sillte shokët e tij. Ai, radijall-lahu anh, doli në audiencën e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), teksa po merrte frymë me vështirësi. Pastaj ia dorëzoi shpirtin Zotit (xh.xh.). I Dërguari i Allahut, (a.s.), deklaroi për Velidin (r.a.): **"Ky njeri është dëshmor. Unë jam dëshmitar për këtë!"** (Shik. EbuDavud, Vitir, 10/1442; Bejhaki, Sunen, II, 200.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), pas luftës së Tebukut e dërgoi Ajjash ibn Ebi Rebiael-Mahzumin (r.a.), si

korrier te mbretërit që gjendeshin në vendet rreth e rrotull. Mbretit të Himjerit dhe Hemedanit ua çoi letrat me anë të këtij sahabi.

Kur i Dërguari i Allahut, pagja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ia dha letrën Ajjash ibn Ebi Rebia el-Mahzumit (r.a.), i dha edhe këtë këshillë: **"Kur të shkosh te vendi i tyre, mos hyr natën. Pasi të presësh deri në mëngjes, merr një abdest të mirëfilltë dhe fal dy rekatë namaz. Kërko nga Allahu shpëtim, pranim dhe mbrojtje. Letrën jepua atyre me dorën e djathtë dhe nga ana e djathtë. Kur të të pranojnë, këndoju suren Bejjine!"**

Bismil-lahirr Rrahmanirr Rrahim

1. Ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, nuk do të largoheshin (nga mosbesimi i tyre), **derisa t'u vinte Dëshmia e qartë:**

2. Një i Dërguar nga Allahu, i cili t'u lexonte faqe të pastra (Kuranin),

3. të cilat përmbanin rregulla të drejta.

4. Ata, që u ishte dhënë Libri, u përçanë vetëm atëherë, kur u erdhi Dëshmia e qartë.

5. E megjithatë, ata qenë urdhëruar vetëm që të adhuronin Allahun me përkushtim të singertë, duke qenë në fenë e pastër (të Ibrahimit), **si dhe të falnin namazin e të jepnin zekatin. Kjo është feja e drejtë.**

6. Në të vërtetë, ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të hyjnë në zjarrin e Xhehenemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija.

7. Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira – pikërisht ata janë krijesat më të mira.

8. Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë. Allahu është i kënaqur me ata, por dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet."

"Pasi ta mbarosh këndimin e sures, thuaju: "Unë i kam besuar Muhamedit dhe jam i pari prej atyre që i besojnë atij!"

Çdo argument që ata mund të të sjellin ty, nuk mund të qëndrojë përpara këtyre! Çdo libër të shndritshëm që mund të të sjellin, do ta ketë ndriçimin e venitur. Kur ata të të lexojnë ndonjë gjë në gjuhët e tyre, thuaju: "Allahu më mjafton!" Pastaj lexoju këtë ajet: "Andaj, ti thirru dhe bëhu këmbëngulës, ashtu siç je urdhëruar, mos i ndiq epshtet e tyre dhe thuaj: "Unë besoj çdo libër që e ka shpallur Allahu dhe jam urdhëruar që të gjykoj drejt midis jush; Allahu është Zoti ynë dhe Zoti i juaj. Veprat tona janë për ne, e veprat tua janë për ju. Midis nesh dhe jush nuk ka kurrfarë mosmarrëveshjeje.

Allahu do të na tubojë të gjithëve dhe tek Ai do të kthehemi të gjithë.” (Shura, 15.)

Ajjash ibn Ebi Rebia (r.a.), rrëfen: “Bëra siç më urdhëroi i Dërguari i Allahut, (a.s.). Kur shkova aty, ata kishin veshur rroba të zbukuruar. Unë u thashë: “Unë jam i dërguari i Muhamedit!” Ata më pranuan siç më pati thënë i Dërguari i Allahut, (a.s.).” (IbnSa’d, Tabakat, vëll. 1, fq. 282-283. Mustafa Asim Këksall, Historia Islame, 7/370-372.)

Ajjash ibn Ebi Rebiael-Mahzumi (r.a.), ka transmetuar disa hadithe nga i Dërguari i Allahut, (a.s.). Këto hadithe gjenden në Musnedin e Ahmed ibn Hanbelit (III, 420; IV, 347.) dhe në Sunenin e Ibn Maxhes (Menasik, 103.). Njëri prej këtyre haditheve është:

Ajjash ibn Ebi Rebiael-Mahzumi (r.a.), tregon: I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: “Ky ummet do të vazhdojë të marrë mirësi, deri kur të respektojë siç duhet Mekën dhe Qabenë. Kur të mos e shfaqin këtë respekt, do të shkatërrohen.” (IbnMaxhe, Menasik, 103.)

Ajjash ibn Ebi Rebiael-Mahzumi (r.a.), ndërroi jetë në Sham përgjatë kohës së kalifatit të “Emiru’l-Mu’minin”, Omerit (r.a.), i cili ishte shoku i tij përgjatë udhëtimit të hixhretit në Medinë. Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Allahu i madhëruar na bëftë të gjithëve prej mbrojtësve të imanit, që nuk bëjnë lëshime në besim dhe që e kryejnë siç duhet detyrën që marrin përsipër, si Ajjash ibn Ebi Rebiael-Mahzumi, radijall-llahu anh. Amin!

LETRA E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT, (A.S.):

“Bismi’l-lahi’rr-Rrahmani’rr-Rrahim.

Nga i Dërguari i Allahut, Muhamedi,

*Për te Harith ibn Abdi Kulali, Nuajm ibn Abdi Kulali
dhe te mbreti i Meafirit dhe Hemedanit, Nuajmi!..*

E falënderoj Allahun, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër, që iu ka udhëzuar. Tashmë duhet ta dini se pasi u kthyem nga toka e Bizantit, i dërguari juaj u takua me ne. Ai na tregoi për arsyen pse e kishit dërguar dhe na dha informacion për ju. Na njoftoi se keni hyrë në fenë islame dhe se po luftoni me politeistët. Nëse i bindeni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, falni namazin, jepni zekatin, jepni një të pestën që i përket Allahut nga plaça e luftës, jepni pjesën e të Dërguarit të Allahut, jepni mallin e zgjedhur për t’ia dhënë atij, jepni lëmoshën që është farz për besimtarët dhe një të dhjetën e të mbjellave që vaditen me ujë burimi dhe shi, do të thotë se Allahu i Lartësuar ju ka vendosur në rrugë të drejtë. Ndërsa ata që kanë mbetur në fenë çifute dhe të krishterë, nuk mund të nxirren me imponim nga fetë e tyre. Çdo burrë apo grua, i lirë apo rob, që hyn në moshën e pubertetit, do të jetë i obliguar të paguajë taksë, plot një dinar, sipas vlerës së Meafirit (rrobë e Jemenit), apo vlerës së një rrobe të njëjtë me të. Ai që ia paguan këtë të Dërguarit të Allahut, do të jetë nën mbrojtjen e Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Kushdo që e refuzon këtë, do të jetë armik i Allahut dhe i Dërguarit të Tij.” (IbnIs’hak, vëll. 4, fq. 236.)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), në letrën e dytë shkroi:

“Nëse do t’i besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të keni paqe dhe siguri. Padyshim se Allahu, që është Një dhe nuk ka të ngjashëm me Të, e dërgoi Musain me ajetet (mrekullitë) e Tij. Isain e krijoi me fjalët e Tij. (Por) Çifutët thanë: “Uzejri është biri i Allahut!” Edhe të krishterët thanë: “Allahu është njëri prej Trinisë. Isai është biri i Allahut!”

Kapërcimi i pengesave

— Ferudun Ozdemir —

Një njeri i paaftë për të kapërcyer pengesat në jetën e tij shkon tek një i njeri i urtë dhe i thotë: “Nuk arrij të kapërcej asnjë pengesë në jetë. Çfarë duhet të bëj?” I urti e merr për dore dhe i kërkon të vështrojë nga dritarja. Aty sheh një flutur që po përpëlitej për të dalë jashtë duke tundur pareshtur flatrat e saj. Edhe pse përpiquej të dilte, ajo përsëri përfundonte duke u përplasur në xhamin e dritares. I urti i afrohet ngadalë dhe hap pak dritaren në mënyrë që ta ndihmojë fluturën të fitojë lirinë. Por edhe kjo pa dobi! Ajo provoi sërish të fluturonte por gjithnjë përplasej pas xhamit.

I urti kthehet dhe i thotë:

“Flutura pandeh se e vetmja mënyrë për të dalë jashtë është kalimi përmes xhamit, i cili në fakt është vetë pengesa. Nëse do të shikonte nga një kënd tjetër, do ta kuptonte që dritarja ishte e hapur. Por ajo e ka burgosur veten në këtë dhomë sepse si rrugëdalje shikon vetëm xhamin.”

Nganjëherë jeta na përball me pengesa që nuk arrijmë t'i kapërcejmë. Në këtë rast ajo çfarë duhet të bëjmë është të hedhim një hap prapa dhe të mendojmë me mendje të qetë. Më pas të kërkojmë dhe të gjejmë një rrugëdalje pasi të kemi fituar një tjetër këndvështrim duke e parë jetën ndryshe...

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI





PËR TA MBAJTUR TË
GJALLË DHE PËR TA
BËRË PRODUKTIVE
PEMËN E NJERËZISË,
DUHET TA VADISIM JO
ME GJAK DHE LOT, POR
ME UJIN E MËSHIRËS
DHE DASHURISË.
ANGAZHIMI ME
DALLIMET SI GJINIA,
NGJYRA, GJUHA, RACA
DHE VENDI, SJELLIN
SHKËPUTJE NGA
RRËNJËT. E ASNJË
GJALLESË ME RRËNJËT E
THARA, NUK KA SHANSE
TË JETOJË!

Identiteti i përbashkët i njeriut dhe Islamit

— Ali Riza Temel —

Veçoritë, të cilat e diferencojnë një njeri nga të tjerët, përbëjnë identitetin. Edhe pse të gjithë si individë zotërojmë një identitet të pavarur, ekzistojnë edhe identitete të përbashkëta që na përfshijnë të gjithëve.

Të qenit njeri është identiteti më i lartë i të gjithë qenieve njerëzore. Nisur nga të qenit njeri, të gjithë formojnë një familje, edhe pse mund t'i kenë të ndryshme gjinitë, ngjyrat, gjuhën, racën dhe vendin. Siç ka thënë Sa'di: "Fëmijët e Ademit janë si organet e një trupi." Njësimi i Krijuesit shpreh edhe unitetin e krijesave. Ky unitet shprehet kështu në Kuranin Fisnik:

"O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj, i Cili ju krijoi prej një njeriu, ndërsa prej atij krijoi bashkëshorten e tij, kurse prej këtyre të dyve krijoi shumë meshkuj e femra..." (Nisa, 1.) Fillimi i ajetit me shprehjen "O njerëz", përfshin të gjithë familjen e njerëzimit. Edhe shprehja e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në formën: "Ejjuhen'-nas/O njerëz!", në hytben e lamtumirës, tregon të njëjtën të vërtetë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), në këtë hytbe ka thënë: "Zoti juaj është Një. Babai juaj është një. Që të gjithë jeni prej Ademit. Ndërsa Ademi është nga dheu." Edhe në një hadith tjetër, Pejgamberi ka thënë: "Të gjitha krijesat janë si individët e familjes së Allahut. Më të dashurit prej këtyre, janë ata që kanë më shumë dobi për individët e familjes." (Mundhiri,

Istinau'l-ma'ruf, hadithi nr: 1.)

Krahas këtij identiteti sublim, ne si myslimanë kemi edhe identitetin e ummetit. Edhe pse gjinitë, racat, gjuhët, ngjyrat dhe kombësitë janë të ndryshme, përkatësia jonë më e fortë është Islami. Asnjë ndryshim nuk mund ta lëkundë dhe nuk duhet ta prishë këtë përkatësi dhe identitet të përbashkët. Fakti që gjuhët, ngjyrat, fiset dhe popujt janë të ndryshëm, nuk është shkak për ndarje dhe armiqësi. Përkundrazi, këto ndryshime duhet të jenë shkak për pasurim, njohje dhe miqësi. Këtë e shpreh edhe Zoti (xh.xh.), në Kuranin Fisnik: **"O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin..."** (Huxhurat, 13.)

Racizmi vjen në krye të faktorëve që e lëkund unitetin dhe bashkimin e myslimanëve. Sigurisht që njeriu nuk duhet ta mohojë origjinën, familjen, farefisnin dhe prejardhjen e vet, por nxjerrja e racës në plan të parë dhe hedhja e Islamit në plan të pasmë, është një fitne e madhe. Edhe nxjerrja në plan të parë e medhhebit është e njëjta gjë. Përgjatë gjithë historisë, por edhe në ditët e sotme, dëmin më të madh si myslimanë e kemi pasur prej racizmit dhe medhhebizmit.

Tashmë le të shfaqim një veprim dhe shembull interesant në lidhje me identitetin e përbashkët Islam: Të

gjithë prej nesh e njohim Selman el-Farisiun (r.a.), i cili ishte një prej sahabëve të nderuar. Le të bëjmë një përmbledhje të shkurtër në lidhje me të dhe identitetin e myslimanit, në mënyrë që të na freskohet memoria:

Selman el-Farisiu (r.a.), ishte me origjinë perse dhe vinte nga një familje e pasur dhe fisnike. Ai i përkiste besimit zoroastrian (sipas së cilit adhurohet zjarri). Gjatë detyrës për ta mbajtur të ndezur zjarrin e shenjtë në tempull, filloi të kërkonte një fe të re. Ai përvetësoi krishtërimin, pavarësisht kundërshtimit të ashpër të familjes së tij. Ai shkoi në Musul, në Nusajbin dhe pastaj në Ammure. Ndërsa një prift, me të cilin Selmani (r.a.) ishte njohur, po dergjej në shtratin e vdekjes, e njoftoi atë se shumë shpejt në gadishullin arabik do të dërgohej një peygamber, që do t'i përkiste fesë së pastër të Ibrahimit (a.s.). Gjithashtu prifti e njoftoi Selmanin (r.a.), edhe për disa shenja të këtij peygamberi. Selmani bëri marrëveshje me një tregtar arab, që ta kalonte në shkretëtirë. Por kur karvani arriti në "Vadil-Kura", tregtari me të cilin kishte bërë marrëveshje, e shiti atë si skllav te një çifut. Edhe ky i fundit e shiti Selmanin (r.a.), te një çifut prej Medine. Kur Selman el-Farisiu (r.a.), ishte në Medinë, dëgjoji se Peygamberi (a.s.), kishte ardhur. Kështu që shkoi në Kuba dhe pa shenjat e profecisë për të cilat ishte njoftuar. Pastaj menjëherë u bë mysliman. Ai bëri një marrëveshje me zotërinë e tij për të shpëtuar nga robëria. Për lirinë e tij do të mbillte treqind fidanë hurmash dhe do të paguante dyzet ukijje (lloj paraje). Me ndihmën e sahabëve dhe përkujdesjen e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), Selman el-Farisiu (r.a.), u lirua pasi u mbollën treqind fidanë hurmash dhe u paguan dyzet ukijje nga "Bejtu'l-Mal". Ai u bë vëlla me Ebu'd-Derdanë (r.a.). Selmani (r.a.), mori pjesë në luftën e Hendekut dhe në luftërat e tjera pas saj. Hapjen e hendekut e pati propozuar ai vetë. Omeri (r.a.), i pati lidhur një rrogë atij. Por Selman el-Farisiu e shpërndau si lëmoshë rrogën dhe e siguroi jetesën duke shitur hasrat që i thurte me fijet e hurmave. Pastaj, ai u emërua prefekt i Medainit, nga Omeri (r.a.). Edhe përgjatë kohës kur ishte prefekt, jetoi me modesti. Ata që nuk e dinin se ai ishte prefekti, i jepnin ngarkesa për t'i mbartur, ngaqë pandehnin se ishte hamall. Ndërsa ai nuk u tregonte se ishte prefekti. Për sa i përkiste pasurisë së kësaj bote, si një udhëtar, ai besonte se duhej të kishte pasuri sa ngarkesa e një deveje, dhe kështu jetoi.

Ndërsa çështja që në fakt duam të shtjellojmë, është përkushtimi i veçantë i tij ndaj Islamit. Për këtë arsye, veten e ka prezantuar si Selman ibn Islami.

Kujtimi i këtij emri është siç vijon:

Në një kuvend ku gjendej edhe Selman el-Farisiu (r.a.), ndërmjet ensarëve dhe muhaxhirëve u kërkuar që të tregoheshin prejardhjet. Të gjithë filluan të tregonin gjerë e gjatë për prejardhjet e tyre. Kur i erdhi radha Selmanit (r.a.), tha: "A dëshironi të dini prejardhjen time? Falënderimi i takon Allahut që më ka nderuar me Islamin. Për këtë arsye, unë jam Selman ibn Islami." Me këtë qëndrim ai u bëri të qartë se të qenit arab

apo pers nuk ka asnjë kuptim dhe se përkatësia e vërtetë është ajo e Islamit. Kur Omeri (r.a.), dëgjoji se Selmani (r.a.), ishte ofenduar nga çështja e prejardhjes, menjëherë shkoi atje dhe dha këtë mesazh:

"Siç e dinë edhe Kurejshit, babai im Hattabi ka qenë njëri prej njerëzve më të zgjedhur të periudhës së injorancës. Këtej e tutje mos më thërrisni me emrin e babait, sepse edhe unë jam Omer ibn Islami, pikërisht si vëllai im Selman ibn Islami."

Kur Omeri (r.a.), u shpreh në këtë mënyrë, nuk dëshironte të mohonte prejardhjen e tij, por t'u jepte një mësim atyre që lavdëroheshin me prejardhjen e vet. Sipas tij, krenaria dhe nderi i njeriut para së gjithash buron nga Islami, në të cilin përket.

Omeri (r.a.), e konsideroi Selman el-Farisiun (r.a.), si vëlla në Islam. Edhe pse Selman el-Farisiu (r.a.), u pranua si vëlla në besim dhe u emërua si prefekt nga Omeri (r.a.), për shkak të marrëdhënieve të vëllazërisë së vërtetë, ai nuk hezitoi asnjëherë ta qortojë Omerin (r.a.).

Transmetohet se Omerit (r.a.), i ishin dërguar copa si plaçkë e luftës. Ai ua ndau të gjithëve në një masë, sa për të dalë një rrobë. Pastaj doli në minber. Veshur kishte një rrobë me një pjesë sipër dhe një pjesë poshtë. Kur tha: "O njerëz! A mund të më dëgjoni?", Selman el-Farisiu (r.a.), i tha: "Nuk të dëgjojmë." Kur Omeri (r.a.), e pyeti për shkakun, Selmani (r.a.), iu përgjigj: "Ti na ke shpërndarë nga një pjesë prej copës, ndërsa vetë ke dy pjesë." Omeri (r.a.), i tha: "Mos u nxito, o robi i Allahut!" Pastaj i tha birit të tij, Abdullahut: "M'u përgjigj për hir të Allahut! A nuk është e jotja kjo rrobë që kam veshur?" Abdullahu (r.a.), iu përgjigj: "Po." Pastaj Selmani (r.a.), i tha: "Tani fol! Po të dëgjojmë." (Ibnu'l-Xhevzi, Sifetu's-Safve, 1/533.)

Selman el-Farisiu (r.a.), e vendosi në plan të parë identitetin islam dhe jetoi në përputhje me këtë identitet, ishte një njeri që duhej nga të gjithë, duke përmendur këtu në radhë të parë të Dërguarin e Allahut, (a.s.). Selmani (r.a.), fitoi edhe lavdërimin e Peygamberit (a.s.), i cili tha: "*Selmani është prej meje dhe prej Ehli Bejtit/pjesëtarëve të familjes sime.*"

Nëse do të mbrohej dhe respektohej identiteti njerëzor në përgjithësi dhe identiteti islam në veçanti, padrejtësitë dhe armiqësitë do të pakësoheshin ndjeshëm. Në këtë mënyrë, do të gjallërohej uniteti, harmonia dhe miqësia, të cilën e duan të gjithë. Gjaku dhe lotët nuk do të derdheshin më. Por ja që pema e njerëzimit ka filluar të thahet dhe nuk i jep dot frutat që priten prej saj, për shkak se është harruar ky identitet, dhe njerëzit kanë filluar të interesohen me degët, duke i neglizhuar rrënjët e trungun.

Për ta mbajtur të gjallë dhe për ta bërë produktive pemën e njerëzisë, duhet ta vadisim jo me gjak dhe lot, por me ujin e mëshirës dhe dashurisë. Angazhimi me dallimet si gjinia, ngjyra, gjuha, raca dhe vendi, sjellin shpëputje nga rrënjët. E asnjë gjallesë me rrënjët e thara, nuk ka shanse të jetojë!



KURRKUNDI DHE PRITSHMËRIA

— Nuredin Nazarko —

Fëmijë. Koha rrjedh. Rritesh. Bëhesh prind. Kupton se çfarë sfide shtrihet para teje. Kupton se me çfarë sfide janë ndeshur prindërit e tu, kur ti ishe ende fëmijë. Telashet nuk do të kenë të sosur. Tashmë e ke kuptuar se jo çdo gjë mbaron kur fëmija yt rritet. Si prind je i shqetësuar për të, deri në frymën e fundit. Gjithsesi nuk duhet harruar se ka përjashtime edhe në këtë sferë. Nuk është e lehtë të jesh prind. Nuk është aventurë për kalim kohe. Sido që të jetë perceptimi i të përjashtuarve nga rregulli përgjithshëm, asgjë nuk ndryshon në rëndësinë thelbësore që ka prindërimi.

Pritshmëritë e prindërve janë në nivel të lartë. Presin nga fëmijët e tyre gjëra të mëdha. Ndoshta realizimin e ëndrrave të tyre të parrealizuara. Besojnë se fëmijët e tyre janë prerë për të kthyer në realitet ëndrrat e një kohe të kaluar tashmë. Projektojnë aty dëshirat e tyre, dhe shpresojnë që një ditë t'i shohin të realizuara. Sforcohen në kërkesat që shtrojnë ndaj tyre për rezultate të shkëlqyera. Madje ka syresh që iu injektojnë idenë e ekselencës, dhe nuk ndalen derisa fëmija i tyre të përmendet si i tillë. Trysnia është e dukshme. Fuqia e saj varion sipas rasteve. Sidoqoftë pasojat e saj nuk janë aspak pozitive. Kjo sjellje krijon individë të cilët besojnë se janë superiorë vetëm sepse i kanë të gjitha vlerësimet dhjeta. U krijon bindjen e gabuar se vetëm ata dinë. Ndihen sikur janë pronarë të diturive. Hyjnë në garë të ethshme me bashkëmoshatarët. Garë që nxit zili të panevojshme, qysh në moshë të njomë. Fuqizon gërryerjen e vlerave që duhet të karakterizojë qenien njerëzore në raport me qeniet e tjera. Rrit përcëimin për atë që s'di, duke e treguar me gisht si inferior. I bind se janë superiorë dhe kështu nënçmojnë aftësitë e shumë syresh në sfera të tjera të veprimtarive njerëzore. Sa e sa të paragjykuar nga shoqëria e superiorëve janë shndërruar në njerëz produktivë në sfera që as vetë si mendonin. Sekush ka rriskun e vet, të cilin do ta gëzojë me patjetër.

Kjo është jashtë dëshirës së superiorëve. Po kush mban përgjegjësi për nxitjen dhe fryrjen e këtij lloj zjarri? Përse fëmijët duhet të hanë inat me njëri – tjetrin për të zënë vendin e ekselentit? A nuk është e mundur të binden se nuk është detyrim jetësor përmendja e emrit si më i dituri apo më e ditura? A nuk duhen bindur se të qenit më i ditur është vlerë dhe përgjegjësi, dhe jo element mburrje në sy të të tjerëve nga ana e prindërve?

Pritshmëritë janë të mëdha. Kërkimi i llogarisë nga prindërit është një nga gjërat më të thjeshta që mund të realizohet. Është krejt e kollajtë mprehja e lapsit të kritikës dhe kryqëzimit. Mund të themi se kjo është një nga gjërat që realizojnë më me qejf prindërit dhe fëmijët në raport me ata që i mësojnë. Mangësi ka kudo. Edhe në punën e mësuesve e pedagogëve ka plot mangësi. Tek e fundit jetojmë në një shoqëri që ka defiqte të mëdha. Ka sfida të mëdha në epokën e revolucionit informatik. Vjen nga një prapambeturi dhe izolim që thau palcën e kulturës. Nuk janë pak këto kobe të së shkuarës, që kanë lënë gjurmë të pashuara tek brezi i prindërve të rinj. Janë gjurmë që japin ndikimet e tyre në perceptimet që kanë shumë syresh mbi mënyrën si funksionon sot shkolla. Ka prej tyre që kujtojnë ende kohën kur hanin dajak dhe rrinin sus para mësuesit. Pastaj thonë që kishte respekt atëherë. Kishte respekt se ishin të bindur në këtë apo i kishte bindur dajaku?

Pritshmëritë janë të mëdha. Defiqtet që kemi si shoqëri nuk duhet t'ia faturojmë vetëm mësimdhënësve, sikur ata të jenë e keqja e madhe e këtij vendi dhe vetëm prej tyre fëmijët nuk po ecin para. Po, a nuk janë të njëjtët që mësojnë si nxënësit që nderojnë veten si ata që aq e kanë takatin, por mund të jenë të mirë në një sferë tjetër? Të njëjtët janë. Përse përgjegjësia shkelmohet si top dhe ata që duhet ta mbajnë janë mësimdhënësit? Po prindi ku e ka rolin e tij si edukator? Shumë mirë bëjnë

që kalojnë në lupë apo në sitë punën e mësimdhënësve. Po punën e tyre a e kalojnë në të njëjtën sitë? Lupë? Apo për ta nuk ka rëndësi kjo pjesë? Si e perceptojnë prindërimin? A është e mjaftueshme vetëm t'i ushqesh? T'i veshësh? Po në përcimin e vlerave ç'rol duhet të luajë familja? Prindërit? Çfarë idesh u përcjellin fëmijëve të tyre që në vogëli? Çfarë qëndrimesh morale iu frymëzojnë?

Pritshmëritë janë të mëdha. Prindërit kërkojnë të gjejnë justifikim të dështimeve të tyre me fëmijët. Fajtori gjendet lehtë. Shkolla. Mësimdhënësit. Ata janë shkak. Tjerrin gjithfarë fantazish. E theksuam që probleme ka. Defiçite ka. Por shtrohen pyetje thelbësore, që prindërit e sotëm nuk duhet t'i shmangin kurrse. Jo për shkollën. As për mësimdhënësit e çdo niveli. Por për të mirën e fëmijëve të tyre sot dhe të kombit nesër.

Cili është modeli përmes të cilit frymëzojmë fëmijët tanë për të qenë njerëz me vlera? Çfarë quajmë vlera sot? A kemi ndryshuar ne si prindër perceptimin mbi vlerat? Apo ndoshta jemi vetë të papërgatitur për të përballur sfidën e prindërimit në epokën e teknologjisë?

Këto pyetje kërkojnë përgjigje, jo vetëm nga prindërit. Por i vendosim prindërit në radhë të parë, sepse ata janë modeli nga ku fëmijët përthithin qëndrimet morale. Nëse prindërit do ta zhbëjnë këtë përgjegjësi të tyre, detyra e institucioneve të tjera do të vështirësohet gjithmonë e më tepër. Nuk është e thjeshtë t'i shkulësh rrënjët e një modeli të përbrendësuar tek fëmija kur ai rritet. Është një nga operacionet më të vështira. Shpesh ndodh të mos ketë sukses. E në çastin që s'ka sukses, fajtori gjendet lehtë dhe ia hodhëm përgjegjësisë. Prindi nuk duhet të sillet kurrse sipas kësaj logjike. Nëse vepron kështu, vetëm e dëmton fëmijën e vet, sepse shndërrohet në avokat të gabimeve të fëmijës. Duke bërë avokatin e fëmijës, bën dhe avokatin e vetvetes. Indirekt hedh poshtë përgjegjësitë e tij si prind në përcimin e vlerave morale. Hasen fëmijë mashtrues dhe intrigantë që të lënë pa fjalë me djallëzinë që i karakterizon. Kush mban përgjegjësi për këto vese që kanë zënë vend në shpirtin e tyre? Shkolla? Shoqëria? Po prindi ku është këtu? Përse shumë prindër kujtohen për mbarëvajtjen e fëmijëve të tyre vetëm kur këta të fundit dalin duarsh dhe bëhen të pakontrollueshëm në sjelljen e tyre?

Pritshmëritë janë të mëdha. Era e teknologjisë po bën të vetën. Është një mundësi e artë për të mësuar. Po ashtu është dhe një nga ngrënësit më të mëdhenj të kohës. Shoqëria është e ekspozuar tërësisht ndaj kësaj vorbulle. Cili është roli prindërve në këtë sfidë? A janë të përgatitur për të menaxhuar situatën apo

edhe ata vetë janë të përfshirë nga vorbulla? Sa kohë shpenzojnë fëmijët me mjetet teknologjike pasi kthehen nga shkolla, universiteti? Sa kohë shpenzojnë për leximin e librave? Po me televizionin? Sa prej programeve të transmetuar kanë efekt çrregullues tek sjelljet e fëmijëve? A janë censurues të mirë prindërit apo lejojnë fëmijët të ndjekin programe krejt të papërshtatshme për moshën e tyre? Nëse ndodh kështu a nuk janë duke mbajtur një peshë që nuk i takon? Një peshë stimulante e sjelljeve jokorrekte e injektuar edhe me indiferencën e prindërve ndaj mesazheve që përçojnë programet që i fryjnë zjarrit të lirisë pa kufi për shijimin e jetës.

Pritshmëritë janë të mëdha. Ngrënësi i madh i kohës bën të vetën. Krejt heshtur prindërit kapitullojnë. Ashtu nën zë sakrifikojnë për t'u siguruar mjete teknologjike fëmijëve të tyre, pa e kuptuar ndoshta se janë duke i hedhur fëmijët e tyre drejt një rreziku fatal për personalitetin e tyre. Çfarë mund të bëjë shkolla, universiteti, mësimdhënësit në këtë rast? A nuk janë prindërit përgjegjës për kontrollin pozitiv që duhet të ushtrojnë ndaj fëmijëve të tyre? A nuk duhet t'iu tregojnë se ka limite, ka kufij që duhen respektuar dhe duhet ndalur? Kush mund t'i kufizojë pas orarit të mësimi? Shkolla? Mësimdhënësit? Kush do t'i shtrojë në punë pas orarit të përfundimit të mësimi? Kush do t'ua heqë nga duart mjetet teknologjike kur janë bash në shtëpinë e tyre? A nuk ndihen përgjegjës këta prindër për helmin mediatik që lejojnë të depërtojë tek fëmijët e tyre? A nuk ndihen përgjegjës këta prindër që lejojnë fëmijët e tyre të shohin e dëgjojnë 24 orë në 24, të ashtuquajturin "art" televiziv ku reklamohen modele suksesi në shkëlqe flagrante të normave morale?

Nëse këto duken tepër të vjetruara për shekullin XXI, atëherë të mos heqin veten mënjane nga përgjegjësitë dhe t'ua delegojnë shkollës, universitetit, mësimdhënësve. Këto të fundit nuk mund të mbajnë më shumë nga sa mundet në çështjet e edukimit dhe kulturës. Duhet hequr dorë nga ideja që shkolla edukon. Familja edukon. Shkolla është thjesht instrumenti që të ndihmon për të çuar më tej veten. Nëse përcillen vlera dhe ato bien në vesh të shurdhër të fëmijëve që jo vetëm nuk i nderojnë por edhe i përqeshin mësimdhënësit, ç'mund të pritët?

Pritshmëritë janë të mëdha. Po prindërit në ç'raport qëndrojnë me këto pritshmëri? Nëse pretendojnë se kanë bërë çmos për t'i edukuar fëmijët e tyre dhe ndërkohë përballë kanë fëmijë që ua shkojnë ujin nën rrogë, atëherë është e sigurt që pritshmëritë kanë shkuar në kurrkund. Me apo pa pasaportë nuk ka rëndësi.

Psikologjia e mëkatit dhe Pendimit

— Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz —

Mëkati dhe pendimi pas tij, janë veçori karakteristike e njeriut. Engjëjt nga që nuk mëkatojnë nuk kanë nevojë për pendim, kafshët duke qenë të privuara nga arsyeja janë larg vetëdijes së mëkatit dhe pendimit kurse shejtani nga që nuk u pendua për mëkatin e bërë u privua nga mirësia e pendimit.

Allahu njeriut i ka dhënë një status tjetër, ndryshe nga statusi i engjëjve, xhinëve dhe kafshëve. Njeriu zotëron vullnetin e lirë për të vepruar dhe zgjedhur midis të keqes dhe të mirës, midis të drejtës dhe të gabuarës. Pra njeri për nga natyra është i prirur nga e mirë dhe nga e keqja. Pejgamberi (a.s.) në një hadith thotë: *“Nëse ju nuk do të bënit as një mëkat atëherë Allahu do të krijonte një bashkësi tjetër që mëkaton dhe pendohet dhe që në fund Allahu i fal”* (Muslim, Tevbe, 10.) Pra aftësia për të mëkatuar është pjesë e natyrës njerëzore. Njeriu erdhi në tokë për shkak të mëkatit që bëri.

Allahu e fton njeriun si krijesën përfaqësuese në tokë dhe më të nderuar në univers të ruhet nga mëkatet, të pendohet për mëkatet e vogla dhe të mëdha, për mëkatet që bën haptazi dhe fshehurazi. *“Largohuni nga gjynahet e hapëta dhe të fshehta, sepse, ata që kanë bërë gjynahe, patjetër që do të ndëshkohen për atë që kanë vepruar.”* (En’am, 120.) Dhe nëse distancohet dhe tregon kujdes ndaj mëkateve të mëdha do t’i falen mëkatet e vogla. *“Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t’ju falim gabimet tuaja të vogla dhe do t’ju shpiem në një vend të nderuar.”* (Nisa, 120.)

Mënyra më e mirë për t’u ruajtur nga mëkatet është kujtimi dhe mbajtja e besës që i kemi dhënë Allahut në botën e shpirtave. Nëse thyhet besa atëherë tek njeriu ndodh ndotja shpirtërore dhe tek ai fillojnë të ngrejë krye egoja, dëshira, epshi,

pasioni dhe kënaqësia. Ngritja krye e këtyre, çon në adhurimin e pasurisë, egos dhe shejtanit duke harruar plotësisht detyrën e adhurimit ndaj Allahut, krijuesit të gjithësisë.

Psikologjia e mëkatit dhe fajit krijon reagime reflektive tek njeriu. Mëkati shkakton brejtje të ndërgegjes dhe ngushtim të zemrës. Ndjenja e fajit dhe pendimit që ekziston natyrshëm tek njeriu vë në lëvizje mekanizmat e pastrimit prej mëkatit. Pendimi që plotëson kushtet pengon katranosjen dhe ngurtësimin e zemrës. Kurse mëkati pa tevbe çon në katranosje dhe ndotje të zemrës. ***“Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat.”*** (Mutaffifin, 14.) Pastrimi nga mëkati i sjellë

SHQETËSIMI
PËR MËKATIN, SHPRESA
E PENDIMIT DHE PËRPRËKJA
E VETËDIJSHME PËR TË
BËRË VEPRA TË MIRA
KRIJON TEK NJERIU
PSIKOLOGJINË E MËKATIT
DHE PENDIMIT. NJË
PSIKOLOGJI E TILLË E
EKUILIBRUAR ËSHTË
NJË FAKTOR SHUMË I
RËNDËSISHËM PËR TË
FORCUAR DHE VËNË NË
LËVIZJE MEKANIZMAT E
VETËKONTROLLIT.

njeriut ndriçim në këtë botë dhe botën tjetër. Sepse papastërtia shpirtërore e pengon njeriut të shikojë, ashtu si është e pamundur të shikohet peshku në ujë të turbullt dhe hëna në kohë me re është e pamundur të shikohet realiteti siç duhet kur midis zemrës dhe realitetit ekzistojnë perde.

Njeri duhet të bëjë përpjekje për t'u pastruar nga mëkatet dhe ndotjet shpirtërore në mënyrë që të takohet me Krijuesin. Allahu i ka dhuruar njeriut pendimin si mënyrën më të shpejtë për t'u pastruar nga mëkatet, krahas pendimit Allahu na informon se veprat e mira parandalojnë dhe fshijnë veprat e këqija. Namazi është një nga adhurimet që freskon, gjallëron dhe pastron zemrën e njeriut nga mëkatet. **“Vërtet që namazi të ruan nga shturja dhe nga çdo vepër e shëmtuar”** (Ankebut,45.) Përmendja e vazhdueshme e Allahut e bën shumë të vështirë rënien në mëkate dhe papastërti. Kurse ai që i nënshtrohet egos, epshit dhe dëshirave fundoset në batakun, llumin dhe ndyrësitat e mëkateve.

Të gjitha sjelljet dhe veprimet e mira të njeriut burojnë prej zemrës kurse veprimet e këqija burojnë prej egos, prej elementit material të njeriut. Nënshtrimi ndaj egos dhe epsheve sjell dobësim të zemrës dhe si përfundim fundosjen përfundimtare të njeriut. Neglizhenca dhe hezitimi për të braktisur kërkesat e egos e vendos njeriun në një pozicion shumë të rrezikshëm, kurse përpjekja për të shpëtuar dhe kapërcyer vështirësitë që krijon egoja e çojnë njeriun në qetësinë dhe lumturinë e përhershme.

Njerëzit, perden me të cilën Allahu u ka mbuluar

mëkatet, e grisin vetë me dëshirën e tyre. Rrumiu personat që zbulojnë mëkatet e tyre i përshkruan kështu: *“Qoftë qafiri qoftë mëkatari e grisin vetë perden që iu mbulon fajet që kanë bërë sepse mëkatet dhe padrejtësia mbeten të fshehta mes enigmave të shpirtit por është mizori ai që i publikon ato duke thënë më shikoni mua, unë kam brirë, shikoni kaun e xhehenemit, o Mizor! Duart dhe këmbët dëshmojnë kundër teje edhe në këtë botë për mëkatet që ke bërë, një zë të nxit duke të thënë mos i fshih, thuaj haptas gjërat, sidomos kur zemërohesh dhe nis të llomotitësh t'i i zbulon të gjitha të gjërat që ishe përpjekur t'i mbaje fshehur, padrejtësitë dhe mëkatet që ke bërë të qëndrojnë mbi krye duke i urdhëruar gjymtyrët të dëshmojnë për ta.”*

Njëkohësisht me melekët Kiramen dhe Katibin regjistrimin e veprave e bën edhe bota jonë e brendshme, ndërgjegjja, shpirti dhe zemra jonë. Këto regjistrime bëhen burim qetësie dhe lumturie ose burim trishtimi dhe dëshpërimi.

Rrumiu personin mëkatari e ngjason me gomarin e zhytur në batakun e cili megjithëse është kafshë, kur bie në batakun përpikët me gjithë fuqinë për të dalë prej aty, ai nuk mendon aspak për të qëndruar aty sepse e di që ai vend nuk është i përshtatshëm për të jetuar. Njeriu që bie në batakun e mëkateve dhe nuk bën asnjë përpjekje për t'u ngritur por përkundrazi është i kënaqur në batakun në të cilin ka rënë bie në nivelin e gomarit. Persona të tillë rrinë e ngushëllojnë veten me gjithfarë pretekstesh. Amr ibn Osmani në lidhje me pendimin thotë: “Pendimi është obligim për çdo person që mëkaton qoftë ky mëkat i madh qoftë i vogël. Në momentin që kryen një mëkat nuk ke asnjë arsyeje për të braktisur pendimin. Kërcënimet e Allahut në lidhje me mëkatet janë shumë të rënda dhe këto kërcënime mënjanohen vetëm përmes pendimit.” Kurse një nga personat e dashur të Allahut. Muhamed ibn Vasi thotë: “Nëse çdo mëkat do të kishte erë, ju nuk do të mund të qëndronit pranë meje prej erës së keqe.

Muhamed ibn Vasiun kur e pyesnin “Si je” përgjigjej:

“Si një person që jeta i shkurtohet, mëkatet i rriten dhe vdekja i afrohet çdo ditë e më shumë.”

Shqetësimi për mëkatet, shpresa e pendimit dhe përpjekja e vetëdijshme për të bërë vepra të mira krijon tek njeriu psikologjinë e mëkatit dhe pendimit. Një psikologji e tillë e ekuilibruar është një faktor shumë i rëndësishëm për të forcuar dhe vënë në lëvizje mekanizmat e vetëkontrollit.



PËRPARËSITË DHE DELIKATESA E RRUGËS SONË

— Fuat Akpënar —

Rruga jonë duhet të jetë një përpjekje e gjatë për të jetuar në udhën e saktë, duke e njohur dhe perceptuar me mend dhe me zemër Krijuesin e Gjithësisë, Allahun, të Vërtetën Absolute përveç të Cilit nuk ka zot tjetër, i Cili na e ka bërë të qartë të Vërtetën e Madhe, i Cili mbështjell me mëshirën e Tij të gjithë krijesat, që i do ato dhe që meriton të duhet më shumë se gjithçka tjetër, Zotëruesi i vërtetë i pronësisë dhe i ditës së gjykimit.

Teksa zemra dhe mendja preokupohet dhe merret me idole të panumërta, pohimi me gjuhë i Dëshmisë së Njesisë Islame (shehadeti) nuk mund të jetë rruga jonë e vërtetë.

Përparësia jonë duhet të jetë komunikimi dhe zbatimi i sekreteve të Njesisë së Zotit dhe nisur nga ajo që na mëson Kurani, gjithashtu edhe njohja, perceptimi dhe praktimi i traditës profetike të Profetit Muhamed, mëshirës së botëve, i cili në jetën e tij përherë interesohej për besimtarët, shqetësohej kur ata kishin probleme dhe sillej butë dhe me mëshirë përherë me ta.

Përparësia jonë duhet të jetë të mos e heqim asnjë çast nga mendja të vërtetën absolute se Allahu është Zoti i qiejve dhe i tokës, i gjithçkaje që gjendet mes atyre të dyjave, të cilat disa i shohim dhe disa nuk i shohim, disa i njohim dhe të tjerat nuk i njohim, se Ai dëshmon Vetë se nuk ka zot tjetër përveç Tij dhe se asgjë tjetër nuk e meriton emrin dhe atributet e Tij, se falënderimi, lavdërimi, vendimi dhe kthimi janë vetëm të Tijat, se Ai është miku, ndihmësi dhe zotëruesi i vërtetë, i Cili e ruan atë që i mbron robërit e Tij dhe ia fal atij fajet dhe gjynahet.

Përparësia jonë duhet të jetë përpjekja për ta njohur Allahun, i Cili ua dhuron begatitë e tij si rezultat i mëshirës së Tij të pafund të gjitha krijesave që gjenden në këtë botë, i Cili mëshiron shumë, ka krijuar natën dhe ditën, i cili dërgon erën si lajmëtare të shirave që i falin gjallërinë tokës së vdekur, i Cili e shpalli Kuranin si shërim, udhëzim dhe mëshirë për shpirtat e njerëzve dhe ua mësoi atyre urtësinë, ndërsa delikatesa duhet të përbëjë pasimin e rrugës profetike, si përgjigje ndaj thirrjes hyjnore për të përfutur mëshirën e pafund.

Përparësia jonë duhet të jetë përpjekja për ta njohur Allahun, i Cili i

purifikon me reshjet e mëshirës së Tij nga gjynahet që kanë bërë robërit e Tij, duke ua bërë të ditur atyre që i bëjnë padrejtësi vetes së tyre, duke tejkaluar kufirin e rregullit në këtë jetë se ata “nuk duhet ta presin shpresën nga mëshira e Allahut, i Cili i fal të gjithë gjynahet, sepse Ai është me të vërtetë Falës dhe Mëshirues i Madh.” Duke ua bërë të qartë atyre se Ai është mëshiruesi më i madh dhe se do t’i gostisë me mëshirën dhe begatinë e Tij në jetën tjetër vetëm dhe vetëm besimtarët, ndërsa delikatesa duhet të jetë përngjasimi me këtë atribut të Zotit, duke u përpjekur që të marrim pjesë sadopak nga ky atribut, duke shkrië në thellësitë e detit tonë të shpirtmadhësisë gabimet dhe të këqijat që të tjerët kryejnë ndaj nesh, si dhe të përhapim shembujt e mëshirës hyjnore në jetën e përditshme me anë të butësisë në marrëdhëniet që krijojmë me të tjerët.

Përparësia jonë është të njohim Allahun, të cilin e madhërojnë të gjitha krijesat kudo që të gjenden ato, si në qiejt që qëndrojnë pa pasur nevojë për shtylla apo në tokë ku gjendet çdo lloj begatie, Zotëruesin e vërtetë të gjithë pasurive që i përdor ato si të dëshirojë, Sunduesin e vërtetë të gjithë universit, i Cili ia jep dhe ia merr pronën atij që dëshiron, i Cili ka në dorë çdo lloj mirësie dhe mposht apo e bën të ngadhënjejë kë të dojë, ndërsa delikatesa duhet të jetë mospjesëmarrja në bashkësitë e dhunës, në mënyrë që të mos ndahemi nga rruga e drejtë, të kërkojmë strehë tek Allahu që të na mbrojë nga të këqijat e njerëzve dhe të xhindëve dhe të madhërojmë përherë Allahun, duke rënë në sexhde dhe duke mos harruar se asgjë në këtë jetë nuk është e jona, por e Allahut.

Përparësia jonë duhet të jetë të njohim me zemër Allahun, i Cili është i zhveshur nga çdo lloj mangësie dhe është i veshur me të gjithë atributet e perfeksionimit dhe kjo manifestohet në rregullin dhe harmoninë madhështore që lexon dhe sheh me habi çdo njeri me mendje të shëndoshë në librin e gjithësisë, ndërsa delikatesa duhet të jetë dashuria jonë për t’u bërë të meritueshëm nga ana e Allahut, duke u pastruar nga të gjitha gabimet dhe gjynahet tona me anë të pendesës dhe kërkimit të faljes hyjnore, duke i shndërruar në ujëvarë lotët tanë që pikojnë me dëshirën e pastrimit dhe drejtimit të gjithë ymetit të Muhamedit.

Përparësia jonë duhet të jetë të kuptojmë ashtu siç ka hije Allahun, që ka krijuar tokën e paqes për robërit e Tij, që i fton ata që u binden urdhrave të tij të jetojnë në xhenet, vendin e prehjes dhe të qetësisë, që i ka përgëzuar ata që besojnë dhe kryejnë vepra të mira se kanë për të jetuar përherë në xhenet, i Cili është i zhveshur nga çdo lloj mangësie dhe ua mundëson robërve të Tij të arrijnë shpëtimin në këtë jetë dhe në jetën tjetër, i Cili i thërret besimtarët që të bien salavat mbi Profetin Muhamed, pasi edhe vetë Ai, së bashku me melekët, bien salavat mbi Profetin.

Delikatesa jonë duhet të jetë besimi në ajetet e Kuranit, në mënyrë që të fitojmë pëlqimin e Zotit dhe kështu të mund të hyjmë në shtëpinë e paqes, të kryejmë punë të mira, të durojmë, ta falim rregullisht namazin, të shpenzojmë në punë të hajrit begatitë që na ka dhuruar Zoti, të kompensojmë të pahijshmen dhe të gabuarën me të hijshmen dhe të bukurën, të këndojmë salavat sa më shumë mbi Profetin Muhamed, të përhapim selamin në mesin e besimtarëve, për të siguruar kështu paqen dhe sigurinë mes tyre dhe të shpallim me veprimet tona dhe me dua fjalët: “Allahu im, që je Paqëtuesi më i madh, na bëj të mundur të jetojmë nën hijen e atributit Tënd, të sillemi me paqe ndaj çdo krijese që do të takojmë në jetën tonë dhe të arrijmë të banojmë në fund fare në shtëpinë e paqes, duke kaluar me sukses përmes rrugës së mahsherit.”

“Dhe kështu, Ne i dhamë Jusufit pozitë në atë vend dhe ai kishte çfarë të dëshironte. Ne e shpërblejmë me mëshirën Tonë, kë të duam dhe, punëmirëve nuk ua humbim shpërblimin.”

(Jusuf, 56)

Surja Jusuf fillon me një ëndërr të Jusufit (a.s.) që ia tregon babait, Jakubit (a.s.). Jusufi (a.s.) shikon në ëndërr njëmbëdhjetë yje, diellin dhe hënën duke i bërë sexhde. Kjo ëndërr simbolizonte jetën dhe pozitën që do të arrinte Jusufi (a.s.). Nga ky këndvështrim çdo njëri prej nesh është një Jusuf sepse të gjithë kemi ëndrra për të ardhmen dhe jetën e programojmë në përmbushjen e kësaj ëndrre.

Smira për suksesin e të tjerëve ka ekzistuar gjithmonë dhe kësaj nuk do ti shpëtonte as Jusufi (a.s.). Për këtë arsye Jakubi i kërkoi ta mbante sekret ëndrrën të mos e ndante as me vëllezërit e tij. Nga kjo kup-tojmë kujdesin e Jakubit (a.s.) për të mos i dhënë mundësi shfaqjes së zilisë midis fëmijëve. Në të njëjtën kohë na paralajmëron se tradhtia mund të vijë edhe nga njerëz shumë të afërt. Ajo që i frikësohej më së shumti Jakubi, i ndodhi Jusufit (a.s.). Jusufi (a.s.) ra pre e tradhtisë së vëllezërve të vet. Ndër alternativat për ti bërë keq Jusufit (a.s.) ishte edhe eliminimi fizik i tij por në fund vendosën ta braktisnin duke e hedhur në një pus. Kur u paraqitën tek babai, i sollën argument të rremë duke thënë se e hëngri ujku. Jusufin (a.s.) e gjeti një karvan që shkonte për Egjipt, e morën dhe ia shitën në tregun skllevërve një nëpunësi të lartë në mbretëri. Jusufi (a.s.) shpëtoi nga kurthi i vëllezërve duke u vendosur i sigurt në Egjipt por jo nga sprovat e kësaj bote. Mbasi vendoset në shtëpinë e vezirit, zonja e shtëpisë kërkon ta joshë por nderi i Jusufit (a.s.) i qëndroi tundimit. **Ai tha: “O Zoti im, më shumë e dua burgun se atë ku më shtyjnë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt atyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dine (ligjet e Tua).”** (Jusuf, 33)

Jusufi (a.s.) megjithëse i pafajshëm burgoset me burgim disa vjet. Pas interpretimit të saktë që i bën ëndrrës së mbretit nxirret nga burgu dhe emërohet përgjegjës për thesarin dhe rezervat e mbretërisë. **Dhe kështu, Ne i dhamë Jusufit pozitë në atë vend dhe ai kishte çfarë të dëshironte. Ne e shpërblejmë me mëshirën Tonë, kë të duam dhe, punëmirëve nuk ua humbim shpërblimin. Ndërsa shpërblimi i jetës tjetër është më i mirë për ata që besojnë dhe e kanë frikë Allahun.** (Jusuf, 56-57)

Këto janë vetëm disa fragmente të zgjedhuara nga tregimi i Jusufit (a.s.) por nga sa treguam mund të nxjerrim këto përfundime:

Në pamje të parë e ardhmja e Jusufit (a.s.) duket si e pashpresë, në fillim e hedhin vëllezërit në pus, ata që e gjejnë e shesin me një çmim të lirë në tregun e skllevërve, mbas kësaj e ndjek burgu disa vjeçar. Të gjitha këto janë sprova shumë të mëdha në jetën e një njeriu. Por mbas gjithë këtyre fatkeqësive, Allahu, i cili nxjerr të gjallën nga e vdekura, po përgatiste të ardhmen e ndritur të Jusufit (a.s.).

Mbas çdo fenomeni qëndron fuqia hyjnore dhe përcaktimin e Krijuesit nuk mund ta pengojë askush. Përfundimi i ngjarjeve do të jetë gjithmonë sipas përcaktimit të Allahut.

Si përfundim në një mënyrë apo një tjetër ne përsërisim jetën e Jusufit (a.s.). Vullneti i Allahut zbatohet mbi çdo njërin prej nesh sepse Allahu është Zotëruesi i gjithë Pushtetit!

“Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mire është në Dorën Tënde! Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë.”

Transmetohet nga Ebu Hurejra se Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

"Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit, le të thotë fjale të mira ose të heshtë!"

Ky hadith përmban shumë urtësi të vyera. Është një hadith që duhet të jetë moto jo vetëm për individin e thjeshtë por edhe për shoqërinë në përgjithësi. Në Islam, të qenët i dobishëm ndaj njerëzve është parësore. Nëse nuk mundesh të jesh i dobishëm për njerëzinë, të paktën mos u bë dëmshëm për të. Për një shoqëri në harmoni është e domosdoshme distancimi prej fjalëve të kota dhe kjo arrihet, sipas hadithit, ose duke folur fjalë të mira e të dobishme ose duke heshtur. Komunikimi është thelbësor për zhvillimin e shëndoshë të çdo shoqërie, e rrjedhimisht edhe të vet Individit si qenie njerëzore. Komunikimi zhvillohet duke i bërë shprehje fjalët e mira, fjalët e bukura dhe duke u larguar sa mundemi nga thashethemet e ofendimet. Në një shoqëri ku dominojnë thashethemet, shpifjet dhe ofendimet nuk mund të ekzistojë një komunikim konstruktiv ndërnjerëzor. Në një shoqëri ku mungon fjala e mirë sundon e keqja. Prandaj kush dëshiron të flasë së pari duhet të

mendohet për pasojën që mund të ketë fjala. Nëse është e dobishme duhet të flasë dhe nëse jo atëherë është më mirë të heshtë. Duhet të jemi të përgjegjshëm për çdo fjalë të thënë sepse për çdo fjalë të thënë do të gjykohemi. Siç e pohon edhe ajeti Kuranor **"Për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm** (për ta shënuar atë)." (Kaf, 18)

Ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Gjykimit ndjejnë një përgjegjësi të madhe për çdo sjellje apo fjalë që shprehin. Siç dihet disiplina është e lidhur ngushtë me besimin në Ditën e Gjykimit sepse një njeri që beson ditën e gjykimit dhe pasojat që vijnë pas gjykimit si dënimi apo shpërblimi përpiqet me gjithë mundësitë e veta për të mos bërë as një vepër që është në dëm të tij në ditën e gjykimit, duke filluar me ruajtjen e gjuhës nga fjalët që mund të jenë fyese, përçarëse e dashakeqëse të cilat bëjnë të mundur humbjen e besimit ndër njerëz.

MËSIMET QË NXJERRIM PREJ HADITHIT:


1. Fjala e mirë ose në të kundrën preferohet heshtja
2. Fjala e mirë ose heshtja tregojnë përsosjen e besimit.
3. Pejgamberi a.s përdor metoda të ndryshme sipas temës.

Një Hadith



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- P J E S A I V -



MEDITIMI I VDEKJES

Nëse njeriu i sheh me syrin e zemrës manifestimet hyjnore që ekspozohen në vetë qenien e tij dhe në gjithësi, do të fillojë të meditojë në lidhje me mënyrën se si duhet ta jetojë jetën e kësaj bote. Ditët, netët, javët, muajt, stinët, e vitet që ndjekin me shpejtësi njëri-tjetrin, të rejat që vjetërsohen, pallatet madhështore që kthehen në gërmadha, fytirat në pasqyrë që ndryshojnë ditë pas dite e flokët që thinjen e bien, na kujtojnë vazhdimisht rruga jonë na drejton diku. Për rrjedhojë, e vërteta me të cilën lidhet më shumë meditimi ynë është ndodhia e “vdekjes”. E në fakt të gjithë ne, pa përjashtim, një ditë do të kalojmë patjetër nga shtegu i vdekjes, duke iu nënshtruar urdhrit hyjnor: “*Çdokush do ta shijojë vdekjen!..*” (Enbija, 35.)

Vdekja, që është e vërteta më absolute që njohim në lidhje me të ardhmen tonë, në një farë kuptimi është vetëm një natë midis ditës së dynjasë dhe

asaj të Ahiretit. Pra dynjaja është një ditë kalimtare, vdekja është një natë provizore, ndërsa Ahireti është një mëngjes i së vërtetës së përjetshme.

Ky fjalim i **Kuss ibn Saide**¹, i mbajtur në panairin e Ukazit në kohën e injorancës, para se të vinte Shpallja, është një përkujtim dhe paralajmërim i jashtëzakonshëm për zemrat e ndjeshme dhe në të njëjtën kohë edhe një përkufizim i bukur i besimit monoteist:

“O njerëz!

Ejani, dëgjoni, ngulitni në mend dhe merrni mësim!

1. Kryetari i fisit Ijad i cili ka jetuar pak kohë para ardhjes së Muh - medit (a.s.), si i dërguar i Allahut. Ai ka pasur besim monoteist të bazuar në shpalljen që i erdhi Isait (a.s.). Gjithashtu ishte edhe një orator dhe poet i njohur.



Kush jeton, vdes; kush vdes tretet e humbet! Bie shiu e mbin bari, fëmijët lindin e zënë vendin e prindërve, pastaj të gjithë pushojnë së qeni e humbasin! Këto ndodhi nuk ndërpritën, ato veçse ndjekin njëra-tjetrën!

Vini vesh e dëgjoni me kujdes! Ka lajme nga qielli se në tokë ka dukuri e elemente mësimdhënëse! Toka është dyshek i shtruar, ndërsa qielli një tavan i lartë. Yjet ecin, detet qëndrojnë. Kush vjen nuk mbetet, kush ikën nuk kthehet. Vallë arsyeja pse nuk kthehen është të qenurit të kënaqur nga vendi ku kanë shkuar, apo se mbahen (me forcë) dhe zhyten në gjumë?..

Betohem se te Allahu është një fe e cila është shumë më e dashur se kjo që keni ju sot!

Dhe është një Profet i Allahut, ardhja e të cilit është shumë e afërt. Hija e tij tashmë gjendet mbi kokat tuaja. Lum për atë që do ta besojë dhe do të mësojë rrugën e drejtë prej tij! Mjerë për atë që do ta mohojë e do t'i dalë kundër!

Mjerë ato popuj që jetën e tyre e kalojnë të shkujdesur!

O njerëz!

Ruhuni nga shkujdesja! Çdo gjë është e përkohshme, vetëm Allahu është i përjetshëm. Ai është një i vetëm, nuk ka shok e të barabartë! Ai s'ka lindur kënd dhe as është i lindur. Vetëm Ai duhet adhuruar!

Ka shumë mësim që duhet të marrim prej atyre që erdhën në këtë botë dhe larguan para nesh.

O fisi Ijad! Ku janë etërit dhe gjyshërit tuaj?! Ku janë Adi dhe Themudi që ndërtonin tempuj të stolisur dhe shtëpi prej guri?! Ku janë Faraoni dhe Nemrudi, që të fryrë nga ndjenja e krenarisë për pasuritë e kësaj bote, u thoshin popujve të tyre: "Unë jam Zoti juaj më i madh!"?!?

Kjo tokë i bloi ata në mullirin e vet dhe i bëri pluhur. Madje edhe kockat e tyre u shkërmoqën dhe u shpërndanë, edhe shtëpitë e tyre ngelën të shkreta. Vendin e tyre tani e gëzojnë qentë! Ruhuni dhe mos u bëni të shkujdesur si ata. Mos shkoni gjurmëve të tyre. Çdo gjë është e përkohshme, vetëm Allahu është i përjetshëm!

Lumi i vdekjes ka porta hyrëse, por s'ka asnjë hapësirë për të dalë prej tij!.. Të vegjël e të mëdhenj,

të gjithë ikin e mërgojnë. Ç'i ka gjetur të tjerët, do më gjejë edhe mua."²

Në fakt, Allahu i Madhëruar ua kujton robërve të tij çdo ditë realitetin e vdekjes, duke dhënë si shembull kapitjen e trupave në gjumin e natës, pas lodhjes me punë të ndryshme gjatë ditës. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik lajmërohet:

"Ai jua merr shpirtrat (ju vë në gjumë) natën, duke e ditur ç'keni bërë ditën, pastaj ju zgjon që të plotësoni kohën tuaj të caktuar për të jetuar. Në fund, tek Ai do të ktheheni dhe Ai do t'ju tregojë gjithçka që keni bërë." (En'am, 60.)

"Allahu ua merr shpirtrat atyre që u ka ardhur çasti i vdekjes dhe atyre që nuk kanë vdekur, por që janë në gjumë. Pastaj Ai ndal shpirtin e atij që i është caktuar vdekja, ndërsa të tjerëve ua lë deri në një kohë të caktuar. Me të vërtetë, këto janë shenja për njerëzit që mendojnë." (Zumer, 42.)

Ditët e para kur Profeti ynë (a.s.) kishte filluar ftesën në Islam, ua kujtoi këtë të vërtetë Kurejshëve, duke u folur atyre prej Kodrës Safa me këto fjalë:

"...Ju do të vdisni sikur bini në gjumë dhe do të ringjallen sikur ngriheni nga gjumi. Patjetër që ju do të ngriheni nga varri, do të dilni para Allahut dhe do të jepni llogarinë e çdo veprimi tuaj në këtë botë. Si përfundim, do të shihni shpërblimin e mirësive dhe adhurimeve tuaja dhe dënimin e ashpër të punëve tuaja të këqija! Shpërblimi është Xheneti i përjetshëm, ndërsa ndëshkimi Xhehenemi i përjetshëm."³

Për rrjedhojë, këtë jetë të përkohshme nuk duhet ta jetojmë duke nenvleftësuar ekzistencën e Ahiretit, siç bëjnë mohuesit, që janë bërë robër të dëshirave egoiste dhe propagandojnë se: **"Nuk ka jetë tjetër përveç jetës së kësaj bote, ne jetojmë e vdesim e nuk do të ringjallemi më."**⁴, por duhet ta çmojmë ashtu siç dëshiron Allahu i Madhëruar dhe të ecim në rrugën e drejtë të Kuranit dhe Sunnetit, duke u nisur prej faktit se: **"Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë..."** (Mulk, 2.)

Ne duhet t'i japim rëndësi këshillës që i Dërguari i

2. Bejhaki, *Kitabu'z-Zuhd*, II, 264; Ibn-i Kesthir, *el-Bidaje*, II, 234-241; Hejthemî, IX, 418.

3. Shih. Belazuri, *Ensabu'l-Eshraf*, I, 118; Ibnu'l-Esir, *el-Kamil*, II, 61; Halebi, *Insanu'l-Ujun*, I, 459.

4. Mu'minun, 37.

Allahut, (a.s.), i dha Tarik ibn Abdullahut (r.a.), kur i tha: *“O Tarik! Përgatitu për vdekjen pa t’u afruar ajo!”* (Hakim, Mustedrek, IV, 347/7868.)

Me qëllim që asnjëri të mos jetë i papërgatitur për ndodhinë e vdekjes, që është një realitet i paevitueshëm dhe të cilin nuk e mohon dot askush, Profeti ynë (a.s.) e ka motivuar ummetin e tij që të meditojë rreth vdekjes, duke na këshilluar:

“Kujtoni vdekjen dhe kalbjen e trupit e të kockave tua pa pasi të vdisni! Kush dëshiron jetën e Ahiretit, e braktis zbukurimin e jetës së dynjasë.” (Tirmidhi, Kijamet, 24/2458.)

Sahabët e nderuar, të cilët u edukuan nga dora e Profetit tonë (a.s.), kishin fituar një butësi zemre të tillë në lidhje me meditimimin rreth vdekjes, sa që çdo gjë që shihnin u kujtonte përkohshmërinë e dynjasë, varrin, kiametin, llogarinë dhe dënimin.

Lidhur me këtë, një prej personaliteteve më të larta të brezit të tabiinëve, Ebu Uail tregon:

“Njëherë dolëm për udhëtim me Abdullah ibni Mes’udin (r.a.). Bashkë me ne ishte edhe Rebi ibn Hajthem. Kur po kalonim pranë një hekurpunuesi, Abdullahu (r.a.) ndaloi dhe filloi të shohë hekurin brenda zjarrit. Edhe Rebiu pa zjarrin dhe gati sa nuk ra në tokë. Më pas u larguam prej aty. Kur shkuam para një furre në breg të Eufratit, Abdullahu (r.a.) pa zjarrin që flakëronte brenda në furrë dhe lexoi ajetin:

“Kur ai t’i vërej prej së largu, ata do t’ia dëgjojnë vlimin dhe rënkimin. E kur të hidhen në një vend të ngushtë të tij, të lidhur duarsh, do të luten për shkatërrimin (e vet).” (Furkan, 12-13.)

Pas kësaj Rebiut i ra të fikët. E morëm dhe e dërguam tek familja e tij. Abdullahu (r.a.) i qëndroi tek koka deri në mbrëmje, kur më në fund Rebiu erdhi në vete...” (Ebu Ubejd, Fedailu’l-Kuran, fq. 23.)

Një prej dijetarëve Islam, Abdulhamdi Keshk thotë:

“Kur një sahab kthehej në mbrëmje në shtëpi, gruaja e tij së pari i bënte këto dy pyetje:

“Sa ajete u zbritën sot nga Kurani?”

“Sa prej haditheve të Profetit (a.s.) ke mësuar përmendësh sot?”

(Në mëngjes) Kur dilte nga shtëpia, gruaja i thoshte:

“Ki frik Allahun, mos fito në haram! Ne e durojmë urinë në këtë botë, por nuk mund ta durojmë dot zjarrin në ditën e Kiametit!”. (Abdulhamid Keshk, Fi fihabi’t-tefsir, I, 26.)

Ndryshe nga dëshira dhe shqetësimi që ka njerëzimi në ditët e sotme, për të jetuar më gjatë dhe më rehat në këtë botë, dëshira më e madhe e brezit të sahabëve ka qenë mërgimi në botën tjetër me zemër të pastër, qetësi shpirtërore dhe nder.

Një ditë, Abdullah ibn-i Mes’udi (r.a.) i thotë miqve të tij prej tabiinëve:

“Ju agjëroni, falni namaz dhe bëni punë të mira më shumë se sahabët e të Dërguarit të Allahut. Mirëpo, ata ishin më të mirë se ju.”

“Si është e mundur kjo?”- pyetën ata.

Ndërsa ai iu përgjigj:

“Ata ishin më asketë se ju kundrejt kësaj bote dhe e dëshironin më shumë se ju Botën tjetër”. (Hakim, Mustedrek, 4/135.)

Muhammed ibn Ka’b el-Kurazi tregon:

“Një ditë u takova me **Omer ibn Abdulazizin** në Medine-i Muneuere. Atëherë ai ishte një djalosh i ri shumë simpatik që jetonte me gjithë të mirat. E kam takuar edhe më pas kur ai u bë halif. Kur e pashë herën e dytë u habita dhe rrija duke e vështruar i shtangur. Më pyeti:

-O Muhamed, çfarë ke që më shikon gjithë habi?

-O prijësi i besimtarëve, - i thashë unë, - ju paska ikur ngjyra, trupi ju është lodhur dhe flokët ju janë zbardhur e ju kanë rënë! Nuk munda ta fsheh habinë time kur ju pashë në këtë gjendje.

Omer ibn Abdulazizi më tha:

-O Muhamed, kushedi sa do të ishe habitur po të më shihje tri ditë pasi të jem varrosur? Atëherë kur krimbat të më kenë ngrënë sytë dhe të më vërshojnë nëpër faqe, dhe kur goja dhe hunda të më jetë



mbushur me qelb dhe gjak. Atëherë nuk do të më kishe njohur aspak dhe do të ishe habitur edhe më shumë me mua...” (Hakim, IV, 300/7706)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), në një hadith fisnik thotë:

“Kujtojeni shpesh vdekjen, e cila ua pret si me thikë të gjitha kënaqësitë!” (Tirmidhi, Zuhd, 4.)

Njeriu që arrin të meditojë siç duhet rreth vdekjes, pa e larguar asnjëherë nga mendja, nuk mashtrohet me kënaqësitë e përkohshme, ndërsa ai që e di se është një udhëtar i përjetësisë, nuk mashtrohet me lodrat e kësaj bote duke humbur kohën me to.

Fëmijët luajnë buzë detit dhe bëjnë kështjella prej rëre, me të cilat kalojnë orë të tëra. Pastaj kur ju mërzhiten i gjuajnë dhe i rrafshojnë... ose vjen një dallgë e fuqishme dhe përpin gjithçka.

E njëjtë është edhe vdekja. Biri i njeriut thur ëndrra, plane dhe projekte në lidhje me të ardhmen. Por, kur kujton vdekjen, horizontin e zemrës së tij e kaplon hidhërimi. Ndërkohë që njerëzit janë duke realizuar nga çasti në çast planet që kanë mendje, u vjen vdekja dhe ua shkatërron gjithçka për një moment. Gjithë ai mund e përpjekje asgjësohet si kështjella prej rëre e fëmijëve. Prandaj konsiderohet shkujdesje e tepruar të jetuarit duke ia lënë ëndrrave egoiste në dorë frerët e jetës dhe duke harruar të vërtetën e vdekjes...

Ebu Said el-Hudri (r.a.), transmeton:

Njëherë, i Dërguari i Allahut, (a.s.), nguli një shkop në tokë. Pranë tij nguli një të dytë, e pak më tej një të tretë. Më pas u kthye nga sahabët dhe i pyeti:

“A e dini se çfarë kuptimi kanë këto?”

Ata, ashtu si përherë, u përgjigjën:

“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë!”

Më pas Profeti (a.s.) ua shpjegoi çështjen sahabëve që dëgjonin me kureshtje, duke thënë:

“Shkopi i parë është njeriu, i dyti është exheli (vdekja) dhe i treti përfaqëson dëshirat dhe kërkesat e tij. Ndërkohë që njeriu vrapon pas dëshirave të

veta, exheli i pret rrugën dhe e merr.” (Ahmed Ibn-i Hanbel, Musned, III, 18.)

Sa mashtrim i hidhur është fakti që njeriu e konsumon kapitalin e jetës së vet me gjëra të kota sikur do të jetojë përgjithmonë në këtë botë, ndërkohë që vdekja është realitet?!..

Lidhur me këtë indiferencë të përgjithshme të njerëzve, i nderuari Sufjan Theuri, shprehet duke na dhënë një shembull:

“Nëse një tellall thërret një grup njerëzish të mbledhur në një vend dhe u thotë:

«Kush mund të deklarojë se sot do të jetojë deri në mbrëmje, le të ngrihet në këmbë!», do të shohim se askush nuk do të ngrihet në këmbë. Por e çuditshmja është se edhe nëse ai u thotë të gjithë njerëzve:

«Kush është përgatitur për vdekjen, të çohet në këmbë!», përsëri nuk do të ngrihet askush!..”

Në një hadith fisnik thuhet:

“Sa i mjerë është rob i thur iluzione për superioritet dhe e harron Allahun e Madhëruar!”

Sa i mjerë është ai që me mizori shkel të drejtat dhe harron Atë që është i fuqishëm e madhështor!

Sa i mjerë është ai që qesh e luan me indiferencë dhe harron varrin e kalbjen nën tokë!

Sa i mjerë është ai që i kalon kufijtë dhe harron lindjen, vdekjen dhe çka ka përtej saj!” (Tirmidhi, Sifatu'l-Kijame, 17.)

Shkurtimisht mund të themi se dija më e rëndësishme fillon me zgjidhjen e enigmave të mbulimit me dhe dhe të lindjes në Botën e përjetshme. E kush mund të jetë më i mjerë se sa udhëtar i indiferent i përjetësisë, kuptimi dhe vetëdija e të cilit nuk kalojnë përtej kufijve material të mureve të varrezave?!

Të mos harrojmë se zemrat e pandriçura nga meditim rreth vdekjes dhe kohës përtej saj, janë si rrënojat e privuara nga drita e diellit. Aq dritë e fortë është meditim mbi vdekjen, sa që një jetë e pandriçuar nga ajo, është e dënuar të mbetet në errësirat e indiferencës.

O biri Ademit!
Dije se nëse ti je
i shkujdesur ndaj vetes tënde
dhe nuk përgatitesh
për vdekjen, padyshim
se askush nuk do t'i bëjë
përgatitjet për ty.



Nisur nga kjo, edhe të parët tanë, të cilët i kanë pasur parime të jetës së tyre këto të vërteta absolute, varrezat i kanë ndërtuar brenda qyteteve dhe para xhamive, me qëllim që kjo të nxisë vazhdimisht meditim mbi përkohshmërinë dhe realitetin e botës tjetër. Në këtë mënyrë, kushdo që kalon andej sheh ardhmërinë e vet dhe mediton mbi gjendjen personale. Kjo bën që njeriu të ndjejë përkohshmërinë e vet dhe të mos e harrojë Ahiretin. Madje kjo e shtyn njeriun që mirësitë e kësaj bote t'i përdorë si shkallë për arritjen e lumturisë së Ahiretit. Kështu ai nuk do të mashtrohet me rininë, shëndetin dhe fuqinë e tij, duke e pandehur veten të përjetshëm në këtë botë. Ai do t'i kthejë shpinën punëve dhe gjërave të padobishme dhe do të përpiket, sa më shumë të jetë e mundur, të sigurojë kapitalin e duhur për jetën e Ahiretit.

Një udhëtim i vetmuar dhe pa kthim

Vdekja është një kalim i detyruar nga bota e silue-tave në botën e vërtetë dhe udhëtimi më i vështirë të cilin njeriu do ta bëjë i vetëm. Lidhur me këtë, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“(Allahu do t’u thotë): «Tashmë na vini veç e veç, ashtu siç ju krijuam herën e parë, duke lënë pas vetes ato që ju patëm dhuruar...»” (En’am, 94.)

Në këtë udhëtim, njeriun nuk do të mund ta sho-qërojnë kurrësi as të afërmit, as fëmijët dhe as pasuria. I vetmi shok i udhës, që do të ketë afër, do të jetë besimi në zemër -nëse ka- dhe punët e mira e bamirësitë që ka dërguar në Ahiret, që kur ka qenë gjallë.

Të urtët i këshillojnë indiferentët e dhënë pas kësaj bote me këto fjalë:

“O ti që mashtrohesh pas dynjasë duke harruar misterin e sprovës, ti njeri indiferent që krenohesh me pasurinë e përkohshme!

Kujdes, mos u beso shumë vilave dhe sarajeve që ke ndërtuar! Mos harro se po të pret një vend nën dhe. Vilat e tua të larta dhe të gjera do të qëndrojnë këtu, ndërsa ti do të shtrihesh në shtëpinë tënde poshtë dheut, i vetmuar dhe pa rrugëdalje. Aty do të hysh vetëm me punët e tua dhe llogarinë e atyre që ke fituar!..”

Pasuria që nuk kthehet në kapital për lumturinë e Ahiretit, do të jetë shkak i një pendese të thellë për të zotin. Lidhur me këtë njerëzit e urtë kanë thënë:

“Kur një njeri vdes, ai përballet me dy fatkeqësi në lidhje me pasurinë e tij, të cilat nuk i ka hasur asnjëherë më parë: E para është marrja e të gjithë pasurisë nga duart dhe e dyta është llogaritja e hollësishme për të gjithë pasurinë, edhe pse ajo tashmë i është marrë nga duart.”

Kushedi sa e vështirë është për një njeri marrja në llogari për një pasuri që në fund të fundit nuk i ka bërë dobi!..

Siç tregohet me hollësi edhe në një hadith fisnik, e vetmja gjë që do ta shoqërojë robin në varr është puna e tij. Nëse punët e tij janë të mira, ato do të jenë miq e shokë për të zotin. Ato e përgëzojnë atë me lajme të mira dhe e ruajnë nga ndëshkimi e të këqijat. Mirëpo, nëse punët e tij janë të këqija -Allahu na ruajtë!-, ato do ta tmerrojnë të zotin në varr, do ta trembin e do ta mbysin në errësirë, duke ia ngushtuar varrin.” (shih. Abdurrezzak, el-Musannef, III, 581-582.)

Po ashtu, nuk duhet harruar as kjo e vërtetë e shprehur nga i nderuari Hasan Basriu:

“Mos të të mashtrojë numri i madh i njerëzve që sheh përreth, sepse ti do të vdesësh i vetëm, do të ringjallesh i vetëm dhe do të merresh në llogari i vetëm!” (Bursevi, Ruhul-Bejan, Tekathur, 3.)

Ndërsa Osmani (r.a.), paralajmëron kështu në lidhje me indiferencën:

“O biri Adem! Dije se meleku i vdekjes të vjen vërdallë që kur ke ardhur në këtë botë. Madje duke kërcyer prej zverkut tënd, ai kap një tjetër. Kjo vazhdon për sa kohë ti të jesh në këtë botë. Mirëpo do të vijë një ditë që ai do të kërcejë prej zverkut të të tjerëve e do të të kapë ty. Kjo do të ndodhë në një moment të papritur për ty. Prandaj përgatitu për frymën e fundit dhe përpiku të mos zihesh i shkujdesur, sepse meleku i vdekjes nuk është kurrë i shkujdesur ndaj teje!..

O biri Adem! Dije se nëse ti je i shkujdesur ndaj vetes tënde dhe nuk përgatitesh për vdekjen, padyshim se askush nuk do t'i bëjë përgatitjet për ty. Mos e harro kurrë se ti patjetër do të dalësh para Allahut dhe për këtë arsye bëje vetë përgatitjen për veten, duke siguruar furnizim për të! Pra mos guxo t'ia lësh dikujt tjetër këtë punë!” (Ali el-muttaki, no: 42790.)

Si të jetosh, ashtu do të vdesësh dhe po ashtu do të ringjallesh

Jeta është si pikat e ujit që mbushin një gotë. Ndërsa fryma e fundit është pika e fundit që e bën gotën të derdhet. Kthjelltësia e ujit në gotë varet nga kthjelltësia e pikave të ujit. Për të dalë të pastër, para Allahut të Madhëruar, është e domosdoshme që ato pika të mos ndoten me baltën e gjynaheve.

Treguesi më i rëndësishëm i gjendjes sonë shpirtërore, në frymën e fundit, është mënyra se si e përdorim ne frymën tonë në këtë moment. Që të largohemi me sukses nga kjo botë e përkohshme, është e domosdoshme që çdo frymë që japim dhe marrim të jetë si përgatitje për frymën e fundit, sepe:

“Njeriu vdes ashtu siç ka jetuar dhe ringjallet ashtu siç ka vdekur”. (Munavi, Fejzu’l-Kadir, V, 663.)

Pra gjendja shpirtërore e frymëve, që japim dhe marrim, me adhurime, vepra dhe moral të bukur në jetën e kësaj bote, është si një letër për frymën tonë të fundit. Në të njëjtën kohë është edhe përkthyes në këtë botë i gjendjes sonë në botën tjetër.

Sa bukur e shpjegon këtë të vërtetë kjo ndodhi:

I nderuari **Behlul Dana** shpesh qëndronte duke vëzhguar murin e anuar të një shtëpie të shkatërruar dhe gjithmonë meditonte për fundin e vet. Përsëri, një ditë, kur ishte ulur përpara shtëpisë së shkatërruar dhe po meditonte thellë, papritur muri rrëzohet. Kjo gjë e lumturoi pamasë Behlul Danën, aq sa lumturia mund të dallohej lehtë në fytyrën e tij. Njerëzit, të cilët e panë, nuk arritën ta kuptonin gëzimin e tij të jashtëzakonshëm dhe me kureshtje të madhe e pyetën për shkakun e këtij gëzimi.

“A nuk e patë, muri u shemb nga ana që ishte anuar!” –tha Behluli.

Të habitur nga kjo përgjigje, njerëzit e pyetën përsëri:

“Mirë, por çfarë ka për t’u çuditur këtu?!”

Atëherë Behlul Dana tha:

“Meqenëse në këtë botë çdo gjë rrëzohet në anën që anon, kur të vdes edhe unë do të shkoj tek Haku inshAllah, sepse edhe animi im është kah Ai. O njerëz! Të mundohemi ta shtojmë animin tonë nga Haku me anë të rukuve dhe sexhdeve, që të mos rrëzohemi në ndonjë anë tjetër!..”

I nderuari Haxhe Ubejdullah Ahrar tregon:

“Një njeri i mirë pa në ëndërr Bahaiddin Nakshibendin pas vdekjes së tij dhe e pyeti:

«Çfarë duhet të bëjmë për të arritur shpëtimin në botën e përjetshme?»

Ai iu përgjigj:

«Bëni atë që duhet bërë në frymën e fundit!»

Pra, ashtu siç është e nevojshme që në frymën e fundit të mendojmë plotësisht vetëm Allahun e Madhëruar, ashtu duhet të veprojmë edhe gjatë gjithë jetës!” (Reshahat, fq. 130.)

Në të shumtën e rasteve, zemrat që duhet t’ia përkushtojmë Allahut, në frymën e fundit merren me atë që janë marrë më shumë gjatë jetës, pra ato vdesin ashtu siç kanë jetuar. Shembuj të tillë kemi plot:

Për shembull një prej dijetarëve të njohur të hadithit, i nderuari Abdulaziz Reuad tregon një ndodhi shumë mësimdhënëse që i ka ndodhur vetë atij:

“Njëherë gjendesha në Medine-i Muneuere. Një natë, teksa po shkoja në xhaminë e Profetit (a.s.), një grua mu afrua e shqetësuar dhe më tha:

«Zotëri! Nëse dëshiron të fitosh sevape, eja më ndihmo! Ketu gjendet një i sëmurë që po jep shpirt. Do ishte mirë sikur ta nxisje të shqiptonte shehadetin!»

Shkova menjëherë, por sado që u përpoqa ta shtytja të shqiptonte shehadetin, ai nuk arrinte ta thoshte. Papritur ai hapi sytë dhe tha:

«Është e disata herë që më kërkon të them shehadetin! Unë kam kohë që i kam kthyer shpinën shehadetit dhe fesë Islame, e tani nuk arrij ta them dot!» Pa kaluar shumë ai vdiq.

Më pas mësova se ai ishte një person që pinte vazhdimisht verë. Pastaj reflektova me vete se padyshim Profeti (a.s.) ka thënë të vërtetën kur është shprehur se: «*Ai që e bën zakon pirjen e verës, është i njëjtë me këdo që adhuron idhuj.*»” (Ibn Maxhe, Eshribe, 3.)

Pra një jetë e errët nuk mund të pasohet nga një vdekje e ndritur!..

Lidhur me këtë çështje edhe Rebi ibn Hajsem na tregon një ngjarje të ngjashme:

“Njëherë jam gjendur pranë një personi që po jepte shpirt. Ndërkohë që unë e nxisja të shqiptonte «La ilahe il-lallah!», dukej sikur ai nuk më dëgjonte fare dhe vazhdonte të bënte llogari me gishta, sikur numëronte paratë. (Pra po jepte shpirt ashtu siç kishte jetuar)”

Prandaj zemra e një besimtarit duhet të jetë gjithmonë e shqetësuar nga pyetje të tilla si: “Ku dhe në çfarë gjendeje do të takohemi me vdekjen? Në çfarë situatë dhe si do të realizohet takimi ynë i pavitueshëm me melekun e vdekjes?..” Sepse:

Mund të vdesësh edhe duke shkuar në xhami, edhe duke u përpjekur të fitosh rrizkun prej hallallit, edhe duke i qarë hallin një të vuajturi, ose duke shoqëruar një të vetmuar, edhe duke u dhuruar njerëzve prej pasurisë për të fituar kënaqësinë e Allahut, etj... Por, -Allahu na ruajtë! - mund të vdesësh edhe duke vepruar të kundërtën e të gjitha këtyre, duke qenë në një vend të papërshtatshëm, duke lënduar një zemër, duke mbajtur anën e të padrejtës në vend të të drejtës, mund të jesh në një moment zemërimi, në kthetrat e dëshirave të ulëta, në miqësi me armiq të Allahut dhe gjynahqarët, duke bërë sehir ndaj të këqijave dhe duke qenë i zhytur në harame!..



EL-HABIR

AI QË NJEH GJITHÇKA TË GJITHKUJT

— Ilir Hoxha —

Për të njohur diçka, duhet ose ta shohim me sytë tanë, ose ta dëgjojmë nga dikush që e ka parë me sytë e tij. Të themi se e pamë, apo e dëgjuam... por, as kjo nuk mjafton! Për të vlerësuar të dhënat që janë mbledhur dhe për t'i kthyer ato në një informacion, duhet edhe mendja. Të themi se edhe kjo është plotësuar... por, kësaj here përballemi me lloj-lloj mangësish të syrit, të veshit dhe të mendjes. Para së gjithash, burimet tona të informacionit janë të kufizuara. Ne nuk mund t'i shohim, t'i dëgjojmë dhe as t'i kuptojmë në çdo detaj ato.

Mirëpo, Allahu nuk është kështu! A mund t'i shpëtojë dijes së Tij ndonjë gjë në pronën e Tij? Zoti ynë i Madhëruar nuk ka asnjë pengesë në shikim, dëgjim dhe dije. (shih. En'am, 13.) Ashtu si çdo emër i Tij që shpreh përsosmëri, edhe emri Habir tregon se Ai është i njohur me gjithçka në mënyrën më të përsosur, pa pasur nevojë për asnjë mjet informacioni, sepse për Të nuk ka asgjë të fshehtë. (shih. Mulk, 14; En'am, 73, 103; Neml, 88.)

Ai, nuk njeh vetëm ato që kanë ndodhur deri më sot, por çdo gjë deri në ditën e kiametit dhe përtej saj. Prandaj, nuk ka aspak nevojë për ndërmjetësues kur kërkohet diçka prej Tij. Çfarëdo që të kërkohet, kërkohet vetëm prej Tij. (shih. Furkan, 59.) Dallimi në kohë dhe hapësirë nuk përbën asnjë pengesë për dijen e Tij. (shih. Lukman, 34.) Ai i di të gjitha sekretet që njeriu i ka të pamundura t'i dijë dhe t'i kuptojë dhe të gjitha detajet e funksionimit të gjithësisë. Kur'ani është Fjala e Allahut, i Cili zotëron këto cilësi dhe, për këtë arsye, ai është shumë i çmuar. (shih. Hud, 1; Fatir, 37.)

Imam Gazaliu, kur bën klasifikimin e cilësive të

Allahut që kanë të bëjnë me dijen, thotë se emri Alim, ka kuptimin e dijes absolute dhe thekson se dija ndahet në dy pjesë, ajo ekzoterike dhe ajo ezoterike. Nisur nga kjo, emri el-Habir shpreh dijen e Allahut në aspektin ezoterik, pra dijet që nuk perceptohen me shqisa, ndërsa esh-Shehid, shpreh dijen ekzoterike, pra dijet që perceptohen me shqisa.

Të gjithë emrat e Zotit tonë të Madhëruar, të cilat shprehin dëgjimin, shikimin dhe njohjen e çdo gjëje nga ana e Tij, mund të konsiderohen edhe si përgëzim, edhe si kërcënim për njeriun, në bazë të gjendjes në të cilën ndodhet ai. Njeriu që është i sigurt për qëllimin dhe veprimin e tij, qetësohet me përkujtimin e këtyre emrave. Kurse hipokritët dhe koprracët, frikësohen prej këtyre emrave. (shih. Al-i Imran, 180; Teube, 16; Isra, 17.) Lidhur me këtë, Lukmani (a.s.), e porositi kështu birin e tij: ***"O djali im, edhe veprën e rëndë sa kokrra e sinapit që ndodhet në shkëmb, në qiej apo në tokë, Allahu do ta nxjerrë në shesh. Me të vërtetë, Allahu njeh mirë çdo imtësi dhe i di të gjitha fshehtësitë."*** (Lukman, 16.) Këto fjalë tregojnë edhe përgëzim, por edhe kërcënim.

Allahu i Madhëruar ka dijeni edhe për pjesët më të fshehta të zemrave dhe mendjeve. Prandaj, Ai është i vetmi që e njeh dhe do ta shpërblejë siç duhet frikë-respektin ndaj Tij në zemrat e robërve, të cilin njerëzit as nuk mund ta kuptojnë dhe as nuk mund ta vlerësojnë ashtu siç duhet. (shih. Huxhurat, 13; Hashr, 18.)

Nga ky aspekt, emri el-Habir, është një përgëzim i madh për ne, sepse kjo njohuri absolute e Allahut,



është dija e Atij që kërkon arsye për të na falur. E si mund ta kuptojmë ndryshe lajmin përgëzues se të gjithë do të falen, përveç atyre që përpiqen me çdo kusht të jenë prej banorëve të Xhehenemit?

Padyshim se ashtu si çdo emër tjetër hyjnor, edhe emri el-Habir shpreh kërcënim për disa njerëz. Ata që thurin kurthe, që bëjnë të këqija me dëshirë, që planifikojnë kaos, që dëmtojnë me dashje, etj..., duhet të dridhen përballë kuptimit të këtij emri hyjnor. (shih. Adijat, 9-11.) Në përgjithësi, këto paralajmërime të tmerrshme të emrit Habir, në Kur'an përforcohen me bashkëshoqërimin e emrave Latif, Basir, Alim dhe Hakim.

Besimi se Allahu i Madhëruar njih çdo gjë në lidhje me ne, përfshi edhe ato që ne vet nuk i njohim, do të thotë se jemi të vetëdijshëm se çdo gjë që ka caktuar Allahu i Madhëruar për ne, është patjetër mirësi. Për shembull, në ajetin 27 të sures Shura, Allahu i Madhëruar e lidh kështu përcaktimin e masës së furnizimit tonë në këtë botë: ***“Sikur Allahu t’i shtonte mjetet e jetesës për robërit e Vet, ata do ta mbushnin Tokën me mbrapshti. Por Ai u jep me masë, sa dëshiron, sepse Ai i njeh dhe i sheh mirë robërit e Vet.”*** Ndërsa në ajetin 30 të sures Isra, urtësinë e ndarjes së furnizimit e shpjegon me emrat Habir dhe Basir.

Nisur nga kjo, mund të themi se fakti që ne e dimë se Zoti ynë i Madhëruar njih gjithçka në lidhje me ne dhe e përdor këtë gjithmonë në favorin tonë, na qetëson zemrat. Dhe ky është një shpërblim më vete. Të dish se Allahu i Madhëruar di gjithçka që ndodh deri në detajet më të fshehta, është një parim i rëndësishëm për të mos u tronditur përballë ndodhjeve të jetës, çfarëdo qofshin ato. Megjithatë, t’i besojmë Allahut, nuk do të thotë t’ia lëmë Atij gjërat që duhet dhe mund t’i bëjmë ne, por pasi të kemi bërë çfarë mund të bëjmë, duhet të mbështemi tek Ai për rezultatet.

Imam Gazaliu, thotë se njerëzit të cilët pajisen me moralin e emrit hyjnor el-Habir, e njohin botën e tyre të brendshme dhe ndjenjat shtazore të egos së tyre, i kanë mposhtur ato dhe janë treguar vigjilentë ndaj dredhive të tyre. Kjo përpjekje na fal një vigjilencë e cila do të na mbrojë prej sëmundjeve të zemrës dhe nga prishja e ngadaltë dhe tinëzare e ndjenjave, mendimeve dhe besimit. Ky vetëkontroll i brendshëm që duket sikur do të na sjellë vështirësi, na siguron një disiplinë të brendshme, e cila do të na çoj drejt besimit të rregullt, përsosmërisë morale dhe devotshmërisë në veprat tona.

Faktori që ndikon dhe përcakton pothuajse çdo gjë në marrëdhëniet mes njerëzve, më tepër se fjalët dhe veprat, është morali ynë. Nëse fjalët dhe veprat nuk shoqërohen me moral të bukur, nuk kanë aspak dobi në marrëdhëniet mes njerëzve. Në një ajet fisnik, që synon përmirësimin e marrëdhënieve bashkëshortore, pasi bëhet i ditur fakti se egoizmi është pengesa më e madhe në këtë çështje dhe se për ta kapërcyer këtë situatë kërkohet altruizëm dhe devotshmëri, thuhet; ***“...Allahu ka dijeni për çdo gjë që veproni”***¹, gjë e cila tregon se për arritjen e këtyre duhet kuptuar mirë emri hyjnor el-Habir.

Po ashtu, edhe funksionimi i drejtësisë, që është themeli kryesor i marrëdhënieve njerëzore, mund të realizohet vetëm në sajë të dëshmitarëve dhe gjykatësve që nuk e fshehin të vërtetën. Fakti që ajetet të cilët e shprehin këtë të vërtetë mbarojnë me emrin el-Habir, është shumë domethënëse. (shih. Bekare, 234; Nisa, 135; Maide, 8.) Drejtësia mund të qëndrojë në këmbë vetëm nëse nuk e harrojmë për asnjë çast se Allahu njih me detaje çdo mendim tonë të fshehtë dhe veprimet në përputhje me këtë. Ndërsa shoqëritë që nuk e ruajnë drejtësinë por thurin padrejtësi pas dyerve të mbyllura, shkatërrohen me shpejtësi.

1. Nisa, 128.

Leximi i Kuranit ME MEDITIM



— Doç. dr. Kerim Bulladë —

Kurani Fisnik është udhërrëfyes për në besim, është një dritë e qartë, mëshirë, shërim dhe burim paqeje për të gjithë njerëzit. Kurani Fisnik është një libër që e shton besimin, e mbron atë dhe u jep sihariqe atyre që i besojnë. Në ajetet e mëposhtme është theksuar me insistim udhërrëfimi i Kuranit dhe specifikat bazë të tij që përfshijnë këtë botë dhe botën tjetër. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim. Ai është udhërrëfyes për të devotshmit.” (Bekare, 2)

“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten” (Enfal, 2)

“O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kurani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët.” (Junus, 57)

“Thuaj: “Cila është dëshmia më e madhe (që ti je profet)?” - dhe përgjigju: “Allahu është dëshmitar midis meje dhe jush”. Ky Kuran më është shpallur, në mënyrë që nëpërmjet tij t’ju tërheq vërejtjen juve dhe kujtëdo që i përcillet. A mos vallë ju dëshmoni se, përveç Allahut ka edhe zota tjerë? Thuaj: “Unë nuk dëshmoj”. Thuaj: “Vërtet, Ai është vetëm Një Zot dhe unë jam larg nga ato që ju ia shoqëroni Allahut (në adhurim).” (En’am, 19)

“Kur ti (Muhamed) nuk u lexon atyre ndonjë varg nga Shpallja, ata thonë: “Ah! Sikur ta bëje ti vetë”! Thuaju: “Unë ndjek vetëm atë që më ka shpallur Zoti im. Ky (Kuran) është vetëm dëshmi ndriçuese nga Zoti juaj, udhërrëfim dhe mëshirë për njerëzit që besojnë.” Kur të lexohet Kurani, dëgjoni dhe heshtni, në mënyrë që të mëshiroheni.” (A’raf, 203-204)

“Thuaj: “Atë (Kuranin) e ka zbritur Shpirti i Shenjtërisë nga Zoti yt me të vërtetën, për t’i forcuar ata që besojnë dhe për të qenë udhërrëfyes dhe lajm i mirë për ata që i dorëzohen Allahut.” (Nahl, 102)

“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh. Ndërsa atyre që nuk besojnë në jetën tjetër, Ne u kemi përgatitur dënim të dhembshëm.” (Isra, 9-10)

“Ne shpallim nga Kurani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.” (Isra, 82)

Siç shikohet edhe në ajetet fisnike të mësipërme, Kurani Fisnik është udhërrëfyes, udhëzim, mëshirë, burim shërimi, një libër që e forcon besimin dhe një libër që e ndriçon syrin e zemrës. Si duhet ta lexojmë dhe si duhet të përfitojmë nga ky libër që luan një rol kaq të rëndësishëm në jetën e myslimanëve? A është e mjaftueshme që ta lexojmë Kuranin Fisnik, i cili i përket Allahut me fjalë dhe me kuptim, vetëm në mënyrë sipërfaqësore, apo thjeshtë me qëllimin e hatmes apo mukabeles? Ne nuk kemi asnjë rrugëzgjidhje tjetër përveçse t’u japim përgjigjen jo këtyre pyetjeve dhe të tjerave të ngjashme me këto, sepse Kurani Fisnik nuk është zbritur që t’i lexohen fjalët dhe me këtë shkak myslimanët të fitojnë sevape. Kurani është libri i dispozitave dhe i jetës. Kurani është dërguar për të sistemuar jetën e kësaj bote dhe të botës tjetër të myslimanëve.

Allahu Teala ka kërkuar nga i Dërguari i Tij (a.s.), që ta lexojë Kuranin Fisnik qartë dhe ngadalë. Për shkak se të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-selam, do

t'i shpalleshin të vërteta të mëdha që e kanë përgjegjësinë e madhe dhe me shumë peshë, i është kërkuar që ta lexojë Kuranin dalëngadalë dhe duke menduar apo medituar rreth tij: **“...Lexoje Kuranin ngadalë dhe qartë, sepse Ne do të të dërgojmë vërtet një fjalë me peshë të rëndë.”** (Muzzemmil, 4-5) Kur zbritën këto ajete fisnike, shpallja e Kuranit sapo kishte filluar. Shkaku që thuhet: **“...Lexoje Kuranin ngadalë dhe qartë”** – është për të mësuar se edhe ajetet e tjera që do të shpallen në të ardhmen duhet të lexohen në këtë mënyrë.

Këto ajete fisnike janë sjellë si argumente për obligimin e leximit të Kuranit me texhvid: **“...Lexoje Kuranin ngadalë dhe qartë...”** (Muzzemmil, 4) “Jobesimtarët thonë: **“Përse Kurani nuk i është shpallur i tëri përnjëherë?!” Ne ta kemi shpallur kështu për të forcuar zemrën tënde dhe ta kemi zbuluar qartazi varg pas vargu.”** (Furkan, 32) **“Ky është një Kuran, që Ne e kemi ndarë pjesë-pjesë, që ti t'ua mësosh njerëzve pak nga pak, duke e shpallur atë kohë pas kohe.”** (Isra, 106) Zemahsheri është shprehur se fjala “tertilen” që kalon në ajetin e katërt të sures Muzzemmil është për të përforcuar obligimin e të lexuarit të Kuranit me texhvid dhe i tregon lexuesit se texhvidi është i nevojshëm në mënyrë absolute.

Ka hadithe fisnike që tregojnë se i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, e ka kënduar Kuranin me texhvid dhe se i ka çmuar ata që e kanë kënduar Kuranin me texhvid. Kur Aishja, radijallahu anha, u pyet se si e kishte kënduar Kuranin i Dërguari i Allahut (a.s.), u përgjigj: “Ai nuk e këndonte siç e këndonin ju. Nëse dikush e dëgjonte të Dërguarin e Allahut (a.s.), po të dëshironte, mund t'i numëronte një nga një shkronjat që lexonte ai.” Xhezeriu është shprehur se mësimi i texhvidit dhe zbatimi i tij është farz i formës së prerë, se bën mëkat ai që e lexon Kuranin pa texhvid, se Allahu Teala e ka zbritur Kuranin me texhvid, se Kurani ka ardhur te ne me texhvid dhe se texhvidi është zbulimi i të kënduarit të Kuranit.¹

Myslimanët e parë që kanë dëshmuar shpalljen e Kuranit Fisnik, janë përkushtuar për të zbatuar parimet e tij që sistemojnë jetën. Madje, krahas leximit dhe mësimi përmendësh të Kuranit, i kanë dhënë më shumë rëndësi kuptimit të tij dhe të vepruarit me të. Tani le të përpiqemi ta shpjegojmë këtë të vërtetë me disa shembuj:

Sipas transmetimeve të Abdullah b. Mes'udit dhe Ubej ibn Ka'bit, i Dërguari i Allahut (a.s.), u këndon-te atyre nga dhjetë ajete. Ata nuk kalonin te dhjetë

ajetet e tjera pa mësuar se si të punonin me dispozitat që gjendeshin në ato dhjetë ajete. I Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, ua mësonte atyre Kuranin Fisnik bashkë me të vepruarit sipas Kuranit.

Abdurrahman es-Sulemi (r.a.), na njofton: “Kur ne mësonim dhjetë ajete nga Kurani, nuk kalonim te dhjetë ajetet e tjera pa i mësuar mirë urdhrat, ndalesat, hallallet dhe haramet që përfshinin ato ajete.”

Imam Maliku thotë në Muvattanë e tij: “Sipas lajmit që më ka ardhur mua, Abdullah ibn Umeri (r.a.) është marrë tetë vjet me suren Bekare për ta mësuar.” Përsëri sipas transmetimit të Imam Malikut, Umeri (r.a.), e ka mësuar suren Bekare për dymbëdhjetë vjet. Kur e mësoi, theri një deve nga gëzimi.

Ndërsa Abdullah b. Mes'udi (r.a.), ka thënë: “Ne e kishim të vështirë t'i mësonim përmendësh fjalët e Kuranit, ndërsa të punuarit me Kuranin e kishim të lehtë. Ndërsa ata që do të vijnë pas nesh, do ta kenë të lehtë për ta mësuar përmendësh Kuranin dhe të vështirë për të punuar me të.”

Muxhahidi transmeton nga Ibn Umeri: “Njerëzit e vërtetshëm prej sahabëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.), në fillimet e këtij umeti, mësonin përmendësh një sure apo ndonjë pjesë prej ndonjë sureje nga Kurani Fisnik. Ndërkohë ata ishin shumë të suksesshëm në të vepruarit me Kuran. Ndërsa në fund të këtij umeti, të verbrit e tyre, madje edhe fëmijët do të lexojnë Kuran, por nuk do të jenë të suksesshëm në të vepruarit me të.” Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet se Umeri (r.a.) e ka mësuar përmendësh suren Bekare për dhjetë vjet dhe kur e mbaroi mësimin përmendësh të saj theri një deve për ta falënderuar Allahun Teala.²

Siç shihet, brezi i parë i myslimanëve, krahas rëndësisë që u jepnin fjalëve të Kuranit Fisnik, u përkushtoheshin më shumë rregullave të tij që sistemonin jetën e kësaj bote dhe të botës tjetër dhe këshillave që i jepnin drejtim jetës së njeriut. Me një shprehje tjetër, ata arritën pikën kulmore për t'i përvetësuar dispozitat e Kuranit në jetën e tyre individuale, sociale dhe ekonomike. Myslimanët, të cilët e gdhendën në mendjet e tyre qëllimin e dërgimit të Kuranit Fisnik dhe të cilët e shikonin arritjen e këtij qëllimi si ideal të nënshtrimit ndaj Zotit (xh. sh.), ia dolën mbanë për t'u bërë njerëzit prijës dhe shembullorë të kohës së tyre dhe të kohërave pas tyre. Kurani Fisnik u bë një libër që u sistemonte atyre jetën në çdo aspekt.

1. Siraxhuddin Muhamed b. Umer el-Mishkavi el-Hanki, Sherhu'l-Mukaddimeti'l-Xhezerijeti, Riad, 2008, fq. 68-69.

2. Kurtubi, Ebu Abdillahi Muhammed b. Ahmed, el-Xhamiu li Ahkami'l-Kur'an, Daru'l-Fikr, Bejrut, 1993, I, 44-45.



Myslimanët studiohen, por nuk njihen

*Myslimanët studiohen sot
në akademitë perëndimore, por synimet
e caktuara imperiale pas këtyre studimeve,
që i përjashtojnë vetë subjektet, i pengon ata
të njihen në kuptimin e vërtetë.*

— Hatem Bazian —

Kutia ime postare dhe posta elektronike janë të mbushura çdo ditë me qindra studime, revista akademike, me artikuj e libra të rinj nga publikimet të shumta që përqendrohen te myslimanët. Gjithçka rreth subjektit të myslimanëve është studiuar dhe analizuar hollësisht me vëllime mbi vëllime botimesh të njëpasnjëshme që citojnë dhe rishqyrtojnë atë çka çdokush ka thënë mbi çdo temë. Vëllimi i studimeve të kryera mbi myslimanët të lë pa mend, dhe lista zgjatet përtej aftësisë për t'i shkruar në fund asaj. Por vëllimet e studimeve të disponueshme në majat e gishtave tanë nuk e kanë bërë të mundur njohjen më mirë të myslimanëve, ndërsa e kanë shtuar përndryshe paditurinë strukturore dhe të formuar mbi subjektin. Ngjan që sa më shumë studime të ketë mbi myslimanët, aq më pak njohuri kemi për ta. Pse studimet mbi myslimanët çojnë në më pak njohuri dhe vetëdije mbi ta?

Prodhimi i njohurisë reflekton forcat sociale, politike, raciale, ekonomike dhe fetare në SHBA që dominojnë dhe që ushtrojnë kontroll hegjemonik mbi institucionet e ngarkuara dhe të financuara për të prodhuar në shkrime subjektin e problematizuar mysliman. “Kompleksi industrial i instituteve kërkimore” ia ka dalë të prodhojë studime masive, por arrin t'i mbajë myslimanët të panjohur. Njëfarë diturie e qëndrueshme është prodhuar nga studiues të kujdesshëm, por në tërësi prirjen të jenë përjasht-

timi, duke patur qarkullim të kufizuar dhe duke qenë promovuar rrallë nga elita politike dhe media e korporatave. Çfarë ka më rëndësi, prodhimi i njohurisë mbi myslimanët nuk është neutral në vlerë, e në pjesën më të madhe kryhet për të zgjidhur problemet empirike që rezultojnë nga ligjërimet e zgjatura hegjemonike të lidhura me burimet. Si ndjehesh të studiohesh por të mos njihesh, e të jesh strukturalisht i heshtur? Masa e madhe e studimeve të kryera mbi myslimanët është një problem që duhet zgjidhur, dhe mënyra si të ndalohen ata nga të qenit të dhunshëm. Pyetjet dhe përpjekjet për zgjidhjen e problemit japin përfundime të panumërta në diskutim, por jo vetë myslimanët, ndërsa vendi i tyre është i përcaktuar si thjesht subjekt në një laborator eksperimental, jo i lejuar si një element i mëvetësishëm.

Gjithçka mbi myslimanët shqyrtohet në të njëjtën mënyrë siç hulumtohet një kampion laboratorik përmes vëzhgimit të vazhdueshëm, duke u regjistruar dhe duke u trajtuar nga teknikët. “Njohuria laboratorike” aktuale mbi myslimanët prodhon punë të hollësishme së cilës i mungon thellësia dhe realiteti, ngaqë përqendrimi është në sigurimin e një përgjigjeje ndaj një problemi empirik, e jo mbi vetë subjektin.

Çështjet janë kështu të parashikueshme. Ato përfshijnë dhunën, të drejtat e femrave, sundimin despotik, irracionalitetin e supozuar, të drejtat e pakicave, korrupsionin, dhe e fundit, por jo më e parëndësishmja, pse ata na urrejnë ne. Të tëra këto çështje janë legjitime në rrethana normale, dhe duhet të mirëprehen nëse fokusi është në myslimanët që arrijnë në vetëzbulim dhe kritikë. Por, këto çështje, dhe shumë si ato, synohen për t’i studiuar dhe dokumentuar myslimanët pa qenë vetë ata pjesë në të. Përndryshe, synimi i këtyre studimeve është të prodhojë të kundërtën e njohurisë që duhet të sigurojë një kuptim dhe vetëdije më të thellë të nevojave të ndryshme të rreth 1.4 miliardë njerëzve që jetojnë në tokë me pjesën tjetër të njerëzimit.

Financimi i siguruar për studimin e myslimanëve ka vënë në lëvizje një industri shtëpiake me një rrjet të ndërlidhur fondacionesh, qendrash kërkimore, institutesh kërkimore, nyjesh të mbledhjes të të dhënave, shërbimesh përkthimi, e një varg konferencash të hapura dhe veç me ftesa. Çdo e dhënë mbi myslimanët është shqyrtuar dhe analizuar, për t’iu shtuar më pas malit të studimeve për të forcuar aftësitë hegjemonike të narrativës për të kontrolluar e dominuar nëpërmjet prodhimit të njohurisë. Këtu, kërkimi mbi myslimanët nuk është i barabartë me njohjen e personit apo të popullit të marrë në shqyrtim në kërkim. Sa më tepër kërkim

i këtij lloji të ndërmerret, aq më pak njohuri kemi ne mbi myslimanët, sepse synimi është të zgjidhet problemi empirik, e jo të vlerësohet unikaliteti dhe kompleksiteti i njerëzve gjoja të studiuar.

Problemi nuk është i ri, ndërsa “Orientalizmi” i Eduard Seidit e trajtoi në referencë me fushatën egjiptiane të Napoleonit, që përfshinte një ekspeditë shkencore për të dokumentuar vendin, për ta lehtësuar kështu projektin kolonial. Studimi i myslimanëve pa njohjen e tyre, pa patur në mendje interesin më të mirë të grupit apo të bashkësisë, e pa pëlqimin për t’u transformuar në një përmbajtje njëdimensionale, akademike, në një faqe, është një krizë etike. Ç’lloj muslimani po kërkoni dhe po shqyrtoni, për bursën tuaj, për pazarin e librit, për ta reklamuar e për ta zgjatur kohën e qëndrimit në detyrë, për paraqitjen mediatike, për përgatitjen kundër ekstremizmit të dhunshëm, për projektin e sekuritizimit, për stërvitjen e gjuhës, për gjermimin e të dhënave, për zgjerimin e tregut hallall, për strategjitë e zgjedhjeve apo për shitjet e armëve?

Çfarëdolloj muslimani që të kërkoni, një kërkues dhe një studim është i disponueshëm për të hedhur njëfarë drite mbi të. Por mos harxhoni shumë kohë duke lexuar materialin apo duke deshifruar poshtëshënimet, sepse ato janë kopjuar dhe përsëritur në pjesën më të madhe nga studimet e mëhershme empirike, e shpesh janë riprodhuar fjalë për fjalë. Një specialist i Kuranit është gati t’u japë gjithçka që ju nevojitet të dini mbi tekstin dhe njerëzit të cilët e lexojnë atë, por mos e çoni kot kohën duke i kërkuar këtij specialisti të lexojë një rresht të tekstit kuranor në arabisht apo madje të posedojë një nivel të lartë aftësie në gjuhën angleze për ta ngërthyer plotësisht përkthimin e përdorur.

Njohuria mbi myslimanët është prodhuar brenda luftës ndaj terrorizmit dhe imagjinarese së islamofobisë, ku përfundimi i çdo studimi është i paravendosur. Myslimanët studiohen për t’iu përshatur meganarrativës të ndërtuar mbi subjektin përpara madje qasjes për studim, e hamendjet në themel të metodologjisë e kanë përcaktuar tanimë rezultatin. Myslimanët jashtë terrorizmit ekzistues dhe problematik, e jashtë hipotezës islamofobike, nuk ekzistojnë, ose, nëse ekzistojnë, atëherë janë të eklipsuar nga prodhuesit e njohurisë empirike të mbërthyer fort. Myslimanët studiohen, por nuk njihen, ngaqë qëllimi i këtyre studimeve është empirik që në nise të tyre, që nuk arrin në vetëdije dhe në vlerësim më të thellë të vetë subjektit.

Përzgjedhji dhe përktheu:

Bujar M. Hoxha



Rinia

SIPAS ISLAMIT

— Mehmet Emin Aj —

Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara, rinia përkufizohet si periudha midis moshës 15-25 vjeç. Kurse sipas referencave psikologjike rinia fillon me shfaqjen e pubertetit dhe vazhdon deri në moshën 20-25 vjeç. Sipas këtyre përkufizimeve, rinia përbën një periudhë totale 10-13 vjet.

Në këtë periudhë përjetojnë ndryshime të mëdha fiziologjike dhe psikologjike. Rinia është periudha e lëkundjeve dhe transformimeve të mëdha. Periudha e rinisë është periudha më e përshtatshme për t'i dhënë formë jetës së njeriut.

Ndikimi është shumë i fuqishëm në këtë periudhë të jetës së njeriut. Rinia i ngjason pemës, e cila mugullon nga filizat dhe lulet për të dhënë frutat në fund të procesit.

Në epokën e teknologjisë dhe shkencës rinia është

grupi i synuar, sepse rinia është më e gatshme për të pranuar risitë. Por mundësitë e mëdha nuk po e bëjnë rinë më të lumtur dhe të suksesshme. Fatkeqësisht varësia ndaj cigares, alkoolit dhe drogës është shumë e përhapur midis të rinjve. Sot më tepër se kurrë rinia është e përfshirë nga sindroma e vetmisë. Të gjitha këto tregojnë që rinia kërkon më tepër interesim dhe ndihmë.

Islami me mesazhin e tij universal dhe përtej kohor i ka zgjatur duart e ndihmës në çdo periudhë njerëzimit. Në këtë kontekst nuk ka përjashtuar as rininë.

Kurani në shumë ajete na jep shembuj të personazheve historike, për shembull ngjarjen tragjike të djemve të Ademit, udhëkryqin e Nuhut (a.s.), si baba, luftën e Tevhidit të Ibrahimit (a.s.), bindjen e Ismailit (a.s.), nderin dhe durimin e Jusufit etj. Të

gjithë shembujt e Kuranit shërbejnë si udhërrëfyes për të riun mysliman.

Edhe në jetën dhe fjalët e Pejgamberit (a.s.), rinia zë një vend shumë të rëndësishëm. *“Kur të mos-huarit më përgënjeshtroan, të rinjtë më besuan”*, thotë Pejgamberi (a.s.), në një hadith.

Si Kurani ashtu edhe tradita profetike përmes shembujve ofron një sërë zgjidhjesh për problemet e rinisë.

Cilësitë që duhet të ketë i riu mysliman mund të grupohen në katër grupe.

1- BESIM I PASTËR DHE I FORTË

Islami synon që ndjenjën e besimit, e cila ekziston tek të rinjtë ta shndërrojë në një besim të shëndoshë dhe të pastër vetëm për Allahun. Shembulli tipik i një besimit të tillë, pra qysh në rini, është Ibrahim (a.s.). Por ka pasur edhe të rinj të tjerë të cilët, megjithëse jo pejgamberë, janë lëvdur në Kuran siç është shembulli i të rinjve të shpellës.

Refuzimin e Pejgamberit (a.s.), për t'u betuar në emër të Latit dhe Uzzasë (dy idhujt kryesor të arabëve) dhe urrejtjen që ushqente ndaj tyre, historianët e tregojnë si argument për mosndotjen e besimit të Tij me idhujtarinë.

Dobësia më e madhe e rinisë së sotme është mungesa e një besimi të pastër dhe të shëndoshë. Rinia e sotme është e rrethuar nga fryma hedoniste, qëllimi i vetëm i së cilës është plotësimi i kënaqësive dhe dëshirave. E vetmja mënyrë për të qenë në paqe me Zotin është besimi i pastër dhe i shëndetshëm tek Ai. Në mënyrë që të jenë në gjendje të përballojnë krizat dhe vështirësitë gjatë jetës së tyre, duhet që rinia të pajiset me një edukim fetar të shëndetshëm qysh në fëmijëri.

2- RESPEKTIMI I PRINDËRVE

Islami, menjëherë pas besimit në një Zot të vetëm, urdhëron mirësjelljen ndaj prindërve. Në shembujt të ndryshëm tregon se kjo është një vlerë që duhet të karakterizojë rininë. Ibrahim (a.s.), babait të tij, megjithëse ishte idhujtar, gjithmonë i drejtohej me fjalë të ëmbla dhe gjithë respekt. Dialogu i Ibrahimit (a.s.), me djalin e tij të vogël Ismailin (a.s.), gjithashtu është një shembull i komunikimit prind-fëmijë. Sulejmani (a.s.), i cili ishte edhe mbret edhe pejgamber, në lutjen e tij nuk harronte asnjëherë prindërit. Jahjaja (a.s.), në Kuran përmendet si një bamirës dhe mirënjohës ndaj prindërve të vet edhe Isai (a.s.), prezantohet në Kuran si një person që sillej mirë dhe respektonte nënën e tij. Pejgamberi (a.s.), sa herë që vizitonte varrin e nënës së tij përloje.

Përloja e Pejgamberit (a.s.), kur vizitonte varrin e nënës së tij, kujdesi dhe respekti i veçantë që tregonte për nënën e qumështit, janë shembuj të cilët tregojnë rëndësinë e dashurisë dhe respektimit të prindërve.

3- MIRËSIA NDAJ VËLLEZËRVE

Të afërmit e tjerë në familje me të cilët personi është në kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm janë vëllezërit. Vëllezërit shpesh janë sprovë për njëri-tjetrin. Kurani në rrëfimin e ngjarjes së djemve të Ademit, Habilit dhe Kabilit dhe hedhjen e Jusufit nga vëllezërit e tij në pus thekson pikërisht faktin e sprovës vëllazërore. Smira dhe zilia e detyroi Kabilin të vriste vëllain e tij. Edhe vëllezërit e Jusufit, të pushtuar nga e njëjta ndjenjë e hodhën atë në pus. Kurani përmes këtyre dy shembujve thekson rolin shkatërrimtar të smirës dhe zilisë. Përballë shembullit të keq qëndron Jusufi (a.s.), i cili i fali vëllezërit për veprimin e tyre. Shembull i mirësisë së treguar ndaj vëllait është Musai (a.s.), i cili iu lut Zotit ta bënte vëllain, Harunin, pejgamber si ai. Allahu, duke ia pranuar lutjen, e bëri edhe atë pejgamber.

Por Islami nuk urdhëron për mirësi vetëm ndaj vëllezërve të një gjaku, por ndaj gjithë vëllezërve të tjerë të fe.

4- FITIMI HALLALL DHE I PASTËR

Një pikë tjetër e rëndësisë së veçantë në pikëpamjen islame është edhe ushqimi hallall dhe i pastër. Nga Kurani mësojmë që të gjithë pejgamberët kanë pasur një profesion përmes të cilit siguronin jetën. Hadithet tregojnë që edhe pejgamberët kanë qenë ushqyer nga puna e tyre. Të gjitha këto tregojnë për rëndësinë e ushqimit hallall dhe të pastër. Kurse sot media i nxit të rinjtë të fitojnë përmes rrugëve të shkurtra. Sot të gjithë kërkojnë të fitojnë sa më shumë pa marrë parasysh faktin nëse puna është e ndershme apo jo. Sepse të gjithë besojnë se fitimi siguron dhe jep lumturi, por realiteti tregon se pasuria nuk jep lumturi.

Një tjetër çështje shumë e rëndësishme është pastërtia e ushqimit që konsumojmë. Sot ushqimet që konsumojmë lënë shumë për të dëshiruar për sa i përket pastërtisë. Ushqimi është shumë i rëndësishëm, sepse prej tij ndikohet edhe trupi edhe shpirti. Shumë ushqime dhe pije të cilat i serviren rinisë sot janë të dëmshme jo vetëm për shëndetin fizik, por edhe për shëndetin shpirtëror. Për ta mbyllur me një hadith, i cili është udhërrëfyes edhe për temën tonë, por për çdo çështje në jetën e përditshme: *“Braktise të dyshimtën dhe kapu pas të sigurtës”*.



Si duket kjo botë, e parë nga bota tjetër!?

— Dr. Murat Kaja —

Kur themi “bota tjetër”, në mendjen tonë merr formë një imagjinatë e caktuar. Ne imagjinojmë vendin ku duam të jemi atje dhe mirësitë që do të gëzojmë. Po ashtu, mundohemi të kuptojmë cilësitë që na janë bërë të ditura prej Kuranit dhe haditheve. Vallë, kur të fillojmë jetën e botës tjetër, si do të jetë botëkuptimi ynë ndaj kësaj bote? Si do ta shohim botën, për çfarë do të na marrë malli dhe çfarë do të kishim dëshiruar të bënim apo të ishim atje? Prandaj, le t'i shqyrtojmë disa ajete e hadithe dhe të mundohemi të evidentojmë disa prej gjërave që njeriu do t'i kujtojë me pendesë kur të jetë në botën tjetër:

1. Allahu i Madhëruar, urdhëron:

“Sikur t'i shohësh keqbërësit se si (rrinë) kokulur para Zotit të tyre e thonë: “O Zoti ynë, pamë dhe dëgjuam, andaj, kthena (në atë botë) që të bëjmë vepra të mira! Ne tashmë besojmë me bindje!” (Sexhde, 32/12)

Domethënë se, kur ta shohim prej dritares së botës tjetër, gjërat më të rëndësishme në këtë botë janë:

- Besimi me bindje të fortë dhe veprat e mira dhe të sinqerta.

I nderuari Semerkandi, shprehet se kur keqbërësit të dalin para Allahut, do të turpërohen nga ato që

kanë bërë në këtë botë.¹ Ndërsa Kurani shprehet se dënimi dhe vuajtja shpirtërore që do të ndjejnë gjynahqarët në botën tjetër, do të jetë më e madhe dhe më e tmerrshme se dënimi i xhehenemit. Më konkretisht, në ajetin 192 të sures Al-i Imran, urdhërohet se njerëzit që do të hyjnë në xhehenem do të poshtërohen jashtë mase, duke na bërë të kuptojmë se poshtërimi dhe turpërimi në Ditën e Kiametit është një nga fatkeqësitë më të mëdha që mund t'u ndodhë atyre. Për këtë arsye, menjëherë pas këtij ajeti, në ajetin 194 na mësohet se si t'i lutemi Zotit tonë, me qëllim që të mos poshtërohemi ditën e kijametit. Madje edhe Ibrahim (a.s.), i është përgjyruar Allahut që të mos e poshtërojë ditën kur njerëzit do të ngjallen përsëri.²

2. Resulullahu (a.s.), ka thënë:

“Allahu i Madhëruar e pyet atë që ka dënimin më të lehtë në xhehenem: «Nëse do të zotëroje gjithë botën dhe çka në të, a do t'i jepje për të shpëtuar nga ky dënim?» Dhe ai përgjigjet: «Po!» Pastaj, Allahu i Madhëruar, urdhëron e thotë: «Kur ti ishte ende në kurrizin e Ademit, unë të kërkova diçka më të thjeshtë se kjo: Nuk do të adhuroje askënd përveç Meje dhe Unë nuk do të fusja në xhehenem. Mirëpo ti këmbëngule në idhujtari!» (Muslim, Munafikin, 51.)

1. shih. Semerkandi, *Bahru'l-ulum*, III, 36.

2. shih. esh-Shuara 26/87.

Ato që janë cilësuar këtu, janë:

- Forcimi në teuhid, duke u pastruar nga të gjitha elementet e idhujtarisë!

3. Allahu i Madhëruar, urdhëron:

“Sikur t’i shohësh ata kur të ndalohen para zjarrit duke thënë: “Ah! Sikur të ktheheshim pas, nuk do t’i mohonim shpalljet e Zotit tonë dhe do të bëheshim besimtarë!” Po, atyre iu doli sheshit ajo që më parë e fshihnin, por edhe sikur të ktheheshin, prapë do të bënëin ato që u ishin ndaluar. Vërtet, ata janë gënjeshtarë.” (En’am, 6/27-28.)

- Të aprovosh me gjithë shpirt ajetet e Allahut, të mos bëhesh i verbër e shurdh kur të lexohen ato dhe të përpiqesh t’i mësosh e t’i jetosh ato së bashku me besimtarët e tjerë.

Çështja që theksohet këtu është fakti se gjynahqarët që dënohen në botën tjetër, do të veprojnë përsëri të njëjta gjynahe nëse dërgohen përsëri në jetën e kësaj bote. Kjo na tregon qartë se sa rrezik të madh përbën egoja e njeriut, sepse egoja e shpie njeriun në shkatërrim me vetëdije të plotë. Atëherë, është e domosdoshme që të përpiqemi shumë në edukimin e egos, madje, të luftojmë me të gjatë gjithë jetës.

4. Allahu i Madhëruar, urdhëron:

“...Sikur keqbërësit të shihnin që tani çastin kur do të përballen me ndëshkimin, do ta kuptonin se e tërë fuqia i përket Allahut dhe se dënimi i Tij është fort i ashpër. Ah, sikur ta shihnin çastin kur të adhuruarit do t’i braktisin adhuresit e tyre, kur të gjithë do të shohin dënimin e midis tyre do të këputet çdo lidhje. Atëherë adhuresit do të thonë: “Ah, sikur të ktheheshim edhe një herë (në jetën e Tokës) e t’i braktisnim ata, ashtu siç na braktisën ne!” Kështu, Allahu do t’ua tregojë veprat e tyre si burim hidhërimi për ta dhe ata s’kanë për të dalë kurrë nga zjarri.” (Bekare, 2/165-167.)

- Të kuptosh se e gjithë fuqia i takon Allahut, të qëndrosh larg prej gjynahqarëve e keqbërësve dhe të mos i ndjekësh ata!

5. Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Ndigni më të mirën e asaj që ju është shpallur nga Zoti juaj, para se t’ju vijë dënimi papritmas, pa e ndier atë dhe që njeriu të mos thotë: “Mjerë për mua që nuk i kam kryer detyrimet ndaj Allahut, madje, edhe jam tallur!”, ose: “Sikur Allahu të më kishte udhëzuar, do të isha bërë njeri i devotshëm”. Dhe, kur ta shohë dënimin të mos thotë: “Ah, sikur të ishte e mundur për t’u kthyer edhe një herë e të bëhesha njeri i mirë!” (Allahu do t’u thotë): “Me të vërtetë, juve ju erdhi shpallja Ime (Kurani), por nuk besuat dhe u bëtë mendjemëdhenj e jobesimtarë.” (Zumer, 39/55-59.)

Imam Tusteri -Allahu e mëshiroftë-, pjesën: **“Mjerë për mua që nuk i kam kryer detyrimet ndaj Allahut...”**, e komenton kështu:

“U mora me mirësitë kalimtare të kësaj bote dhe ndoqa kënaqësitë dhe dëshirat e egos, duke e humbur mundësinë për t’iu afruar Allahut. Tregova mangësi në orientimin nga Allahu dhe në mbështetjen vetëm tek Ai, duke braktisur respektimin e të drejtave të Tij dhe shërbimin në rrugën e Tij.”³

Gjithashtu, njeriu do të ndjejë keqardhje, duke thënë: *“Mjerë për mua që e braktisa përmendjen e Allahut!”⁴*

- Të ndjekësh Kuranin, të mos neglizhosh në të jetuarit e Islamit, të mos tallesh me besimtarët dhe të bëhesh njeri i mirë dhe i devotshëm.

6. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Në Ditën e Kiametit, biri i Ademit do të sillet si qengj përpara Allahut, i Cili do t’i thotë:

«Të dhashë mirësi të shumta, të dhashë pasuri dhe të bëra gjithë ato të mira. E çfarë bëre ti në këmbim të këtyre?» Robi thotë:

«O Zot! Mblodha, shtova dhe lashë pas më tepër se ç’ishte. Më dërgo pas (në jetën e tokës) dhe t’i sjell të gjitha Ty.» Allahu i Madhëruar, thotë:

«Më trego ato që ke dërguar që më parë në botën e mëtejshme!» Robi përsëri thotë:

«O Zot! Mblodha, shtova dhe lashë pas më tepër se ç’ishte. Më dërgo pas (në jetën e tokës) dhe t’i sjell të gjitha Ty.» Sepse ky rob nuk kishte dërguar asnjë të mirë që më parë. Dhe për këtë arsye, do të urdhërohet që ai të hidhet në xhehenem.»⁵

“Ky njeri, pasi nuk gjen asgjë që ta ketë dërguar që më parë, kërkon të kthehet pas në këtë botë. Mirëpo, kjo nuk është aspak e mundur.”⁶

- Të dhurosh në rrugën e Allahut të Madhëruar prej të gjitha të mirave që ka falur Ai; të nxitosh në punë të mira dhe të investosh për të ardhmen e vërtetë.

Domethënë, njeriu nuk e çmon ashtu siç duhet vlerën e jetës së tij. Përveçse, kur të dalë jashtë saj, ta shikojë nga larg e të fillojë të thotë “ah sikur!”, duke dëshiruar veprat e mira, bamirësinë dhe sevapet. Atëherë ai do të bëhet pishman për gjendjen në të cilën do të bjerë, mirëpo kjo nuk do t’i bëjë asnjë dobi. Si thoni, të bëjmë një llogari të egos sonë para se të vijë dita ku dëshirat nuk do të kenë më dobi!?!..

3. shih. Tusteri, *Tefsiru’t-Tusteri*, fq. 135.

4. Semerkandi, *Bahru’l-ulum*, III, 191-192.

5. Tirmidhi, *Kijamet* 6/2427.

6. Abdullah Ibnu’l-Mubarek, *ez-Zuhd ue’r-rekaik*; Habiburrahman el-A’zamî, Bejrut, fq. 357.



Fëmija I MBARË

— Ferit Piku —

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin fisnik: **“Pasuria dhe fëmijët janë bukuri të kësaj bote, ndërsa punët e mira kanë shpërblim më të mirë tek Zoti dhe kanë shpresë më të madhe”.** (Kehf, 46).

Fëmija është bukuria më e madhe, që mund të ketë prindi në këtë botë. Fëmija për prindin është si drita e syve. Fëmija ia mban gjallë emrin prindit edhe pasi ai të ketë ndërruar jetë. Por fëmija që është lumturia e prindit, mund të kthehet edhe në brengë të madhe. Ai mund të jetë bukuria e kësaj bote, por njëkohësisht mund të kthehet në hallin më të madh. Ai mund ta mbajë lart emrin e mirë të prindit, por edhe mund ta poshtërojë atë.

Përpara se fëmija të lindë, njeriu kërkon nga Zoti vetëm që të ketë fëmijë, duke menduar se do ta edukojë në formën më të mirë. Por pasi fëmija lind, të gjithë joshen nga bukuria, çiltërsia dhe naiviteti i fëmijës dhe harrojnë ta edukojnë atë. Dalëngadalë prindi thjesht kënaqet me fëmijën e tij, por harron ta edukojë atë. Por me rritjen e fëmijës rriten edhe kërkesat. Kështu prindit i shtohen hallet dhe brengat. Ndoshta ky fëmijë, për të cilin ti u lute që të vijë në jetë, një ditë bëhet brengë shumë e madhe për ty.

Fëmija i mbarë është dhurata më e madhe, që Zoti i jep njeriut pas besimit. Shumë njerëz luten që të kenë fëmijë, ndërsa njerëzit e mençur luten që Zoti t’iu japë fëmijë të mbarë. Fëmija i mbarë është ai, që kur e sheh të gëzon, kur i flet të dëgjon, ai që të ndihmon sa je i ri e kur të plakësh, ai përpiqet të t’i

lehtësojë hallet. Është ai që kur ti vdes, të respekton me të gjitha mënyrat, ndërsa kur je në varr lutet për ty. Fëmija i mbarë me lejen e Zotit mund të ndër-mjetësojë për ty.

Çdo prind ka aq shumë halle dhe shqetësime për fëmijën e tij, sa nuk do të mjaftonin net të tëra dimri për t’i treguar të gjitha. Të gjithë kanë dëshirë që fëmija i tyre të jetë i mirë, por si mund të arrihet kjo?! Si mundet që kjo dhuratë që na ka dhënë Zoti, të mos kthehet dënim kundër nesh?! Pas lejes së Zotit, duhen bërë disa punë dhe unë do të flas vetëm për tre prej tyre. Nëse i bëjmë këto punë, me lejen e Zotit fëmija jonë do të jetë i mbarë.

Detyra e parë është **MODELI**, sjellja jote, puna jote,



ajo që fëmija sheh tek ti. Shumë prindër ankohen, se djalin ia prishi shoqëria, shokët e këqij, por ndoshta vetë prindi nuk e ka bërë punën e tij, por e ka lënë fëmijën që të marrë atë rrugë që dëshiron, qoftë ajo e mirë apo e keqe. Fëmija imiton. Sidomos kur është i vogël, prindërit për të janë njerëzit më të mirë dhe nuk ka më të fortë dhe më të mençur sesa ata. Modeli i prindit instalon tek fëmija ose të mirën, ose të keqen. Këtu vlen shprehja “Çfarë do të mbjellësh, do të korrësh”. Nëse sot i thua: “Po i ra njeri telefonit, ti thuaji se babi nuk është në shtëpi”, nesër mos ia shkul veshin kur të gënjejë, se ia ke mësuar me gojën tënde. Nëse fëmija shikon babanë, që godet gruan e tij, mos u çudit nesër, kur të shikosh se ky fëmijë godet nënën dhe babanë e tij. Nëse fëmija sheh babanë e tij sesi falet, sesi komunikon urtë e butë në shtëpi, ai e merr si model prindin e tij edhe pse ndoshta ti nuk e ndjen diçka të tillë. Ashtu siç sillësh ti me fëmijën tënd, ashtu do të silltet edhe fëmija yt me njerëzit e tjerë. Dikush mund të thotë: “Kam dështuar në edukimin e fëmijës tim, nuk kam çfarë të bëj”. Atëherë mos i prit shpresat, por rregulloje veten tënde, se ndoshta Zoti do ta rregullojë fëmijën tënd. Investo tek vetja jote, që Zoti të investojë tek fëmija yt. Nëse prindi është munduar ta edukojë fëmijën e tij dhe gjithmonë është lutur për të, por fëmija nuk ka marrë udhën e drejtë dhe prindi vdes me shqetësim për fëmijën e tij, mund të kalojë një kohë dhe fëmija yt merr rrugën e drejtë, pendohet për çfarë ka bërë dhe fillon jetën sipas urdhrave të Zotit.

Kurani na tregon, sesi Zoti dërgoi Musain (a.s.) bashkë me Hizrin në një udhëtim shumë të gjatë. Dikur ata arritën në një qytet dhe panë një mur të shtrembër. Hizri e drejtoi murin dhe Musai (a.s.) u çudit për këtë gjë. Hizri ia shpjegoi këtë gjë dhe i tha, se ai mur ishte i dy jetimëve të atij qyteti dhe nën mur kishte një thesar. Hizri e kishte bërë atë veprim, sepse babai i atyre fëmijëve kishte qenë besimtar i mirë dhe Zoti deshi t’i ndihmonte ata fëmijë për hatër të babait të tyre. Nëse ne rregullojmë veten tonë, inshallah Zoti do t’i drejtojë fëmijët tanë. Fëmija nuk dëgjon shumë me fjalë, por ai sheh me sy. Prandaj baballarët tanë i kujtojnë prindërit e tyre për sjelljet e tyre edhe pse ka vite që kanë ndërruar jetë.

Detyra e dytë është **KËSHILLIMI PËR MIRË DHE NDALIMI NGA E KEQJA**. Shumë prindër kanë shqetësim vetëm që ta ushqejnë apo ta veshin fëmijën e tyre. Shumë prindër ndjehen keq, se s’kanë para t’i blejnë një celular, disa të tjerë duan t’i blejnë fëmijës së tyre një makinë, të tjerë duan t’i blejnë një shtëpi dhe vazhdimisht janë të shqetësuar për këtë. Shkurt gjithë shqetësimi i prindërve është tek aspekti material. Pak prindër e dinë, që investimi më i madh është edukata që merr ky fëmijë. Sa përpiqen prindërit në këtë drejtim për fëmijët e tyre?! Këshilloje fëmijën për mirë, por me të mirë dhe me të butë. Ndaloje që të mos bëjë keq, por përsëri bëje këtë me të mirë dhe me të butë, sepse kurrë nuk do të arrish që ta edukosh një fëmijë me dhunë. Feja jonë

na mëson, që t’i edukojmë fëmijët që të falen edhe pse nuk kuptojnë asgjë nga ato veprime, të cilat për momentin u duken të pakuptimta. Prindi edukon dhe fëmija skalitet. Profeti (a.s.) thotë: **“Fëmija lind në natyrën e pastër, por janë prindërit ata që e bëjnë çifut, të krishterë apo zjarrputist”**.¹ Gjithashtu mësoje fëmijën tënd që ta thotë të vërtetën dhe të mos gënjejë kurrë. Mos u mërzit kur të thyen një gotë apo diçka më të madhe se ajo. Njeriu duhet të mërzitet, kur mëson se fëmija i tij gënjen dhe mashtron. Gotat blihen përsëri, por vesi është i vështirë për t’u hequr. Prandaj edukojë fëmijën që ta ketë zemrën e madhe. Të respektojë jo vetëm ty dhe nënën e tij, por edhe dajallarët, hallat, farefisën dhe të gjithë njerëzit e kësaj toke. Sot kemi shumë familje të ngushta, që nuk dalin jashtë portës së shtëpisë së tyre. Zoti na porositi në Kuran: **“O ju që keni besuar! Ruani vetet tuaja dhe familjet tuaja nga zjarri i xhehenemit”**. (Tahrim: 6). Në këtë ajet përmendet edhe familja, sepse në përgjithësi prindi është shkaktari kryesor, që familja e tij të përfundojë në zjarrin e xhehenemit ose anasjelltas. Pra edukojë fëmijën tënd, se ky është investimi më i madh që mund të bësh për veten, për fëmijën dhe për gjithë shoqërinë.

Detyra e tretë është **LUTJA** për fëmijët e tu. Bëj dua’ (lutje) për fëmijën tënd, se ai nuk është krijesa jote, por është krijesë e Zotit dhe kur ta shohësh që ai ka devijuar, lutju Allahut (xh.sh) ta drejtojë e ta udhëzojë fëmijën tënd. Feja na mëson që të bëjmë dua’ përpara se fëmija të lindë. Kur të lindë fëmija, duhet t’i thërrasim ezanin dhe ikametin. Të bësh dua’ për të është shumë më mirë, sesa ta shash për diçka jo të mirë që ka vepruar. Prandaj profetët e Zotit luteshin gjithmonë për fëmijë të hairit dhe Zoti na urdhëron për këtë në Kuran.

Por nëse nuk ke mundësi të lutesh për mirë, kij kujdes të mos lutesh për keq. Mos u lut kundër fëmijës tënd dhe mos e mallko atë, çfarëdo lloj gjëje që të ketë bërë. Mos e mallko, sepse ti je i pari që do ta paguash faturën e këtij mallkimi. Shumë njerëz i mallkojnë fëmijët e tyre dhe kur lutja e tyre plotësohet dhe fëmijët e tyre gjenden në hall, prindërit e tyre janë më në siklet se vetë fëmija i tyre, pasi e vuajnë këtë gjë, të cilën e kanë bërë me gjuhët e tyre. Pra bëni kujdes dhe lutuni për fëmijët tuaj në vend që t’i mallkoni ata. Profeti (a.s.) thotë: **“Lutuni për çdo gjë. Mos u lutni kundër veteve tuaja. Mos u lutni kundër fëmijëve tuaj, mos u lutni kundër pasurisë tuaj”**.²

Një prind shkon bashkë me fëmijën e tij tek një dijetar i quajtur Muhamed Ibn Sirin dhe i thotë: “Ky fëmijë ma ka sjellë në majë të hundës. Çfarë mund të bëj unë me të”? Por dijetari e pyeti: “A je lutur ndonjëherë kundër këtij fëmije?” Burri tha: “Të them të drejtën po, jam lutur”. Atëherë dijetari i tha: “Shko

1. **Hadith i vërtetë**. Buhariu (1359) dhe Muslimi (2658).

2. **Hadith i vërtetë**. Muslimi (3009) dhe Ebu Daudi (1532).

se ti ia ke shkatërruar jetën këtij fëmije, përpara se ai të shkatërrojë jetën tënde”. Prandaj kurrë nuk duhet të lutemi kundër fëmijëve tanë, se vallahi ne do ta vuajmë shumë këtë gjë.

E lus Zotin që t’i bëjë fëmijët tanë të mbarë, t’i ruajë Zoti nga çdo e keqe, t’i bëjë këta fëmijë gëzim e lumturi për ne në këtë botë dhe në botën tjetër.

Shpresoj se këto fjalë që thamë, do të jenë një tërheqje vëmendje për një investim shumë të madh, që pak njerëz e bëjnë e ai është Investimi tek fëmijët. Investimi më i madh është edukata, sjellja, vlerat e këtij fëmije. Për Zotin do t’ia shohësh hairin në këtë botë dhe në botën tjetër. Historia që do të tregoj tani nxjerr në pah, se fëmija është gëzim dhe lumturi jo vetëm për prindin, por për mbarë shoqërinë.

Flitet për një zonë, ku njerëzit nuk ishin shumë besimtarë, nuk e kishin frikë Zotin, nuk e njihnin botën tjetër. Imami i xhamisë gjithmonë pas namazit të xhumasë merrte djalin e tij 11-vjeçar dhe të dy bashkë dilnin për të shpërndarë një libër të vogël që titullohej “Rruga për në xhenet”, duke shpresuar që dikush ta lexonte dhe t’i drejtohej zemra. Në një nga xhumatë po binte një shi i rrëmbyeshëm. Fëmija ishte veshur mirë, sepse ishte përgatitur që të dilte në rrugë, por kur ia tha të atit për të dalë, babai i tij iu përgjigj: “Nuk është kohë për të dalë sot, sepse po bie shumë shi dhe nuk ka as njerëz”. Fëmija i thotë: “Baba! Ti më ke thënë se ka shumë njerëz, që nuk e njohin Zotin. Prandaj edhe pse bie shi, njerëzit përsëri kanë nevojë që dikush t’ua kujtojë Zotin”. Por babai i tij refuzon që të dalë. Atëherë djali merr leje nga i ati, që të dalë vetë e të shpërndajë libra. Ky fëmijë doli me çiltërsinë e tij, duke u shpërndarë broshura të gjithë njerëzve që po kalonin, derisa në fund i mbetet vetëm një libër, i cili ftonte për në xhenet. Nuk kishte më njerëz rreth e rrotull tij, por ai ishte betuar, që nuk do të shkonte në shtëpi, derisa t’i kishte shpërndarë të gjithë librat. Atëherë mendoj të trokasë në derën e ndonjë shtëpie. Shkoi dhe trokiti në derën e një shtëpie. Trokiti një herë, dy herë, tre herë. Kur po bëhej gati të ikte, pasi askush nuk po i përgjigjej, një zë nga brenda i tha që të kthehej dhe të trokiste përsëri. Ai u kthye dhe filloi t’i binte fort derës, madje edhe vetë po çuditej që po e bënte një veprim të tillë. Kaluan gati 10 minuta dhe askush nuk po përgjigjej. Djali u bë gati të ikte, por në atë moment dikush e hapi ngadalë derën e shtëpisë. Doli një grua e përplotur. Dukej se kishte halle dhe probleme. Ajo pa këtë fëmijë me sytë që i ndrisnin, ndërsa shiu sa vinte e shtoej. Djali i zgjati librin dhe i tha: “O nënë! Zoti të do shumë ty. Lexojë këtë libër”. Pastaj iku si era. Çfarë ndodhi?!

Pas një jave, imami pasi mbaroi mësimin që mbante për njerëzit, u tha nëse kishin ndonjë pyetje. Një grua nga fundet e rreshtave të grave u ngrit dhe tha: “I nderuar imam! Me siguri ti nuk më njeh mua e as këto shoqet e mia nuk më njohin. Ka pak kohë që më ka ndërruar jetë burri. Të gjithë njerëzit më braktisën, sikur s’më njihnin. Kur e pashë veten në atë gjendje dhe kur e pashë motin e zymtë me shi dhe rrebesh, shkova në katin e dytë të shtëpisë time dhe vendosa të var veten time. Por çuditërisht filloi të binte dera. Kujtova se mos është ndonjë kalimtar i rastit dhe prandaj nuk e hapa derën për 5 minuta. Por kur dera filloi të binte me forcë, atëherë pyeta veten se kush interesohej për mua. Dola dhe pashë një fëmijë, që i ndriste fytyra dhe sytë nga gëzimi. Më zgjati një libër dhe më tha: “Nënë! Zoti të do ty”. Pastaj iku me të shpejtë. Mbeta vetëm me librin në dorë. Libri titullohej “Rruga për në xhenet”. Kur lexova atë libër, pashë që po bëja gjynahun më të madh, po vrisja veten time. E pashë që Zoti kishte menduar për mua dhe sot jam në këtë vend falë Zotit dhe shkak për këtë është ai fëmijë, që më dha atë libër”. Imami e dinte, që ai fëmijë ishte djali i tij 11-vjeçar, i cili insistoi të dilte atë ditë.

Të gjithë njerëzit qanin nga gëzimi. Imami u ngrit, e puthi djalin e tij në ballë dhe tha: “Ty të bëri Zoti shkak për ta shpëtuar atë grua dhe jo mua. Unë them fjalët, por punën e bëre ti”. Kjo është kënaqësi dhe realisht fëmija i mirë është gëzim për prindin e tij, por është pasuri e madhe për të gjithë njerëzit e tjerë.

Prandaj Zoti na ndihmoftë që të bëhemi të mirë në veten tonë, që të ndikojmë sadopak tek fëmijët tanë. Atyre që Zoti nuk iu ka dhënë fëmijë, e lus Zotin t’iu japë fëmijë të mirë. Atyre që Zoti u ka dhënë fëmijë, inshallah Zoti i ndihmon që t’i edukojnë fëmijët e tyre. Atyre që Zoti i ka sprovuar dhe fëmijët e tyre kanë devijuar nga rruga e drejtë, Zoti me mëshirën e Tij i ktheftë në rrugën e hairit dhe i largoftë nga shoqëria e keqe. Atyre që Zoti i ka sprovuar, duke ua marrë jetën e fëmijëve të tyre, inshallah Zoti u jep durim dhe i bën ata fëmijë ndërmjetësues për prindërit e tyre në botën tjetër, pasi profeti (a.s.)ka thënë: “**Kur Zoti ia merr robët të vet fëmijën dhe ai bëhet i durueshëm, do të ketë si shpërblim Xhenetin**”.³ Zoti i bëftë fëmijët tanë të mirë dhe të mbarë dhe ne na bëftë fëmijë të mirë për prindërit tanë, pasi edhe ata persona që janë me thinja në kokë, ta dinë se janë fëmijët e dikujt. Zoti na ndihmoftë gjithmonë.

Amin!..

3. **Hadith i vërtetë.** Buhariu (6060).

A u mbush kavanozi?

Një mësues u tha nxënësve se do t'u tregonte diçka interesante. Ai vendosi një kavanoz të madh mbi tavolinë. Pastaj nxori nga çanta disa copa të mëdha prej guri dhe i futi në kavanoz. Kur nuk mbeti më vend në kavanoz, pyeti: "A është mbushur kavanozi?"

Të gjithë nxënësit që gjendeshin në klasë u përgjigjën: "Po."

Pasi mori këtë përgjigje, mësuesi nxori gurët e vegjël të çakllit, i futi në kavanoz dhe përsëri i pyeti nxënësit: "A u mbush kavanozi?"

Nxënësit të cilët këtë herë fituan një këndvështrim tjetër të situatës, u përgjigjën: "Jo."

Këtë radhë mësuesi nxori një enë të vogël të mbushur me rërë. Ai e hodhi rërën në kavanoz dhe përsëri i pyeti fëmijët: "A u mbush kavanozi?"

Pasi fëmijët u përgjigjën të gjithë duke bërëtitur me të madhe: "Jooo.", mësuesi hodhi ujë në kavanoz dhe u shpreh: "Copat e mëdha të gurëve janë familja, fëmijët, shëndeti, shokët dhe gjërat e tjera të rëndësishme për ju. Gurët e çakllit janë gjërat më pak të rëndësishme për ju si puna, shtëpia dhe makina. Ndërsa rëra simbolizon gjërat e vogla fare. Nëse në kavanoz së pari do të hidhnit rërën, nuk do të mbetej vend për copat e mëdha të gurëve dhe për gurët e çakllit." Pastaj shtroi këtë pyetje që secili duhet t'ia bëjë vetes: "Cilat janë copat e mëdha të gurëve në jetën tuaj? A i fusni ato të parat në kavanoz? Mos vallë e mbushni kavanozin me rërë dhe ujë, ndërsa copat e mëdha i lini jashtë?"



NJË POEZI

*Dituri do të thotë të dish, veten të njohësh,
Nëse veten s'e njeh, është e kotë të lexosh?
Qëllimi i leximit, është që rob i Zotin të njohë,
Nëse lexon e nuk njeh, kjo punë është e kotë!
Njëzetënëntë rrokje nga kreu në fund i lexon,
Elif thua ti, mësuesi, çfarë do të thotë?*

(Junus Emre)

NJË THËNIE

*"E ardhmja e një vendi
është e lidhur me edukimin
që marrin njerëzit e atij vendi."*

(Albert Ajnshtajn)

NJË LUTJE

*"O Zoti ynë! Na bëj të përlur ndaj Teje! Bëj
që edhe pasardhësit tanë të jenë të përlur
ndaj Teje! Tregona ritet e Haxhit dhe pranoje
pendimin tonë, se, pa dyshim, Ti je Pranuesi i
pendimit, Mëshirëploti!"*

(Bekare, 128)



NJERIU është mësues I ASAJ QË DI

— Kybra Çoban —

Jemi në një periudhë ku besimi është bërë si thëngjill në dorën tonë, në të cilën pothuajse është bërë e pamundur të mbrohesh nga mëkatet e të qëndrosh larg haramit dhe në të cilën çdo musliman e ka farz (obligim) “emri bil-maruf, nehji anil munker”. Ne jemi umeti i kohës së fundit. Jemi në një kohë të vështirë. Po, “urdhërimi i të mirës dhe ndalimi nga e keqja” është detyra e ne të gjithëve...

Ndoshta do të thoni:

“Si mund t’i bindim të tjerët, ndërkohë që nuk kemi bindur akoma veten tonë? Çfarë dobie do të kenë njerëzit prej nesh, ndërkohë që edhe ne vetë kemi ardhur në një gjendje që nuk e dallojmë dot se cila është e gabuar dhe cila është e vërtetë? Faktikisht nuk kemi edhe shumë dije, kështu që kujt dhe çfarë kemi për t’i mësuar?..”

Atëherë, a do të heqim dorë nga adhurimi duke u justifikuar me këto? A do të jemi indiferentë, edhe pse e dimë proverbin: “Çdo dele varet nga këmba e saj?” Sigurisht që jo!

Ne duhet të fillojmë nga diku për ta ndryshuar, për ta rregulluar dhe për ta drejtuar dynjanë nga e mira... Së pari duhet të fillojmë nga vetja jonë...

Për këtë arsye, duhet të përpiqemi që çdo ditë të mësojmë nga një gjë të re dhe çdo gjë që kemi mësuar, duhet ta reflektojmë në jetën tonë ashtu si sahabët e nderuar, sepse atij që punon me atë që di, Allahu Teala premton se do t’i mësojë gjëra të reja. Çdo gjë që jemi përpjekur ta mësojmë dhe ta praktikojmë, duhet ta ndajmë edhe me ndonjë tjetër. Ndoshta nuk dimë çdo gjë dhe çdo gjë që dimë nuk e praktikojmë në mënyrë të përsosur,

por nuk duhet të harrojmë se “njeriu është mësuesi i asaj që di”.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), u tha shokëve të Tij në Hutben e Lamtumirës:

“Kur ndonjëri prej jush të mësojë diçka prej meje, le t’ia mësojë atë edhe dikujt tjetër! Ka të ngjarë që ai i cili e mëson më vonë, mund ta kuptojë dhe praktikojë atë më mirë se ai që ia mësoi.” (Tirmidhi, Ilim, 7.)

Edhe ne, duke filluar nga më të afërmit tanë, duhet t’i ndajmë me njerëzit ato që dimë sipas vendit, gjendjes, shkallës së aftësisë së të kuptuarit të bashkëbiseduesit dhe në një mënyrë të përshtatshme me cilësitë e tij. Në të kundërt, nëse, në Ditën e Kiametit, ata do të ankohen prej nesh duke u shprehur se nuk ua kemi mësuar të vërtetën edhe pse e dinim. Detyra jonë është që të përpiqemi t’ua mësojmë e shpjegojmë njerëzve fenë dhe t’i ndalojmë nga të këqijat...

Atëherë, si do ta bëjmë këtë ndërkohë që njerëzit janë tërbuar?

Së pari duhet të mendojmë në vetvete se në ç’mënyrë do na pëlqente të merrnim ndonjë këshillë kundrejt gabimeve tona. Sigurisht nuk do ta dëgjonim një njeri që vazhdimisht gjen gabimet tona dhe flet duke na fajësuar pa u ndalur, edhe nëse do të thoshte të vërtetën... Të vjetrit kanë thënë: “Vlerësimi të jep kurajë, ndërsa qortimi të demoralizon.” Çdo njeri patjetër që ka një anë pozitive, kështu që duhet t’i japim kurajë duke ia shfaqur atë anë dhe nuk duhet t’i ekzagjerojmë mangësitë dhe gabimet e tij. Metoda profetike na mëson që edhe një qeni që kundërmon erë të keqe, t’i shohim dhëmbët e tij të bukur... Është e lehtë ta refuzosh apo të tregosh vazhdimisht për mangësitë e tij!..

Për më tepër, ne nuk i duam shumë ata njerëz që tentojnë të kenë autoritet mbi ne dhe themi: “Askush nuk mund të më imponojë ndonjë gjë.” Megjithatë, përpiqemi për të bërë çdo gjë të atyre që na urdhërojnë me mirësi dhe nuk vështirësohemi për ta kryer atë. Atëherë, sjellja jonë nuk duhet të jetë imponuese dhe detyruese, por duhet t’i urdhërojmë njerëzit me një gjuhë të butë e të ëmbël dhe me buzëqeshje. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Lehtësoni dhe mos vështirësoni! Përgëzoni dhe mos i bëni të tjerët që të urrejnë!..” (Buhari, Ilim, 11.)

Allahu Teala çdo njeri e ka krijuar me karakter dhe cilësi të ndryshme. Dikujt i pëlqen ashpërsia, dikujt mirësjellja, dikush i kupton siç janë ato që

thuhën, ndërsa dikujt tjetër duhet t’ia shpjegojmë me shembuj me mënyra indirekte. Ajo që dikujt mund t’i duket e vështirë, mund të jetë e lehtë për dikë tjetër. Dikush kupton më mirë duke parë, dikush duke dëgjuar... Por askujt nuk i pëlqen fajësimi, poshtërimi dhe krahasimi me dikë tjetër.

Për ta kryer në mënyrën më të mirë “emri bil maruf, nehji anil munkerin”, meqë gradë-gradë është farz për çdo mysliman, duhet të mësojmë metodat e predikimit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), i cili është udhëzuesi ynë i vetëm dhe duhet t’i zbatojmë sipas vendit dhe kohës së tyre. Gjërat që Pejgamberi, (a.s.), donte t’ua mësonte të tjerëve, ua mësonte sipas gjendjes së tyre dhe me mënyra të ndryshme. Nganjëherë u bënte pyetje, nganjëherë vizatonte skema, a nganjëherë më gjuhën e trupit, nganjëherë duke bërë shaka, duke ua treguar dhe duke ua shpjeguar... Domethënë, nëse synimi është një, është e mundur të arrihet me rrugë të ndryshme por të lejuara...

Allahu Teala thotë në suren Asr:

“Pasha kohën! Me të vërtetë, njeriu është në humbje. Përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, i këshillojnë njëri-tjetrit të vërtetën e i këshillojnë njëri-tjetrit durimin.” (Asr, 1-3)

Domethënë, mënyra e shpëtimit nga humbja është besimi, vepra e mirë dhe këshilla për të vërtetën e durimin... Besimtarët duhet të jenë si dy duar që lajnë njëra-tjetrën dhe si një mbulesë e vetme që mbulojnë gabimet e njëri-tjetrit.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë në hadithet fisnike:

“Ai që bëhet shkak për një mirësi, është si ai që e ka bërë atë.” (Tirmidhi, Ilim, 14.)

“(O Ali!) Betohe me në Allahun se, nëse Allahu Teala udhëzon qoftë edhe një njeri nëpërmjet teje, është më e mirë për ty se devetë e kuqe (që konsideroheshin si mirësia më e madhe e dynjasë).” (Buhari, As’habu’n-Nebi, 9.)

O Zot! Na bëj prej robërve të udhëzuar dhe prej atyre nëpërmjet të cilëve udhëzohen robërit e Tu!.. Jetën tonë bëje shkak për shtimin e çdo lloj mirësie dhe vdekjen tonë shpëtim nga çdo gjë e keqe! Të gjithëve na bëj prej atyre që përjetojnë mirësi, që prijnë për në mirësi, që i bëjnë të tjerët të jetojnë në mirësi dhe prej atyre që bëhen shkak për mirësi! Na bëj të jetojmë përderisa jeta jonë të jetë më e mirë dhe na prano në audiencën Tënde me fytyrë të bardhë kur vdekja të jetë më e mirë për ne!..

Amin!

Për një fjalë të bukur

— Seher Ajdën —

Njeriu, që është një qenie e dobët dhe e pafuqishme, gjatë gjithë historisë ka ndjerë nevojën e strehimit dhe zotërimit. Me nevojën e strehimit ka plotësuar anën e tij të vogëlsisë dhe paaftësisë. Ndërsa me ndjenjën e zotërimit ka dashur të kënaqë dobësitë e nefsit. Pikërisht, ana e nefsit të njeriut, i cili është krijuar nga balta, e tërheq atë drejt tokës (fitimeve të pritshme e shterpa) që është gjithmonë e ulët. Ndërsa shpirti që Zoti i botëve i ka fryrë, e drejton njeriun në vepra të larta e fisnike.

Duke bërë vazhdimisht zgjedhje sipas dëshirës së tij mes këtyre dy poleve, njeriu që e bën të qartë vendin e tij, në shumë raste mjaftohet me të dukshmen dhe e harxhon gjithë jetën e tij për pasuri dhe fitime. Si Nemrudët që e shpallën veten posedues të gjithë sipërfaqes së tokës apo si Karunët që mjaftoheshin e lumturoheshin me sarajet dhe thesaret e tyre... Ndërsa sahabet, dijetarët, fetarët e drejtë, të gjithë këta me në krye Pejgamberët, investimet e tyre nuk i kanë bërë për ambiciet e tyre kalimtare, por për pasuritë e përhershme që ngrihen në Arsh.

Ashtu si Pejgamberi, (a.s.), e pa të shkurtër jetën e kësaj bote, sa të ulesh e të pushosh nën një pemë e pastaj të ngrihesh; por Ai e zbukuroi atë vend me veprat dhe me fjalët më të bukura. Si rezultat i këtyre bukurive, armiqtë u bënë miq dhe me dashurinë e singertë ndaj Allahut ranë në shtratin e vdekjes.

Këto bukuri nuk kanë rrethuar vetëm njerëzit që jetojnë së bashku, por të gjitha kohërat dhe popujt nga lindja në perëndim, nga fillimi deri në fund. Biri i Abdullahut, Muhamedi, (a.s.), që ishte jetimi dhe i varfri i Mekës, sot është burimi më i madh pasuror i zemrave dhe jetës më fisnike.

FJALA

Fjala, që është dalluesi i njerëzve, është e shenjtë. Zoti i botëve, kur na bëri pyetjen e parë, na pyeti me dy fjalë; krijesat janë pranuar si besimtarë me një çift fjalësh. Për të hyrë në rrethin e Islamit, duhet një çift fjalësh. Për këtë arsye Allahu Teala një fjalë të bukur e shpreh si një pemë të bereqetshme rrënjët e së cilës janë thellë në tokë, degët i ka lart në qiell dhe që gjithmonë jep fruta. (shik. Ibrahim, 24-25)

Trupi i vdekshëm, i cili është zotërues i fjalës, edhe nëse ndahet nga jeta e kësaj bote, ajo fjalë gjithmonë do ta vazhdojë frytdhënien dhe riskun. Ashtu si tregimet dhe këshillat të cilat sot i japin jetë shpirtit tonë...

Kur ne jemi të pakujdesshëm kundrejt urdhrave të Allahut Teala, na bëhet shembull pendimi i Pejgamberit Adem (a.s.). Themi si ai me pendim dhe modesti:

“... O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na fal dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit.” (Araf, 23)

Në dhimbjet më të vështira e të padurueshme, ulemi te gjunjët e Jakupit, alejhisselam, mësojmë nga ai durimin dhe si ai gjejmë ngushëllim:

“...Tashmë ajo që më takon mua, është të duroj.” (Jususf, 18, 83)

Kur zotërojmë pasuritë dhe madhësitë e botës, falënderojmë ashtu si Sulejmani, alejhisselam, **“... Kjo është misësia e Allahut...”** (Neml, 40)

Fjala, kur thuhet, është e lidhur me kohën dhe vendin, por ajo ka aftësi t'i kapërcejë

ato, duke u bërë udhërrëfyese edhe në kohë dhe vende të tjera. Çdo fjalë merret nën përgjegjësi dhe shënohet në regjistër. Ky është shkaku që në hadithin fisnik këshillohet:

“Ose flisni fjalë të bukura, ose heshtni.” (shik. Hakim, IV, 319/77.)

Përpyekja më fisnike e kësaj fjale aq të shenjtë dhe të rëndësishme; shpjegimi i Zotit të botëve dhe mesazheve të Tij; është zbatimi i **“emr-i bil mâruf nehy-i anil mun-ker”**, pra **“urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja”**. Kështu pra Allahu që na do më shumë se ç’e duam ne veten tonë, dëshiron që asnjë nga robërit e Tij të mos jetë i trishtuar. Shfaq gjithmonë raste dhe hap dyer që të robërit të kenë mundësinë të fitojnë mirësitë që ka përgatitur në Xhenet. Madje një hapi të robit i përgjigjet me dhjetra hapa.

Prandaj ata që nuk dinë, i këshillon të mësojnë dhe të dëgjojnë, ndërsa atyre që dinë u bën të ditur fisnikërinë e të shpjeguarit dhe të mësuarit të tjerëve. Robërit të cilët mbledhen dhe lexojnë Kuran, ua lavdëron engjëjve. Atyre që mbledhen për kënaqësinë e Tij, ua fal të gjitha mëkatet akoma pa u larguar nga ai kuvend dhe i pastron ata nga papastërtia e çdo lloj mëkati. Atij që u mëson njerëzve një hadith fisnik, në Ditën e Kiametit ia zbardh fytyrën.

Një nga sahabët e nderuar me emrin Durre (r.a.), tregon:

“Një ditë, ndërkohë që Pejgamberi, (a.s.), qëndronte në xhami, i shkova pranë dhe e pyeta:

“O i Dërguari i Allahut!.. Kush është më i devotshmi nga njerëzit?”

Pejgamberi, (a.s.), tha:

“Ai që urdhëron më shumë për të mirë, ndalon më shumë nga e liga dhe që interesohet më shumë për të afërmit.” (Kenzu’l-Ummal, III/689.)

Ndërsa Enes bin Maliku i cili e kaloi të gjithë fëmijërinë dhe rininë pranë Pejgamberit, (a.s.), thotë:

Në një nga bisedat e Tij, Pejgamberi, (a.s.), ka thënë:

“A t’ju njoftoj për ata persona të cilët, edhe pse nuk janë pejgamberë apo shehidë, në Ditën e Kiametit profetët dhe dëshmorët do ta lakmojnë pozitën e tyre prej drite?”

Sahabët e nderuar pyetën:

“Cilët janë ata, o i Dërguari i Allahut?”

Pejgamberi, (a.s.), tha:

“Janë ata persona të cilët ua bëjnë të dashur Allahun robërve dhe robërit ia bëjnë të dashur Allahut. Janë ata njerëz të cilëve u është ngarkuar detyra e predikimit mbi sipërfaqen e tokës.”

Kur ata pyetën sërish:

“O i Dërguari i Allahut! Ne e dimë mirë se si t’ia bëjmë të dashur Allahun robërve, por nuk dimë si mund t’ia bëjmë të dashur robërit, Krijuesit të tyre, Allahut! Pejgamberi, (a.s.), tha:

“Ata i inkurajojnë robërit për gjërat që i do Allahu dhe i ndalojnë ata nga gjërat që Ai (xh.xh.), nuk i do. Dhe kur ata zbatojnë veçoritë që u tregohen, Allahu i do ata.” (Bejhaki, Shuanu’l-Iman, I, 367.)

Fitimi më i madh në jetën e kësaj bote dhe detyra më fisnike është t’u flasësh njerëzve për Allahun Teala, Zotëruesin e vërtetë të të gjitha mirësive që kemi, t’u tregosh për urdhrat dhe ndalesat e Tij dhe për shkak të kësaj të arrish kënaqësinë e Tij (xh.xh.). Dy fjalë që kemi mundur t’i mësojmë, janë kapitali ynë më i madh. Ashtu siç thuhet në suren el-Fatir, ajeti 10:

“Kush dëshiron lavdi e pushtet, ta dijë se e gjithë lavdia e pushteti i takojnë Allahut. Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë. Sa i përket atyre që kurdisin të këqija, ata do të kenë dënim të rëndë dhe dredhitë e tyre do të dështojnë.” (Fatir, 10)



USHQIMET E DOMOSDOSHME

për një shëndet të mirë

Janë disa produkte që nuk duhet të mungojnë asnjëherë në shtëpinë tonë. Këto produkte, jo vetëm pasurojnë edhe më shumë tryezën tonë, por edhe e shkurtojnë kohën e përgatitjes së tyre.

FRUTAT DHE PERIMET

Shpeshherë konsumimi i drithërave, i brumërave dhe i sheqerit sjellin një mbingopje të organizmit me karbohidrate. Prandaj këshillohet të konsumohen frutat dhe perimet, duke qenë të pasura me vitamina dhe betakaroten e ato janë antioksidantë të fuqishëm që ndihmojnë. Në vazhdim do të paraqesim disa këshilla për shëndet të mirë.

Bananet, sallata jeshile, limoni, trangujt, karotat, ananasi, brokoli, kungulleshkat, patatet, frutat dhe perime të tjera meritojnë vend të posaçëm në frigoriferin tonë, sepse janë shumë ushqyese, kanë vitamina dhe minerale të cilat nuk mund t'i gjejmë në produkte tjera, kanë numër të ulët të kalorive e disa nga to nuk kanë fare kalori, përgatiten lehtë dhe konsumohen të kombinuara me shumë lloje të ndryshme të mishrave. Ato kanë efekte të jashtëzakonshme shëndetësore në të gjithë trupin, prandaj konsumimi i tyre preferohet shumë. Frutat dhe perimet mund të konsumohen shumë mirë edhe në formën e lëngjeve. Lëngje të këtilla janë shumë ushqyese dhe i japin organizmit energji gjatë tërë ditës. Ato mund të konsumohen në çdo kohë. Është mirë që në lëngjet e frutave dhe perimeve të mos përdore sheqer, sepse mund të shtojë numrin e kalorive. Lëngjet e tilla konsiderohen edhe si ushqime dietike.

MERRNI SA MË SHUMË SELEN

Minerali i selenit është një ndihmës i mirë në luftën kundër kancerit, obezitetit dhe mbipeshës. Personat, të cilët kanë të ulët nivelin e selenit në gjak apo antioksidantëve të tjerë kanë një bel më të trashë se ata persona që kanë një nivel më të lartë seleniumi. Seleni gjendet te drithërat, djathi dhe arrat.

SHTONI USHQIMET E PASURA ME PROTEINA

Të hani një ushqim sa më të pasur me proteina ju jep shumë energji. Por, konsumimi i tepruar mund të sjellë dhe mungesë kalciumi. Është e nevojshme që 25 për qind e kalorive të merret nga proteinat. Nëse ju konsumoni 2000 kalori në ditë, 500 prej tyre duhet të jenë proteina. Produkte të nevojshme janë: qumështi, kosi, peshku, mishi etj.

KONSUMONI YNDYRAT E DUHURA

Disa studime kanë treguar se për të pasur një trup sa më elegant duhet të konsumohen yndyra të pangopura të gjendura te vaji i ullirit, omega-3 i gjendur te peshku në forma vajore, yndyrat omega-6 që gjenden te vaji i misrit, te vezët, etj.

KUJDES!

Është e shëndetshme dhe preferohet që të mënjanohen produktet e konservuara nga frigoriferi ynë për shkak të koncentreve që posedojnë dhe disa herë të kontrollojmë afatin e qëndrueshmërisë së një produkti për shkaqe shëndetësore.



DUHANI DËMTON edhe shikimin

Përveç zemrës dhe mushkërive, pirja e duhanit më shumë se 20 cigare në ditë mund të dëmtojë edhe sytë, sipas zbulimit të universitetit Rutgers.

Në këtë studim janë përfshirë 71 persona të shëndetshëm, tetë nga të cilët kanë pirë më pak se 15 cigare në ditë, dhe 63 persona që pinin më shumë se 20 cigare në ditë. Pjesëmarrësit ishin midis moshave 25 dhe 45 vjeç.

Studiuesit kanë shqyrtuar mënyrën dhe nivelet e kontrasteve (dallime delikate në mbrojtjen nga drita) dhe ngjyrave nga një monitor CRT.

Rezultatet treguan ndryshime të rëndësishme tek

duhanpirësit në lidhje me shikimin e ngjyrave të kuqe dhe gjelbër dhe ngjyrave blu dhe të verdha, i cili sugjeron se konsumimi i substancave kimike, të tilla si ato të përfshira në cigare, mund të shkaktojë një humbje të përgjithshme të vizionit të ngjyrave.

Studimi tregon se duhanpirësit e rëndomtë kanë një aftësi më të reduktuar për të dalluar kontrastet dhe ngjyrat se sa joduhanpirësit.

Edhe pse kërkimi nuk jep një shpjegim fiziologjik për rezultatet, ekipi i shkencëtarëve thekson se nikotina dhe tymi dëmtojnë sistemin e enëve të gjakut si dhe retinën e syve.

DËMET E MUNGESËS së Kalciumit

Kalciumi është shumë i përhapur dhe në organizmin e njeriut ka rreth 1 deri 1.5 kg kalciumi. Pothuajse 100 për qind e kalciumit në trup gjendet në kocka dhe dhëmbë, dhe ai është i nevojshëm për një trup të shëndetshëm dhe funksionim të mirë të të gjithë organizmit.

NGËRÇET NË MUSKUJ

Simptomat e mungesës së kalciumit në organizëm përfshijnë: dridhje në gishtat dhe ngurtësi, spazma të muskujve dhe dhimbje gjatë konvulsione, oreks i dobët, marrja e dobët e ushqimit, ritmi jonormal i zemrës, dhimbje në laring, vështirësi në frymëmarrje, depresion, madje edhe psikozë.

DËMTIMI I TRURIT DHE ZEMRËS

Në rast të defektit afatgjatë mund të ndodhë dëmtimi i trurit dhe dëmtimi i përhershëm i zemrës. Pje-

sët e para të trupit në të cilin do të ndjeni mungesën e kalciumit janë muskujt dhe eshtrat. Përveç kësaj, rreziku i marrjes së osteoporozës si dhe frakturave të kockave rritet.

Përveç kalciumit, është e rëndësishme që të keni mjaft vitaminë D dhe magnez, pasi ato luajnë një rol të madh në thithjen e duhur të saj. Ushqime të pasura me kalcium janë: algat detare, qumështi dhe produktet e tij, spinaqi, panxhari, rrepka, bizelet, lakra, brokoli, mjalti, fiq të thatë, banane, bajame, portokalli.

Trupi nuk mund të prodhojë kalcium në mënyrë të pavarur. Ju nuk keni nevojë të merrni ndonjë shtesë nëse e hani atë mjaftueshëm përmes dietës suaj. Trupi absorbon më mirë kalciumin nëse e administron atë përmes dietës, krahasuar me plotësimin, dhe disa studime kanë treguar se shtesat e kalciumit mund të rrisin rrezikun e gurëve të veshkave.



APPLE ME ORË INTELIJENTE PËR EKG

Seria e pestë e orës së mençur Apple do të vijë me dizajn të përmirësuar qeramike dhe mbështetjen elektrokardiogram në rajone të shumfishta. Kjo bazohet në detajet më të fundit nga raporti i investitorëve, i cili erdhi nga analisti Ming-Chi Kuo.

Funksioni EKG është aktualisht në dispozicion vetëm për përdoruesit në SHBA, pasi që Apple duhet të merret me rregullore të ndryshme shëndetësore në vende të ndryshme, në mënyrë që të zbatojë këtë funksion në elektronikën e saj.

Problemi me kalimin e kësaj karakteristike në një orë të zgjuar është se pajisja bëhet një "pajisje mjekësore", një kategori krejtësisht e ndryshme, e rregulluar me ligje dhe rregulla të ndryshme.

Përveç kësaj, Kuo përmend se Apple Watch Series 5 do të ketë një dizajn të ri prej qeramike. Nuk dihet saktësisht se çfarë do të thotë kjo, por dihet se versionet premium të qeramikës të modeleve më të hershme të Apple Watch kishin disa probleme, kështu që ridizajni ka kuptim.

SHKENCËTARËT ZBULOJNË ORËN E DYTË BIOLOGJIKE NË TRUPIN E NJERIUT

Shkencëtarët e Harvardit kanë gjetur ADN ribosomale të njohur si ora rDNA, ose një orë biologjike që zbulon se sa vjeç jemi. Dr. Bernardo Lemos, një profesor i epigjenetikës mjedisore në Harvard, thotë se pjesë të vogla të ADN-së mbledhin sinjale rreth viteve aq mirë sa shfaqin vitet tona biologjike. Ai dhe bashkëpunëtorët e tij thanë se rDNA ishte një "armë tymi" në kontrollin gjenom të plakjes. Ata mendojnë se ai mund të shpjegojë orën e mëparshme të panjohur.

Për të përcaktuar sa shpejt ose ngadalë ora biologjike prek secilin prej nesh, shkencëtarët po kërkojnë metilatin, një molekulë të vogël në ADN. Ora biologjike është pjesë e një gjenomi që ndihmon shkencëtarët të përcaktojnë atë që quhet orë biologjike, që tregon sa është trupi i dikujt në të vërtetë i vjetër në bazë të ndryshimeve që ndodhin në ADN

dhe mund të ndihmojnë në parashikimin e sëmundjeve. Tani është shumë më e lehtë për shkencëtarët të ndjekin orën biologjike, pasi në vend që të shohin një sërë kromozomesh në disa vende, tani ata janë duke ndjekur vetëm një gjenom të veçantë.



“Ky është me të vërtetë një zbulim i madh pasi metilati përgjatë ADN-së mund të përdoret për përcaktimin e saktë dhe konfidencial të moshës. rDNA është ndoshta një hap në drejtimin e duhur për të lidhur disa orë të ndryshme mekanikisht”, tha Lemos.

Ajo që i dha Lemos besim në zbulimin e tij është dobia e veçantë që ka bërë kur është fjala për përcaktimin e zgjedhjeve që trupi ynë i bën për të përshpejtuar ose ngadalësuar procesin e plakjes.

Kur vëzhgoi orën rDNA në minj që ishin pjesë e eksperimentit, ai zbuloi se ora e tyre tregonte më pak sinjale të plakjes biologjike, edhe kur minjtë ishin më të moshuar.

Njohja e orës biologjike dhe mënyra e funksionimit të tij mund të na ndihmojë të ndikojmë në procesin e plakjes biologjike. Shkencëtarët po përpiqen të zbulojnë se si ushqimi përmes proceseve kimike përshpejton ose ngadalëson orën biologjike.

OPERATORËT BËJNË THIRRJE PËR TESTIME SIGURIE TË PAJISJEVE 5G

Industria e rrjeteve mobile bëri thirrje për implementimin e një skeme të re Evropiane për testimin e sigurisë së pajisjeve 5G përpara se të implementohen.

Disa vende kanë ndaluar kompani të caktuara për furnizimin e operatorëve lokalë me pajisje të rrjetit 5G për shkak të shqetësimeve të sigurisë. Gjigandi Huawei dhe ZTE janë dy prej kompanive më të prekura.

GSMA, një shoqatë e cila përfaqëson 800 operatorë celularë, tha një skemë testi do të eliminonte nevojën për të bllokuar furnizues të ndryshëm. Australia, Zelanda e Re dhe Shtetet e Bashkuara kanë ndaluar Huawei të furnizojë operatorët celularë me pajisje për rrjetin 5G.

Kanadaja gjithashtu po kryen hetime ndaj produkteve të Huawei ndërsa gjigandi Britanik BT ka vendosur të heqë pajisjet e Huawei nga bërthama e rrjetit 5G.

Shumë vende tremben se qeveria Kineze përdor

Huawei për të spiunuar rivalët dhe vjedhur informacione. Huawei është shprehur disa herë se nuk ka lidhje me qeverinë Kineze dhe nuk i bashkon asgjë përveç taksave. Por kritikët vënë në pikëpyetje lirinë e çdo biznesi Kinez përballë influencës së Pekinit. GSMA shqetësohet se bllokimi i kompanive si Huawei mund të shtyjë implementimin e 5G-së dhe të rrisë kostot.

“Pasoja të tilla janë plotësisht të shmangshme,” thuhej në deklaratën e GSMA.

Institucioni shpreson që të krijojë një task force Evropiane për të testuar pajisjet. GCHQ Britanike kishte bërë teste të pajisjeve të Huawei dhe kishte evidentuar “mangësi” duke mos dhënë garanci se firma nuk përbën kërcënim. Deklarata e GSMA gjeti mbështetjen e Deutsche Telekom dhe Telefonica. Vetë Huawei është anëtar i GSMA dhe një prej mbështetësve më të mëdhenj të Kongresit Mobil Botëror që do të mbahet në fund të muajit nga GSMA.





“Ata që të janë betuar
për besnikëri,
në të vërtetë, i janë betuar
për besnikëri Allahut.
Dora e Allahut
është mbi duart e tyre!..”

(Fet’h, 10)

